

Zaev-Sela
Maqedonia
Veriore, shtet
i të gjithëve

Fq.3



JESS BAILY
Koha për
vendime
të vështira
strategjike


Fq.4



Interi i
rikthehet
Luka
Modricit

Sport

Fq.22



Koha

www.koha.mk



**Fundi i
ëndrrës
kurde**

Fq.16-17

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3553 · e mërkurë, 9 janar 2019

-9°C | -4°C

15 DEN

SPECIALE

**Gabimi
strategjik i
Perëndimit
në Lindjen
e Mesme**



Aktet e përhapura të përhapura terroriste, dhe ngjarjet katastrofike të vitit 2016 në Evropë, kanë zbuluar qasje të reja të grupimeve ekstremiste dhe radikale, të cilat kanë shkaktuar frikë në mesin e perëndimorëve. Hetimi i akteve shkatërrimtare të 2 viteve të fundit, ka treguar se operacione të tilla terroriste, janë... Fq.13

GLOBI

**Turqia, krah
SHBA-ve
kundër
ISIS-it**

Fq.15

RAJON

**Mogherini ua
kërkon ekipit
negociator
heqjen e
taksës ndaj
Serbisë**

Fq.14



BADENTERI NË VENDIMET E QEVERISË

SHPATË ME DY TEHE



Me ndryshimet Kushtetuese të vitit 2001, midis tjerash për t'iu shmangur majorizimit u fut si instrument në vendimmarrjen e Kuvendit edhe parimi i Badenterit. Mirëpo, atë botë në tavolinë ishte edhe ideja që ky parim të futet edhe në vendimmarrjen e Qeverisë, por u refuzua me argumentin se rrethanat dhe kushtet politike të kohës nuk ishin mjaftueshëm të pjekura Fq.5

Maqedonia tri herë më dobët se Gjermania

Shkup, 8 janar - Maqedonia është një nga shtetet me produktivitet më të ulët të punës në Evropë. Sipas të dhënave të Zyrës Evropiane të Statistikave - EUROSTAT, një punëtor në Maqedoni për një orë krijon vetëm 43 për qind të vlerës së shtuar të mesatares evropiane, apo për tre herë më dobët se mesatarja gjermane prej 127 për qind. Ekonomistët vlerësojnë se Maqedonia ngjashëm me shtetet e tjera të Bal-

lkanit Perëndimor ka probleme me shumicën e faktorëve që ndikojnë në suksesin e një prodhimtarie, siç janë kapitali fizik apo makineritë relativisht të vjetra që përdoren në industrinë vendore, kapitali njerëzor që përfshin shkallën e arsimimit, shkathtësitë e punëtorëve si dhe përvojën që mbështet procesin e punës, teknologjia moderne e punës që shpesh mungon në fabrikat tona... Fq.6



OPINION

50 HIJET E TË VERDHËS

Jean PISANI-FERRY

Jelevdhet janë si shumë të dukshëm ash-tu edhe shumë enigmatike. Rebelimi i tyre filloi me okupimin e rreth rrotullimeve në të gjithë vendin, por ai arriti kulmin me demonstratat e dhunshme në Paris. Ata kanë ruajtur mbështetjen e 70% të popullit dhe afërsisht rreth 3 milionë njerëz janë regjistruar për "Numërinin zyrtar të jelevdhetëve" në Facebook, por protestat e tyre s'i kaluan kurrë 300,000 pjesëmarrës – shumë më pak se në protestat e kaluara të organizuara nga sindikatat kundër reformave sociale. Ata kanë qenë të pranishëm kudo nëpër kanalet e lajmeve, por nuk kanë një zëdhënës të vërtetë. Kryeministri Édouard Philippe bëri thirrje për dialog dhe hapi dyert e tij, por nuk u paraqiti askush.

Nuk është e lehtë të mësohet se çfarë duan vërtet ata. Jelevdhet kanë ndryshuar dy herë tashmë. Kryengritja fillimisht u shkaktoi nga lajmërimi i taksave shtesë të karburantit, me qëllim që të inkurajonte një reduktim të emetimeve të dioksidit të karbonit. Por, pasi qeveria anuloi rritjen e planifikuar të taksës, fokusi i protestës ndryshoi. Përsëri qeveria hapi rrugë. Presidenti Emmanuel Macron njoftoi më 10 dhjetor shfuqizimin e rritjes së taksave për pensionistët dhe një rritje të përfitimeve sociale që do të rrisin të ardhurat e njerëzve me pagë minimale prej 8.5%. Protestuesit u përgjigjën negativisht dhe theksuan kërkesat politike, përfshirë një hapësirë më të madhe për demokraci të drejtpërdrejtë, sidomos nëpërmjet referendumeve popullore.

Ajo që motivoi protestat fillestare është e qartë. Taksat e energjisë janë regresive: njerëzit me të ardhura të ulëta dhe të mesme shpenzojnë një pjesë të madhe të asaj që fitojnë për ngrohjen e shtëpive dhe furnizimin e makinave të tyre me karburant. Në dekadat e fundit, shumë familje të shtresës së mesme janë shpërngulur nëpër vende larg punës së tyre ku shtëpitë janë më të lira (Franca është amerikanizuar shumë në këtë drejtim). Ata e konsiderojnë taksën e karbonit si të padrejtë – të pasurit nuk i paguajnë ato në udhëtimet ajrore dhe hipsterat metropolitanë përfitojnë nga transporti publik i subvencionuar. Për t'i bërë ato të pranueshme, të ardhurat ose duhet të ishin përkushtuar për të mbështetur tranzicionin e gjelbër ose duhet të ishin rishpërndarë në mënyrë eksplicite në formën e reduktimit të taksave. Për arsye buxhetore, masat mbështetëse u limituan në 10% të pjesës së fundit të popullsisë. Njerëzit e gjendur në pjesën e sipërme u ndjenë menjëherë të neglizhuar dhe të shtrydhur. Ata bllokuan rreth rrotullimet në shenjë proteste.

Është më pak e thjeshtë të kuptohet pse kaq shumë njerëz të klasës së ulët dhe të mesme ndihen të paafte për të fituar bukën e gojës. Ndërkohë që të ardhurat mesatare familjare kanë mbetur amulli në Shtetet e Bashkuara dhe në Gjermani që nga fillimi i mijëvjeçarit, kjo nuk ndodhi në Francë. Pavarësisht krizës financiare, të ardhurat reale të familjeve u rritën me 8% nga viti 2007 deri në vitin 2017 – më shumë se në shumë

vende të tjera europiane. Për më tepër, pati rishpërndarje të rëndësishme përgjatë shkallës së të ardhurave. Ndryshimet në taksat dhe transfertat u hoqën 5% të të ardhurave 10 përqindëshit të sipërm dhe rritën me 5% të ardhurat e 20 përqindëshit të poshtëm.

Një pjesë e shpjegimit është demografia: plakja dhe rritja e familjeve me një person ose me një prind beqar kanë rritur numrin e njësitëve të konsumit dhe kanë zvogëluar fuqinë e tyre individuale blerëse. Një pjesë është sociologjike: standardet e konsumit në klasë të mesme – telefonat celularë, darkat nëpër restorante dhe pushime në plazh – janë rritur në përputhje me të ardhurat e të kamurve dhe janë bërë tepër të vështira për t'u përballuar nga klasa e mesme. Një pjesë është gjeografike: që nga viti 2000, zonat metropolitane kanë ecur mjaft mirë, ndërsa qytetet më të vogla janë munduar shumë. Çmimet e shtëpive janë rritur në pjesën e parë, por janë ulur në qytetet e vogla, duke i bërë pronarët e tyre më të varfër. Nuk është habi që ka pasur më shumë jelevdhetë nëpër qytetet me nga 50,000 banorë sesa në Lion apo Tuluzë.

Problemi më i thellë është se njerëzit e klasës së mesme ndiejnë se kontrata shoqërore është prishur. Ata dikur besonin se rritja e niveleve të arsimin do të sillte punë më të mira, të ardhura më të larta, prosperitet më të madh dhe rritje sociale për fëmijët e tyre. Por rritja është bërë tepër e dobët për të gjeneruar rritje të ndjeshme në të ardhura, punët e klasës së mesme kërcënohen nga revolucioni dixhital dhe konkurrenca për qasje në shkollat më të mira duket gjithnjë e më e shtrembëruar që të përfitojnë njerëzit që tashmë ndodhen në krye. Një pesimizëm francez i rrënjësor thellë thjesht përforcon ankthin e tyre.

Macron kishte diagnozën e duhur. Ai foli për njerëz që shkarkoheshin nga puna dhe që provoheshin nga mundësitë. Ai donte të zhbllokonte rritjen, të nxiste lëvizjen dhe të promovonte barazinë në qasje. Ai saktë tha se me shpenzimet publike shumë më të larta sesa në vendet e tjera të përparuar, përgjigja nuk mund të ishte më shumë taksat dhe më shumë shpenzime sociale. Por ai e nënvlerësoi madhësinë e ndryshimit në perspektivën për të cilën ai po bënte thirrje dhe ai nuk arriti t'i përgjigjej kërkesës për drejtësi në hartimin e reformave. Veprimet e tij të para – uljen e taksave për të pasurit – bënë që ai të fitonte nofken "presidenti i të pasurëve". Pa përmendur që këto taksat ndonjëherë kapnin të gjitha të ardhurat reale të kapitalit ose se, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore, ky vendim ishte ekonomikisht racional. Politikisht dhe shoqërisht, Macron u pa si një njeri që i shërbente të pasurve. Si rezultat, një dëshirë për kryengritje tashmë ka zënë rrënjë në shoqërinë franceze. E majta dhe e djathta kanë ndihmuar pa-turpësisht jelevdhetë, pa ofruar përgjigje reale. Fituesi mund të jetë edhe Tubimi Kombëtar i Marine Le Pen (ish-Fronti Kombëtar).

(Project Syndicate)

20 PËRQINDËSHI DHE PROBLEMI I TYRE

"Këto ditë disa zëra që në rastin më të mirë duan të ngrenë pluhur mediatic sepse rrojnë nga paratë e spekulimeve mediaticke, pra këta zëra hodhën tymnajën se: Opozita Shqiptare qenka proruse...sepse fakti që Aleanca për Shqiptarët kërkon nga Kryeministri që gjuha shqipe mos të quhet 20%, na bëka automatikisht neve parti proruse! Në rregull, supozojmë se Putini paska origjinë të fshehtë shqiptare, dhe dirigjon nga stepat ruse opozitën shqiptare që ja të mbrojnë gjuhën shqipe ja s'ka, po krahu tjetër?! Krahu i këtyre që nuk duan që gjuhën shqipe ta quajnë si të tillë por ta lënë 20%, çfarë janë këta?! Antishqiptar, apo proruse?! Se po të ecim me logjikën e pro dhe kundër, atëherë del që NATO sipas këtyre analistëve të jetë edhe ajo Antishqiptare?!

A mendoni se çfarë akuze e rëndë do të ishte kjo për një insitucion dhe për një Pakt të nderuar si që është NATO-ja?! E dinë këta llafollogët se NATO nuk do të lejonte kurrë mohimin e të drejtave minimale e jo më të drejtat e një Kombi sikur që janë Shqiptarët!

Për të qartësuar diçka për në fund: Mund të na shpallni proamerikan dhe njëkohësisht prorus, prokinëz dhe prokanadez, por ne jemi proshqiptarë, që do të thotë ProNato, ProLiri, ProDinjtet! Të gjithë ata që ndjehen 20%, që nuk e çmojnë lirinë dhe dinjtetin e tyre, problemi është i tyre!", shkruan në profilin e tij në FB, kryetari i Gostivarit, dr.Arben Taravari.

AMENDAMENTET SHQIPTARE NUK E PREKIN MARRËVESHJEN E PRESPËS

"Amendamentet legjitime shqiptare nuk e prekin asnjë presje Marrëveshjen e Prespës, përkundrazi, kësaj marrëveshjeje ia forcojnë qëndrueshmërinë dhe legjitimitetin e brendshëm të saj..!

Çdo përgjegjësi tjetër për dështimin e saj do bjerë fare pa dilema mbi dy shtrembërues të imponimit dhe interpretimit të saj, në përpjekjet për të kontrabanduar dhe legjitimuar me manipulime formulimet arbitrare nëpër Draft-amendamentet që kanë dalë përtej caqeve të Marrëveshjes së nënshkruar.

Dhe, për këtë, përgjegjësia do bjerë shumë paq mbi Zoran Zaevin dhe mbështetësin e tij në hije, Ambasadorin e UE në Shkup, z. S. Zhbogar", ka shkruar një status në Facebook, publicisti dhe studiuesi Nijazi Muhamedi.

MEDIACitate

NEGOCIATA TË NGJESHURA

Mesazhet kryesore ishin se negociatat tani duhet të bëhen përmes këtij ekipi. Taksat prej 100 për qind nuk mund të hiqet "në të thatë" dhe qëllimi i negociatave duhet të jetë njohja reciproke mes Kosovës dhe Serbisë. Udhëheqësit e delegacionit bënë të ditur se gjatë pjesës së parë të këtij viti do të punohet me orarë të ngjeshur për të shfrytëzuar atë që Bashkimi Evropian e quan një "dritare e mundësisë".

Shpend Ahmeti, bashkëkryesues i ekipit, theksoi pas takimit me Mogherinin se gjatë muajve të parë të këtij viti do të punohet me një orar të ngjeshur. "Sipas zonjës Mogherini edhe sipas asaj që e kemi dëgjuar nga përfaqësues të Departamentit të Shtetit (SHBA), ideja është që të punohet me një orar pak më të ngjeshur në gjysmën e parë të këtij viti, për të parë se a mund të arrijmë një marrëveshje me Serbinë. Këtu puna po koordinohet shumë afër me shtetet anëtare të BE-së, me shtetet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së... Është e qartë se ka pasur komunikim edhe me Uashingtonin edhe Moskën, se mund të ketë një marrëveshje", tha Ahmeti. Mirëpo përderisa bashkësia ndërkombëtare ka bërë angazhim shtesë për arritjen e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe presioni është shtuar nga Uashingtoni dhe Brukseli, delegacioni kosovar nuk solli diçka të re nga zhvillimet e fundit. Delegacioni bëri të qartë se taksat prej 100 % nuk duhet të hiqet. Delegacioni e konsideron këtë si mjet të vetëm të Kosovës në politikën e jashtme. Në anën tjetër Serbia ka kushtëzuar pjesëmarrjen e vet në dialog me heqjen e kësaj takse. "Taksa nuk hiqet në të thatë", tha Ahmeti. Ai tutje shtoi se nuk bënë të vendosen kushte për zhvillimin e dialogut: "Nuk bënë të thuhet nuk diskutojmë pa e hequr taksën. Çka nëse Kosova thotë nuk diskutojmë derisa Serbia të mos zbatojë marrëveshjen e energjetikës... cili është kuptimi i dialogut?", pyeti Ahmeti. Nga ana tjetër BE-ja në një deklaratë për media të lëshuar pas takimit ka theksuar "urgjencën e heqjes së taksës" duke theksuar se "marrëveshja gjithpërfshirëse ligjrisht e obligueshme mund të arrihet në një klimë që nuk ndihmon marrëdhëniet e mira fqinjësore, ku marrëveshjet e mëhershme nuk respektohen dhe nuk zbatohen", thuhet në deklaratën e Mogherinit. (DW, 8 janar)

ZAEVI PRANON DISA AMENDAMENTE TË OPOZITËS

MAQEDONIA VERIORE, SHTET I TË GJITHËVE

“Kemi arritur marrëveshje. Jemi krenar që me kontributin tonë kemi bërë të paktën që fjalë e parë e Kushtetutës, Preambula, të heq padrejtësi për definimin e keq të gjërave. Kemi folur rreth kërkesave që Aleanca për Shqiptarët i ka pasur. Prej sot nuk do të kemi dy kategori të qytetarëve - qytetarë, si dhe qytetarë tjerë..., por do të jetë vetëm populli maqedonas, shqiptarë, turk etj”, tha Sela pas takimit me Zaevin



me Republikën e Kosovës, kështu që Kosova do të jetë fqinji i pestë që kufizohet Maqedonia. Me këtë do të kemi mbështetjen e Aleancës për ndryshimet Kushtetuese”, deklaroi Zaevi.

LEHTËSOHET ZAEVI, AFËR 81 VOTAVE

Ndërkaq, në pyetjen se ai keni të sigurt tani 81 deputetë për të ratifikuar Marrëveshjen e Prespës, Zaevi u shpreh se akoma nuk është i sigurt në numrat. “Ende nuk mund të them i sigurt, sepse duhet të presim edhe deputetët e BESËS që të harmonizojmë qëndrimet pas takimit që do të realizohet me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov”, deklaroi Zaevi. Në ndërkohë, krenar me marrëveshjen me kryeministrin është shprehur vet Ziadin Sela.

“Kemi arritur marrëveshje. Jemi krenar që me kontributin tonë kemi bërë të paktën që fjalë e parë e Kushtetutës, Preambula, të heq padrejtësi për definimin e keq të gjërave. Kemi folur rreth kërkesave që Aleanca për Shqiptarët i ka pasur. Prej sot nuk do të kemi dy kategori të qytetarëve - qytetarë, si dhe qytetarë tjerë..., por do të jetë vetëm populli maqedonas, shqiptarë, turk etj”, tha Sela. Në lidhje me çështjen e riemërimit të gjuhës shqipe nga “gjuha që e flasin 20% e

popullatës” në gjuhën shqipe, Sela tha se këtë do ta shqyrtojnë në të ardhmen. Për të njëjtën gjë, Zaevi deklaroi se nuk ka mundësi formale që tani të realizohet, por se edhe ai nuk dëshiron që ndonjë gjuhë të thirret me përqindje.

Në ndërkohë, gjatë ditës, zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani lidhur me qëndrimin e Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqiptarët (ASH), për kushtëzimin e votës “për” ndryshimet kushtetuese sipas Marrëveshjes së Prespës, akuzoi këto dy parti opozitare shqiptare se me propozimet amendamentet e tyre për ndryshimet kushtetuese po dëmtojnë procesin e integritetit të Maqedonisë në BE dhe hyrjes në NATO.

“Ka dyshime për një dorë të fshehur, gjatë ditëve të fundit në këtë proces. Nuk dua të them se shqiptarët janë pjesë e kësaj dore të fshehur, të cilët tentojnë ta komprometojnë këtë proces, por nganjëherë, nga mospasja e një eksperience të mjaftueshme, ndodh që të krijoni një perceptim të tillë. Shërbimi më i keq që mund t’ia bëni shqiptarëve është të prezantoni para botës se shqiptarët janë duke e bllokuar procesin integruar. Nuk dua të mendojnë ndërkombëtarët që shqiptarët janë duke e bllokuar procesin euro-integruar të

Maqedonisë”, tha Osmani.

Përgjigje e menjëhershme ndaj akuzave të Osmanit ka ardhur nga deputeti i BESËS, Fadil Zendeli. “Ne nuk e pengojmë procesin por ata të cilët i ndryshuan rregullat. Ne dy deputetë të Lëvizjes BESA e mbështetëm iniciativën për hapjen e ndryshimeve Kushtetuese, por gjatë procesit u ndryshuan rregullat e lojës, u shtuan disa çështje të reja të cilat për ne janë kontestuese. Për këtë arsye, përgjegjësi duhet të bartin ato që ndryshuan rregullat e lojës, shtuan rregulla të reja, që nuk ishin pjesë e propozimit ndryshimeve Kushtetuese. Osmani të shkon dhe të pyes shqiptarët a pranojnë që në shtetësi të quhen maqedonas”, tha Zendeli.

Akuzat e zëvendëskryeministrit Bujar Osmani i ka komentuar edhe lideri i ASH-së, Ziadin Sela, ndërsa i quajti si “refren përsëritës”. “Kam dëgjuar zotëri Osmani po e përsërit si refren, këtë punën e duarve të zgjatura, por mendoj se më tepër bëhet fjalë për fenomenin e bishtit të kapur. Kur flasim për Osmanin më së e mirë e shpjegojnë deklaratat që ai i jep. Është shumë naive që opinioni t’iu beson akuzave të tija të pabaza. Në kërkim që gjuha e nënës së tij të respektohet si gjuhë e komuniteteve tjera. Askush nuk duhet të frikësohet nga barabartësia e qytetarëve. Ne po kërkim

që të jemi të barabartë në këtë shtet dhe kjo nuk rrezikon askënd. Kërkesat tona janë të drejta. Të gjithë ne duhet të frikohemi nga kompromiset që po bëhen me ligjin për amnisti dhe kompromiset e tjera përmes PSP”, tha Sela.

EKSPERTËT MAQEDONAS AKUZOJNË PËR KUSHTËZIME

Zhvillimet e fundit me kërkesat e opozitës shqiptare i kanë komentuar edhe ekspertë politikë maqedonas. Profesori universitar Lubomir Cuculovski takimet me liderët e partive opozitare shqiptare para se gjithash i sheh si çështje se deri ku është i gatshëm kryeministri Zaev të pranohet dhe me çfarë kërkesash ato dalin. “A po bëhen punët tani më të qarta? Nuk bëhet fjalë për 4 vota që të miratohen ndryshimet kushtetuese. Këto vota Qeveria i kishte atëherë kur u votua për hapjen e kushtetutës që edhe tani i ka. Megjithatë duhet të krijohet përshtypja se nuk i ka dhe mu për këtë duhet të bëjë lëshime ndaj kërkesave të faktorit politik shqiptar”, thotë Cuculovski.

Në anën tjetër, qëndrimin kushtëzues të dy partive opozitare shqiptare, dekani i Universitetit FON, Nano Ruzhin e vlerëson si një moment çasti që po e shfrytëzojnë këto parti që të plasojnë kërkesa të caktuara në interes të rritjes së rejtikut të votuesit e tyre.

“Edhe pse kjo për partitë opozitare shqiptare paraqet rrezik të madh për përgjegjësinë për mos suksesin eventual të Maqedonisë për tu bërë anëtare e BE-së dhe NATO-së. Është e njohur se partitë shqiptare në Maqedoni janë nën ndikim të madh nga faktori ndërkombëtar, e cila i jep përkrahje të madhe Maqedonisë për hyrje në BE dhe NATO. Nëse për shkak të lëvizjes BESA dhe Aleancës për Shqiptarët nuk votohen ndryshimet kushtetuese, e më këtë humbet shansi i Maqedonisë për në NATO, ekziston dhe rreziku tjetër që këto dy parti të humbin mbështetjen e votuesve të tyre në zgjedhjet e ardhshme”, thotë Nano Ruzhin, profesor universitar.

GASHI ME DY DEPUTETË “KUNDËR” AMENDAMENTEVE TË OPOZITËS SHQIPTARE

Shkup, 8 janar - Përderisa Aleanca për Shqiptarët (ASH) dhe Lëvizja BESA e udhëhequr nga Bilall Kasami gjatë gjithë procesit të ndryshimeve Kushtetuese, kishin vërejtjet e tyre, madje edhe parashtruan amendamente, grupacioni politik që veten e quan “Lëvizja BESA”, i udhëhequr nga Afrim Gashi, e që është edhe pjesë e koalicionit qeveritar, në gjithë këtë proces ka qenë i heshtur. As Gashi, por as dy deputetët tjerë të kësaj partie të martën nuk kanë dashur të përgjigjen nëse i mbështesin amendamentet e BESËS dhe ASH-së, ndërsa kanë lënë të kuptohet se ndryshimet kushtetuese do të

mbështeten ashtu siç janë marrë vesh partnerët e koalicionit dhe tetë deputetët e përjashtuar të VMRO-së, e që janë siguri për t’u arritur shumica e dyfishtë në Parlament. I vetmi që ka folur për gazetën KOHA është anëtar i lartë i grupacionit politik të Afrim Gashit, Skender Rexhepi, i cili ka porositur që, megjithëse përcaktimi i tyre programor është “Maqedonia e barabartë për të gjithë”, të mos abuzohet për, siç u shpreh ai, për qëllime ditore. “Qëndrimi ynë konform përcaktimeve programore është i paluhatshtëm. Ky shtet do të ketë ardhmëri të shëndritshme vetëm me barazi të plotë shtetërore edhe të shqiptarëve

dhe gjuhës shqipe. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që duhet abuzuar me këtë qëndrim për politikë ditore. Sot, shteti (përfshirë edhe shqiptarët si pjesë jetike e këtij shteti) është para një udhëkryqi historik, që duke përkrahur ndryshimet kushtetuese dhe të jemi në krah të miqve tanë - SHBA dhe BE, ose duke e penguar këtë proces ta fusim shtetin në errësirën ruse, e cila ka synim destabilizim e rajonit”, deklaroi për gazetën KOHA, Rexhepi. Sipas tij, partia e tyre do t’i përkrah ndryshimet kushtetuese që do t’i hapte udhë aderimit sa më të shpejt të vendit në NATO dhe BE. (D.J)

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 8 janar - Në ndryshimet kushtetuese që sot pritet të miratohen, do të futen edhe disa nga amendamentet e Aleancës për Shqiptarët. Kështu ka informuar kryeministri Zoran Zaev pas takimit me kreun e ASH-së, Ziadin Sela, ndërsa ka informuar se ndryshime do të pësojë edhe Preambula, ku siç ka kërkuar ASH, përveç shprehjes “Republika Veriore e Maqedonisë është shtet i maqedonasve dhe qytetarëve të saj”, do të shtohen edhe “i shqiptarëve, turqve, vllheve...”

“Me rëndësi është pjesëmarrja e të gjitha partive që procesi i ndryshimeve integruar të jetë i suksesshëm. Deri më tani kemi pranuar amendamentet e Aleancës për Shqiptarët në pjesën e Preambulës që të hiqet pjesa ku thuhet se ‘jetojnë në kufijtë’. Është e pranueshme që në Preambulë të qëndrojë formulimi i amendamentit të ASH-së se ‘Republika Veriore e Maqedonisë është shtet i qytetarëve maqedonas si dhe qytetarëve shqiptarë, turq, vllhe dhe gjithë të tjerëve që jetojnë në Maqedoni’, e jo siç qëndronte se është shtet i maqedonasve dhe etniteteve tjera që jetojnë brenda territorit të Maqedonisë. Amendamenti i dytë që u pranua është i Aleancës dhe BESËS, pra amendamenti 36 apo neni 49 që ka të bëjë me diasporën maqedonase. Falë diskutimeve të këtyre dy partive, pranohet që diaspora maqedonase të zëvendësohet dhe e komuniteteve të tjera në diasporë që jetojnë në Maqedoni. Pastaj pranohet edhe amendamenti i ASH-së që në Kushtetutë të jetë se ‘Republika e Maqedonisë kufizohet edhe

“Shtetet e Bashkuara qëndrojnë me Maqedoninë dhe me atë që qytetarët dhe udhëheqësit e Maqedonisë vendosin se është në interesin më të mirë të vendit. Ne e dimë se kompromiset në Marrëveshjen e Prespës nuk janë të lehta, por kjo është me të vërtetë një mundësi historike për Maqedoninë dhe për rajonin...”, thotë ambasadori Baily

Shkup, 8 janar - Ambasadori amerikan në Shkup, Jess Baily tha se Marrëveshja e Prespës është një mundësi historike për Maqedoninë dhe për rajonin. Në një intervistë ekskluzive për shërbimin maqedonas të Zërit të Amerikës, ambasadori Baily u bëri thirrje udhëheqësve të vendit të marrin vendimet e vështira strategjike që kërkon realizimi i marrëveshjes.

Ndërsa Maqedonia hyn në vitin 2019, cilat janë disa nga refleksionet tuaja për zhvillimet e vitit të kaluar atje?

BAILY: Kur mendoj për vitin e kaluar, gjatë të cilit pati aq shumë zhvillime historike, të gjitha mund të përmbliidhen me fjalët: një udhëheqje e guximshme. Qytetarët e Maqedonisë qartazi duan anëtarësimin në NATO dhe në BE. Kryeministrat Zaev dhe Tsipras si dhe ministrat e tyre të jashtëm u morën me çështje tepër të vështira për të arritur marrëveshjen e Prespës, e cila do të heqë pengesat për anëtarësimin. Ata treguan guxim, durim, vendosmëri dhe përqendrim të rëndësishëm në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje të gjatë.

Ne pamë gjithashtu një udhëheqje të guximshme në Parlament, kur deputetët votuan për të filluar procesin e ndryshimit të kushtetutës, duke lënë mënjanë interesat partiake në emër të të ardhmeje më të ndritur për Maqedoninë dhe qytetarët e saj. Në fund të fundit, është në dorë të udhëheqësve të zgjedhur në mënyrë demokratike në Maqedoni që të marrin vendimet e vështira strategjike që kërkon Marrëveshja e Prespës dhe të përcaktojnë kursin më të mirë për vendin. Shtetet e Bashkuara qëndrojnë me Maqedoninë dhe me atë që qytetarët dhe udhëheqësit e Maqedonisë vendosin se është në interesin më të mirë të vendit. Ne e dimë se kompromiset në Marrëveshjen e Prespës nuk janë të lehta, por kjo është me të vërtetë një mundësi historike për Maqedoninë dhe për rajonin, që do të çojë në një të ardhme më të sigurt dhe më të begatë.

INTERVISTË PËR VOA E AMBASADORIT AMERIKAN NË SHKUP, JESS BAILY

KOHA PËR VENDIME TË VËSHTIRA STRATEGJIKE



Qeveria e SHBA ka demonstruar një nivel të lartë angazhimi në Maqedoni. Çfarë e motivon mbështetjen e SHBA-ve për zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Prespës dhe anëtarësimin e Maqedonisë në NATO?

BAILY: Së pari, Shtetet e Bashkuara kanë qenë mik dhe partner i Maqedonisë që nga pavarësia e saj mbi 25 vjet më parë. Gjatë gjithë kësaj kohe, qytetarët dhe qeveria e Maqedonisë kanë mbështetur fuqimisht integrimin në institucionet euroatlantike. Është zgjedhja sovraane e Maqedonisë për t'u bashkuar me NATO-n. Ne jemi krenarë që e mbështesim këtë zgjedhje dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë sepse Maqedonia ndryshon rrjedhën e së ardhmes së saj. Ne mbështesim fuqimisht zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Prespës midis Maqedonisë dhe Greqisë. Marrëveshja do të lejojë që Maqedonia të zërvendin që meriton në NATO dhe BE dhe do të kontribuojë në stabilitetin, sigurinë dhe begatinë rajonale. Përveç kësaj, Zëvendës Sekretari i Shtetit, John Sullivan ishte këtu disa javë më parë dhe ai na kujtoi të gjithëve se bota ka ndryshuar në mënyrë dramatike këto 20 vitet e fundit. Konkurrenca dhe konflikti mes fuqive të mëdha janë kthyer në skenë, me aktorë të këqij që kërkojnë të prishin dhe destabilizojnë sistemet demokratike. Për t'i mposhtur ata, kemi nevojë për shtete të forta, me themele të forta demokratike, media të lira dhe tregje të gjalla e të hapura. Ne sinjalisim besojmë se Maqedonia, e integruar plotësisht në NATO dhe në BE, do të jetë një aleat e fortë në

prosperitetin dhe sigurinë tonë kolektive.

A jeni i bindur se Maqedonia do ta zbatojë Prespën? Cili është plani rezervë nëse votimi në parlament dështon, qoftë në Maqedoni apo në Greqi?

BAILY: Gjatë gjithë procesit të negociatave dhe zbatimit të Marrëveshjes së Prespës, udhëheqësit në të gjithë spektrin kanë qenë të gatshëm të lënë mënjanë interesat afatshkurtra partiake për të mbështetur të ardhmen e Maqedonisë në NATO dhe BE. Udhëheqësit në Greqi dhe Maqedoni kanë thënë se kjo marrëveshje është thellësisht në interesin e tyre kombëtar; ajo do të çojë në siguri dhe begati për të dy vendet dhe për rajonin. Arritja e kësaj zgjidhjeje zgjati 25 vjet dhe unë nuk shoh ndonjë alternativë praktike në horizont. Kam besim se do të vazhdojmë të shohim udhëheqës të guximshëm që punojnë për të siguruar se Maqedonia dhe Greqia nuk do ta humbasin rastin që më në fund ta zgjidhin këtë çështje.

Shumë njerëz kritikojnë Qeverinë Zaev për kompromis në emër të pajtimit dhe në emër të së ardhmes së Maqedonisë në NATO dhe në BE. Çfarë mendoni për amnistinë për shumë prej atyre të përfshirë në sulmin e 27 prillit në Parlament? A e dobëson kjo pozitën e Maqedonisë si një udhëheqëse në rajon në angazhimin e saj për paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin, siç tha zëvendës sekretari Sullivan në vizitën e tij të fundit?

BAILY: Mendoj se ne të gjithë pajtohemi se kriza e zgjatur politike ka qenë jashtëzakonisht përçarëse dhe ka çuar në një situatë

ku ndarjet politike përcaktojnë marrëdhëniet mes njerëzve, madje në disa raste, edhe më shumë sesa dallimet etnike, fetare apo ekonomike. Udhëheqësit e Maqedonisë duhet të jenë në gjendje të punojnë së bashku për të trajtuar çështjet e vështira me të cilat ballafaqohet vendi dhe qytetarët e tij. Vendimi i Parlamentit për të miratuar një ligj për amnistinë është një vendim i rëndësishëm politik, i miratuar nëpërmjet një procesi transparent dhe demokratik që u mbështet nga një shumicë e madhe parlamentarësh. Në fund të fundit, mendoj se kjo gjykohet nga fakti nëse ligji ndërton konsensusin kombëtar të nevojshëm për të realizuar aspiratën e shumicës së qytetarëve për t'u bashkuar me NATO-n dhe BE-në, një proces që do të forcojë sundimin e ligjit në vend.

Ne besojmë se është e rëndësishme që ata që organizuan sulmet e 27 prillit të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre. Gjatë gjithë këtij procesi, gjyqësori duhet të mbetet i pavarur nga ndikimi politik dhe i lirë të vendosë për këto raste në bazë të fakteve dhe ligjit. Siç tha kohët e fundit kryeprokurori Publik Joveski, kjo është pikërisht ajo që po bëjnë gjyqtarët dhe prokurorët: zbatimi i ligjit.

A e kërcënon amnistia dhe ndryshimet në kodin penal kualifikimin e Maqedonisë për anëtarësim në NATO dhe BE?

BAILY: Procesi i pranimit në NATO po ecën mirë. Zyrtarët e NATO-s dhe Qeveria e Maqedonisë kanë përgatitur protokollet e pranimit dhe sapo Marrëveshja e Prespës të zbatohet plotësisht, ato do

të finalizohen. Më 6 dhjetor, Maqedonia i paraqiti zotimet e saj për sundimin e ligjit tek aleatët në shpërbërje të reformave që do të shoqërojnë protokollet e saj të pranimit në NATO. Këto përfshijnë përpjekjet për të rritur pavarësinë e gjyqësorit, për të mbajtur zyrtarët përgjegjës për korrupsionin dhe keqpërdorimin e pushtetit dhe për të reformuar sektorin e inteligjencës. Pasi të 29 aleatë të kenë ratifikuar Protokollet e Anëtarësimin, Maqedonia do të bëhet anëtare e 30-të e NATO-s.

Si do të vazhdojë SHBA-ja të mbështesë agjendën e reformave në Maqedoni? Cilat duhet të jenë fushat kryesore të përqendrimit për qeverinë Zaev në përpjekjet e saj për reforma?

BAILY: Në bisedat e mia të shumta me qytetarët, një gjë është shumë e qartë: njerëzit duan që Maqedonia të jetë një vend i begatë, një vend ku njerëzit e mençur dhe të zellshëm të mund të ndërtojnë një të ardhme të ndritur, pavarësisht prej nga vijnë apo cilin njohin. Zbatimi i Marrëveshjes së Prespës dhe anëtarësimi i Maqedonisë në NATO do të rrisë stabilitetin dhe sigurinë dhe kjo do të çojë në rritje ekonomike. Bizneset dhe investitorët, vendas dhe të huaj, do të jenë më të sigurt për të vepruar në vend.

Por Maqedonia duhet të punojë gjithashtu për të ndërtuar institucionet e forta që nevojiten për të arritur begatinë afatgjatë. Qytetarët duhet të kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga institucionet. Kjo nuk është thjesht një çështje e ligjeve dhe rregulloreve, por ndryshim i sjelljes, duke ndryshuar “mënyrën se si funksionojnë gjërat”, në mënyrë që ligjet të funksionojnë siç duhet, që të shpërblehet merita dhe jo besnikëria ndaj epurve dhe që inovacioni të lulëzojë e jo status quo-ja. Kjo nuk është e lehtë dhe do të kërkojë udhëheqje të guximshme dhe vizion të guximshëm nga të gjitha palët. SHBA është e angazhuar për partneritetin tonë me Maqedoninë dhe ne do të vazhdojmë të qëndrojmë krah për krah me Maqedoninë në mbështetje të vendosmërisë suaj sovraane për një të ardhme të sigurt dhe të begatë në familjen perëndimore të kombeve, duke përfatuar plotësisht vlerat demokratike dhe përgjegjësitë e përbashkëta të aleancës dhe institucioneve tona.

Me ndryshimet Kushtetuese të vitit 2001, midis tjerash për t'iu shmangur majorizimit u fut si instrument në vendimmarrjen e Kuvendit edhe parimi i Badenterit. Mirëpo, atë botë në tavolinë ishte edhe ideja që ky parim të futet edhe në vendimmarrjen e Qeverisë, por u refuzua me argumentin se rrethanat dhe kushtet politike të kohës nuk ishin mjaftueshëm të pjekura

Koha Destan JONUZI

BADENTERI NË VENDIMET E QEVERISË

SHPATË ME DY TEHE



Shkup, 8 janar - Parimi i Badenterit si mekanizëm i cili do ti mbronte komunitetet etnike në Republikën e Maqedonisë nga majorizimi, me ndryshimet Kushtetuese të vitit 2001, të bazuara në Marrëveshjen e Ohrit u fut si instrument vetëm se në vendimmarrje të Kuvendit për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat kolektive të shqiptarëve dhe bashkësive më të vogla etnike. Por, atë kohë me arsyetimin se nuk është koha ky parim ngjashëm edhe si me parimin e 20 %, është refuzuar të bëhet kategori Kushtetuese, shkruan gazeta Koha. Eksperti juridik dhe njohësi i çështjeve politike, Naser Ziberi në një prononcim për gazetën KOHA thotë se parimi i Badenterit si instrument nga mbrojtja e majorizimit është mirë që të jetë edhe pjesë e vendimmarrjeve të Qeverisë, ashtu siç

është edhe pjesë e vendimmarrjes në Parlament.

"Edhe në Qeveri duhet të ekzistoj ky instrument mbrojtës. Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001, ky parim nuk ka arritur të futet në vendimmarrjen e Qeverisë me argumentin se mund t'i bllokojë proceset. Nëse ka vullnet politik mendoj se ky parim mund të aplikohet dhe futet si instrument edhe në Qeveri. Por mendoj se edhe nëse tani hapet kjo çështje përsëri do të përdoret i njëjti argument si në vitin 2001", deklaroi Ziberi.

Nga ana tjetër, Albert Musliu, njohës i çështjeve politike në Maqedoni thekson se për mos futjen e parimit të Badenterit në vendimmarrjen e Qeverisë justifikimi në vitin 2001 ka qenë se nuk është koha tani, ngjashëm siç ishte justifi-

fikimi edhe për 20 %.

"Parimi i Badenterit dhe koncepti qytetarë që proklamoi Qeveria janë në kundërshtim njëra me tjetrën, për arsye se njëri parim ka të bëjë me të drejtat etnike e tjetri me të drejtat qytetare. Badenteri është një shpat me dy tehe, për arsye se shumica e Badenterit nënkupton vota të pjesëtarëve të komuniteteve etnike, që në rastin e Maqedonisë mund ti siguron edhe një parti maqedonase siç është rasti me LSDM-në e cila në radhët e saj ka edhe pjesëtarë të komunitetit shqiptarë dhe komuniteteve tjera etnike", deklaroi për gazetën KOHA, analisti Albert Musliu.

Sikundër dihet, me ndryshimet Kushtetuese të vitit 2001, duke u bazuar në Marrëveshjen Paqësore të Ohrit e cila doli si rrjedhojë e luftës së vitit 2001, midis tjerash

për t'ju shmangur majorizimit u fut si instrument në vendimmarrjen e Kuvendit edhe parimi i Badenterit, Mirëpo, atë botë në tavolinë ishte edhe ideja që ky parim të futet edhe në vendimmarrjen e Qeverisë, por u refuzua me argumentin se rrethanat dhe kushtet politike të kohës nuk ishin mjaftueshëm të pjekura që të instalohet ky mekanizëm edhe në Qeveri. Analistët për gazetën KOHA thonë se janë bërë tentime të vogla që të zëvendësohet ky instrument me disa projekte konkrete: formimi i Qeverisë në bazë të parimit fituesi me fituesin (fituesi i zgjedhjeve në kampin politik maqedonase dhe ai në kampin politik shqiptar formojnë Qeverinë), një program i përbashkët qeveritar i bazuar në programet e partive të koalicionit qeveritar etj.

Debat për shpenzimet për kredi dhe për bursat studentore

Shkup, 8 janar - Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredite konsumatore, me të cilat kufizohet shkalla vjetore e shpenzimeve të përgjithshme të kredive konsumatore sot mori mbështetje në lexim të parë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Siç elaboroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski, me kufizimin e shfrytëzuesve të kredive nuk do të paguajnë shpenzime më të mëdha të kredive dhe do të minimizohet rreziku nga përkeqësimi i mëtutjeshëm i gjendjes së shfrytëzuesve të kredive, të cilët kanë probleme me pagesën e kredisë. Ligji do të vlejë edhe për kreditë në vlerë më të vogël se 200 euro në kundërvlerë të denarit, si dhe për kreditë për të cilat konsumatori deponon lëndë tek kreditori.

"Tani shpenzimet të cilat kreditoret i llogarisin dhe paguajnë kreditë e aprovuara konsumatore si provizione, kompensime dhe ngjashëm, nuk janë të kufizuara, që i jep mundësi të llogarisin kompensime të larta dhe provizione gjatë miratimit të kredisë konsumatore. Situata e këtillë është e shprehur më tepër tek kontratat për kredi të vogla, gjegjësisht të quajtura kredi të shpejta. Në atë mënyrë numër i madh i qytetarëve kanë vështirësi gjatë pagesës së kredisë dhe zakonisht janë të detyruar të marrin kredi të re për mbulim të atij paraprak", tha Tevdovski. Deputetët i mbështetën edhe ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për standard studentor në lexim të parë. Me to vendoset tip i ri bursave studentore për studentë të regjistruar në programe studimore të institucioneve të larta arsimore për arsim të kuadrit mësimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Me propozimin është vërtetuar se nga numri i përgjithshëm i bursave që i ndaj Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 49 për qind janë për studentë të kategorive sociale, 30 për qind janë për studentë me sukses të veçantë në mësim, 20 për qind janë për studentë të fakultetet matematikonoaturore, tekniko-teknologjike, bioteknike dhe/ose shkencë mjekësore, ndërsa një për qind për studentë të regjistruar në programe studimore të institucioneve të larta arsimore për arsim të kuadrit mësimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

TAKIM I KOMITETIT PUNUES

EUROINTEGRIMET MOBILIZOJNË MINISTRAT DERI TE NËPUNËSIT

Shkup, 8 janar - Gjendje të jashtëzakonshme në administratë, mobilizim të të gjithëve, nga ministrit, përmes zëvendësve, sekretarëve shtetërorë, nëpunësve, "shpalli" dje zëvendëskryeministri i angazhuar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në deklaratën para fillimit të takimit të Komitetit punues për eurointegrimet. Vitin e cilësoi si kyç për proceset eurointegruese të Maqedonisë, ndërsa raportin nga Komisioni evropian, nëse jo në prill, pritet ta marrim pas zgjedhjeve për Parlamentin evropian, të caktuara për në maj. Por pa dallim nga kjo, theksoi Osmani, do të punohet maksimalisht sikur të ketë raport në prill, me qëllim që të dërgohen rezultate nga proceset reformuese dhe të mos ketë asnjë hapësirë të vogël për hamendje mes 27 vendeve anëtare të Unionit.



"Që prej ditës së parë të mobilizohen të gjitha resurset e mundshme në administratë, por edhe jashtë saj në prag të muajve më të rëndësishëm për procesin eurointegruese të RM-së. Ky është edhe një vit historik për RM-në, por tani për korrje të rezultateve të cilat i presim nga dy proceset më të rëndësishme, integrimin në BE dhe

anëtarësimin në NATO. Prej sot, në njëfarë mënyre, shpallim gjendje të jashtëzakonshme në administratë, i vendosim në disponim të gjitha trupat e mundshëm, të gjithë njerëzit nga udhëheqësit, deri te ministrat, zëvendësit, sekretarët shtetërorë, deri te njeriu i fundit me qëllim që të zbatohen reformat, të dërgohen rezultate, në

pajtim me rekomandimet e Këshillit të BE-së, të dhëna vitin e kaluar në qershor. Por, edhe të ketë rezultate konkrete nga miratimi i atyre reformave, të cilat do t'i bëjnë shoqërinë dhe shtetin më evropian dhe do të japin argumente të volitshme për t'i bindur vendet-anëtare që edhe formalisht ta fillojmë datën për negociatën", tha Osmani, duke cekur se me atë do të hapet rruga që këtë vit ta kemi konferencën e parë ndërqeveritare.

Në takimin e Komitetit punues, siç paralajmëroi Osmani, bëhet prerje e Planit 18 dhe obligimeve për muajt e ardhshëm, ajo që është bërë nga takimet përgatitore, por bisedohet edhe për formimin e strukturave negociuese. Negociuesi teknik, Bojan Mariçiq përkujtoi se takimet përgatitore për negociatën kanë filluar në shtator të viti të kaluar. (Z.V)

Një punëtor në Maqedoni krijon diku rreth 15 mijë euro të Prodhimit të Brendshëm Bruto në vit që është gati tre herë më pak se mesatarja evropiane prej rreth 50 mijë euro

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 janar - Maqedonia është një nga shtetet me produktivitet më të ulët të punës në Evropë.

Sipas të dhënave të Zyrës Evropiane të Statistikave - EUROSTAT, një punëtor në Maqedoni për një orë krijon vetëm 43 për qind të vlerës së shtuar të mesatares evropiane, apo për tre herë më dobët se mesatarja gjermane prej 127 për qind. Ekonomistët vlerësojnë se Maqedonia ngjashëm me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor ka probleme me shumicën e faktorëve që ndikojnë në suksesin e një prodhimit, siç janë kapitali fizik apo makineritë relativisht të vjetra që përdoren në industrinë vendore, kapitali njerëzor që përfshin shkollën e arsimimit, shkathësitë e punëtorëve si dhe përvojën që mbështet procesin e punës, teknologjia moderne e punës që shpesh mungon në fabrikat tona. Problemet e tjera janë edhe organizimi shpesh joefikas i punës, ambient ekonomik dhe ai juridik nën të cilin zhvillohet puna si dhe faktorët e tjerë që rrisin apo ulin produktivitetin.

PRODUKTIVITETI I ULËT I PUNËS

MAQEDONIA TRI HERË MË DOBËT SE GJERMANIA



tin.

"Problemi i produktivitetit të punës paraqet një çështje mjaft komplekse që i mundon të gjitha shtetet e rajonit, përfshi edhe Maqedoninë. Megjithatë nëse i njëjti punëtor nga Maqedonia në Gjermani apo në Zvicër, është një nga shembujt e punëtorit më të mirë, atëherë nuk mundet të thuhet se ai nuk është punëtor, por atij i mungon një motivim më i madh, jo vetëm në aspektin e pagës ku këtu punon për 250 apo 300 euro ndërsa për perëndim punon për një pagë dhjetë herë më të madhe, por edhe stimulimeve të llojeve të ndryshme. Njëherazi këtu kemi edhe problemin e menaxhimit të

mirëfilltë, kompanive mirë të organizuara dhe me objektiva të qarta të punës", thotë profesori universitetar, Neritan Turkeshi.

Sipas tij, në këtë drejtim edhe fabrikat tona nevojitet më shumë të ofrojnë prodhime më cilësore, por edhe të orientohen më shumë në prodhime që më shtrëngt mund ti shesin në treg, në mënyrë që të sjellin edhe profit më të madh për kompanitë.

Nga ana tjetër, eksperti Vanço Uzunov, vlerëson se produktiviteti i punës rritet përmes investimeve dhe kualifikimeve bashkëkohore, ndërsa mirëqenia e qytetarëve rritet me dinamikën e përmirësimit të kualifikimeve të punës dhe me in-

vestime.

"Thelbi i përmirësimit të konkurrencës dhe produktivitetit të ekonomisë nënkupton kualifikime më të mira që i kërkon tregu i punës, si dhe angazhimi në prodhime dhe shërbime që do të kenë komponentën e vlerës së shtuar të prodhimeve për eksport", vlerëson Uzunov.

Nga ana tjetër, edhe hulumtimet e ndryshme tregojnë se Maqedonia ka produktivitet të ulët të matur me vlera materiale për punëtor. Analizat e produktivitetit të punës të para disa viteve, tregojnë se një punëtor në Maqedoni krijon diku rreth 15 mijë euro të Prodhimit të Brendshëm Bruto në vit që është gati tre herë më pak se mesatarja evropiane prej rreth 50 mijë euro. Ndryshe, sipas EUROSTAT, punëtorët më produktiv janë ata të Luksemburgut me 172 për qind të mesatares evropiane, të Danimarkës me 133 për qind dhe Gjermanisë me 127 për qind të mesatares evropiane. Nga ana tjetër, Bullgaria ka produktivitet të punës prej afër 45 për qind të mesatares evropiane, Rumania ka 59 për qind, Greqia dhe Kroacia nga 64 për qind, ndërsa Sllovenia ka 81 për qind.



Zaevi të vizitojë Kodrën e Diellit, protesta gjatë vikendit

Tetovë, 8 janar - Protesta dhe bllokada në rrugën Tetovë - Kodra e Diellit, të shtunën që vijon tek teleferiku në Tetovë nëse institucionet kompetente nuk përgjigjen pozitivisht në kërkesat për përmirësimin e kushteve për punë normale të qendrës dimërore Kodra e Diellit. Këtë dje e paralajmëruan nga iniciativa "Ta shpëtojme Kodrën e Diellit" në konferencën për shtyp që e mbajtën tek Teleferiku në fillim të rrugës për këtë qendër dimërore. Sipas anëtarit të iniciativës Amdi Sulejmani, Kodra e Diellit edhe këtë sezon dimëror ka mbetur pa investimet e premtuara dhe kujdesin e nevojshëm nga institucionet. Ai theksoi edhe një pjesë të kërkesave kryesore të kësaj iniciative për shmangien e bllokadave të paralajmëruara. "Kërkojmë takim urgjent me kryeministrin Zaev dhe përfaqësuesit tjerë nga kabineti i tij më së voni deri të shtunën çka duhet të realizohet në Kodrën e Diellit me ç'rast kërkojmë që kryeministri vizitën ta realizojë si qytetar i thjeshtë që nga afër të përballlet me vështirësitë reale me të cilat vazhdimisht përballen vizitorët në këtë qendër turistike. Qeveria të formojë komision për mbikëqyrje të punëve të Kodrës së Diellit me përfshirjen e përfaqësuesve nga Qeveria, sektori civil, ekspertët nga sportet dimërore dhe kuadri të filluar me gjendjet në qendrën dimërore. Përkushtim më të madh nga Agjencia për zhvillim të turizmit, Agjencia për rini dhe sport dhe Federata e skijimit dhe presion të tyre më të madh ndaj institucioneve kompetente rreth punës së tyre të pasuksesshme të Kodrës së Diellit", deklaroi Sulejmani.

Nga iniciativa "Për shpëtim të Kodrës së Diellit" presin edhe reagim urgjent të kompetentëve për, siç tha Sulejmani, tejkalim urgjent të situatave të krizës që përsëriten çdo sezon si pastrim i parkingut nga bora, të punojnë rregullisht teleferikët, rend dhe qetësi në terrenet dhe punë 24 orëshe e ambulancës në Qendër. (U.H)

Sipas hulumtimit, blerjet onllajn ndaj shitësve vendorë ndërrohen në drejtim pozitiv për e-shitoret e Maqedonisë. Qytetarët e Maqedonisë shpenzojnë mesatarisht 19.7 euro në një transaksion onllajn kur blejnë në shtëpi, përderisa 31.5 euro kur blejnë nga e-tregtarë të huaj

Koha

Qefersa ABDYLI

Shkup, 8 janar - Transaksione në vlerë prej 100 milionë eurove janë bërë me kartela pagesore për blerje onllajn në tre tremujorët e parë të vitit të kaluar, apo për 28 për qind më shumë në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Transaksionet individuale në këtë periudhë shënojnë trend akoma më të madh në rritje, prej 39 për qind, tregon sot hulumtimi i publikuar i Asociacionit të Maqedonisë për e-tregti.

Pjesa më e madhe e blerjeve onllajn, përkatësisht 63 për qind,

MEGJITHËSE MË SHUMË SHPENZOJMË JASHTË MAQEDONISË

RRITET TREGTIA ONLLAJN



janë shpenzuar për blerje nga e-tregtarë të huaj apo pothuajse 63.34 milionë euro, përkundër 31.15 milionë euro të realizuar ndaj e-tregtarëve vendorë të cilët janë 33 për qind. Katër për qind apo 3.8 milionë euro nga vlera e transaksioneve të realizuara ndaj e-tregtarëve vendorë janë bërë nga posedues të kartelave të huaja pagesore. Blerjet e kryera onllajn nga poseduesit e kartelave pagesore të Maqedonisë ndaj e-tregtarëve vendorë shënon rritje prej 51 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, për-

derisa të huajt në Maqedoni shpenzuan për 82 për qind më shumë onllajn tek e-tregtarët vendorë. Në të dhënat e BPRM-së për transaksione të realizuara onllajn numërohen edhe transaksionet për pagesa të faturave për ujë, rrymë, telefon që janë realizuar onllajn me kartela pagesore. Sipas hulumtimit, blerjet onllajn ndaj shitësve vendorë ndërrohen në drejtim pozitiv për e-shitoret e Maqedonisë. Qytetarët e Maqedonisë shpenzojnë mesatarisht 19.7 euro në një transaksion onllajn kur blejnë në shtëpi, përderisa 31.5

euro kur blejnë nga e-tregtarë të huaj. Ndoshta oferta e rritur onllajn nga e-tregtarët vendorë do të kontribuojë ndaj interesimit më të madh për blerje onllajn nga tregtarë vendorë.

Oferta e shtuar dhe më e mirë nga e-tregtarët, përvoja e përmirësuar dhe mundësi më të mëdha për blerësit janë kyçe për rritje të interesit të qytetarëve për blerje onllajn. Kompanitë e mëdha, gjithashtu, duhet ta vendosin në fokus këtë kanal për shitje fillimisht për shkak të përfitimeve, të cilat i mundëson e-tregtia, e me atë edhe dukshëm do të ndikojnë dhe kontribuojnë drejt rritjes së e-tregut", konsideron Nina Angellovska, kryetare e Asociacionit të Maqedonisë për e-tregti. Kryesisht, siç tregon, mungon edukimi dhe besimi, ndërkaq ato i ndërtojnë më së shumti kompanitë vendore me ofertat, proceset, mbështetjen e tyre për blerësit dhe përvoja e përgjithshme e mirë e cila do t'i hasë dhe tejkalojë pritjet e blerësve.

Ekspertët thonë se në Maqedoni konsumimi i druve të zjarrit shkon deri në mbi 20 metra kub në vit, që kërkon më shumë së 60.000 denarë në vit

Shkup, 8 janar - Ngrohja me dru zjarri është ende ekonomikisht më efektive në pjesët e vendit ku nuk ka ngrohje qendrore dhe ngrohja me energji elektrike është më miqësore me mjedisin, thonë ekspertët. Sipas tyre, sezoni i ngrohjes në Maqedoni zakonisht zgjat gjashtë muaj, tre prej të cilave kërkojnë ngrohje më të madhe, ndërsa në pjesën tjetër zakonisht ulet për të ngrohur pjesërisht lokalit.

Ata theksojnë se ngrohja më e lirë në dispozicion në Maqedoni është me dru zjarri, por nuk është e pranueshme për mjedisin dhe nëse sistemi i gazsjellësit është mjaftueshëm i zhvilluar në vend dhe kështu do të rriste konsumin e gazit natyrorë, prioritet do të ishte ngrohja e gazit që pothuajse nuk e ndot mjedisin. Aktualisht, gazi është i disponueshëm, vetëm për disa familje në Kumanovë dhe Strumicë, ndërsa në pjesët e mbetura të vendit ende nuk ka rrjet adekuat të gazit.

Ekspertët thonë se një familje mesatare në Maqedoni përdorë çdo vit 3 deri në 10 metra kub dru për ngrohje ose zakonisht rreth gjashtë metra kub. Nëse masa e përgjithshme e drurit e prodhuar

SITUATA E NGROHJES NË MAQEDONI

DRURI, BURIM PRIMAR I ENERGJISË



në vend ndahet çdo vit, dhe është rreth 780.000 metra kub, me numrin mesatar në metra kub të nevojshëm për ngrohje, më shumë se 130.000 familje ngrohen me dru. Çmimi në PE "Pyjet e Maqedonisë", sipas thirrjes së tyre, nuk duhet të jetë më i lartë se 2.900 për ahu dhe 3.000 denarë për lis. Çmimi mesatar i shitjes me pakicë për një metër kub të druve të pyllit në magazinat private shkon 3.300 deri në 3.800 denarë, ndërsa druri i lirisit është më i shtrenjtë për 100 deri 200 denarë për metër kub. Kjo tre-

gon se për ngrohjen me dru zjarri një familje mesatare në Maqedoni ndan midis 20 dhe 23 mijë denarë në vit.

Ekspertët thonë se në Maqedoni konsumimi i druve të zjarrit shkon deri mbi 20 metra kub në vit, që kërkon më shumë së 60.000 denarë në vit. Në Maqedoni është e vështirë të vlerësohet se sa familje ngrohen me energjinë elektrike, sepse askush nuk ka detyrimin të shpallë atë që do të ngrohet. Sipas ekspertëve, ngrohja e energjisë elektrike aktualisht është eko-

logjikisht më e pranueshme për zonat urbane, nëse marrim parasysh se 70%e nevojave të energjisë elektrike nga "REK Bitola" që operon në qymyr dhe në mënyrë të konsiderueshme ndot mjedisin në afërsi të termocentralit.

Sipas publikimit "Konsumimi i energjisë shtëpiake", 62% e numrit të përgjithshëm të amvisërisë në Maqedoni përdorin drurin si burim primar të energjisë, 29% energjinë elektrike dhe vetëm 8% janë të lidhur me ngrohjen qendrore. (Q.A)

Asnjë fëmijë me fruth në Tetovë!

Tetovë, 8 janar - Zyrtarisht, në Tetovë nuk ka të regjistruar raste të fruthit tek fëmijët. Por, dyshimet ekzistojnë se edhe në rajonin më të gjerë të Tetovës ka të sëmure me fruth, por nuk janë diagnostifikuar. Kështu thotë mjeku peditër Sani Bajrami, sipas të cilit, në Tetovë me rrethinë, momentalisht raste zyrtare të evidencuara me fruth nuk ka, mirëpo kjo nuk do të thotë se sëmundja e fruthit nuk është e rifshfaqur ose prezente.

"Dua të ritheksoj se sëmundja e fruthit ka qenë sëmundje karakteristike e viteve 70-ta, gjegjësisht para 30 apo 40 viteve, pra nuk është sëmundje karakteristike për vitet në të cilat tani ne jetojmë. Kjo lidhet me shkakun që në ato vite, vaksinimi i fëmijëve me vaksinën Morbilit MRT nuk është realizuar, mirëpo në tre dekadat e fundit, e gjithë popullata është e përfshirë në imunizim ose me vaksinimin kundër sëmundjes së fruthit ose kundër morbilit", thotë Bajrami. Sipas tij, paraqitja e fruthit është pasojë e mos vaksinimit të fëmijëve, ndërsa thotë se edhe nëse fëmija nuk është vaksinuar, duhet që brenda 72 orëve të vaksinohet dhe të mos ketë komplikime.

"Problemi kryesor qëndron te mos vaksinimi i fëmijëve. Duhet ta dimë që vaksinimi kundër morbilit realizohet në periudhën 12 muajshe, pra në vitin e parë dhe kur fëmija është në moshën 5-vjeçare. Dua të jap një apel që të gjithë ata fëmijë, të cilët diagnostifikohen për momentin, nuk është vonë edhe vaksinimi i menjëherëshëm, sepse neqoftëse fëmija është në kontakt me persona të cilët janë të sëmurë me morbil, inkubacioni i kësaj sëmundje është dhjetë deri në pesëmbëdhjetë ditë, prandaj nëse një fëmijë ka rënë në kontakt me të infektuar me morbil, edhe nëse ai nuk është i vaksinuar fare, ka kohë deri në 72 orë që të vaksinohet dhe si i tillë rezultatin ta ketë maksimal", deklaroi ai. Mjekët informojnë se shenjat e para janë temperaturë, ethe dhe ndryshimet në lëkurë.

Mjekët sugjerojnë që qytetarët duhet të konsumojnë sa më shumë lëngje dhe fruta, si dhe t'iu ikin ambienteve të hapura mbipopulluara. Qytetarët gjithashtu nuk duhet ta zëvendësojnë mjekun, duke konsumuar antibiotik në shumë raste

GJENDJA GRIPALE NË RRIJTE

PRIJNË TETOVA DHE SHKUPI



Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 8 janar - Ulja e menjëhershme e temperaturave ka rritur numrin e të sëmurëve. Numri i pacientëve të prekur nga viroza apo gjendje gripale, siç preferojnë ta quajnë mjekët, është rritur dukshëm nëpër spitalet dhe poliklinikat e vendit, sidomos në Tetovë dhe në Shkup.

"Rastet e ditëve të fundin kanë qenë në rritje dhe gjithçka fillon me dhimbje fyti, që shoqërohet me kollë dhe sekrecione", thotë për ga-

zetën tone, dr. Imran Sadiku, mjek në poliklinikën e Bit Pazarit. Ndërkaq nga Spitali i Tetovës njoftohemi se ulja e temperaturave te pacientët manifestohet me tharje e djegie te fytit, teshtitje, lodhje, dobësi, kollë të thatë. Siç na e konfirmon edhe dr. Rexhep Emurllai, bëhet fjalë për tipe të ndryshme të viruseve, që në këto periudha e

gjejnë rrugën për zhvillimin e vet dhe rritjen e tyre. Kjo manifestohet sidomos ditëve e ftohta të dimrit kur grumbullimi i njerëzve në ambiente të mbyllura favorizon përhapjen e infeksioneve. Një përparësi në këtë aspekt paraqet ndërprerja e procesit arsimor i cili parandalon prekjën e viruseve te grupmoshat e fëmijëve.

Në ndërkohë, 202 raste të të sëmurëve nga gripi janë regjistruar deri para dhjetë ditëve në Republikën e Maqedonisë, theksohet në raportin të cilin në ueb faqen e tij e publikoi Instituti i Shëndetit Publik. Raporti i ri i të sëmurëve nga gripi nga ky Institut pritet në ditët në vijim. Numri më i madh i të sëmurëve janë të moshës prej 15-64 vjet, ndërsa incidenca më e madhe prej 14.5 në 100.000 banorë është regjistruar te personat e moshës mbi 65 vjet. Numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në rajonin e Njësisë rajonale Kostivar dhe në qendrat për shëndet publik në Tetovë dhe Kumanovë.

Mjekët sugjerojnë që qytetarët duhet të konsumojnë sa më shumë lëngje dhe fruta, si dhe t'iu ikin ambienteve të hapura të mbipopulluara. Qytetarët gjithashtu nuk duhet ta zëvendësojnë mjekun, duke konsumuar antibiotik në shumë raste.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E VRAPÇISHTIT

Rr. 100 PN, 1238 Vrapçisht

+389 (0) 42 332-378

info@komunavrapcisht.gov.mk

SHPALLJE

Për tjetërsim të tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë përmes ankandit publik elektronik

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronë e Republikës së Maqedonisë, paraparë me PAU - Projekt arkitektonik urbanistik, sipas pasqyrave tabelore në të cilat janë të parashtruara të dhëna për parcelat ndërtimore, për parcelat kadastrale të cilat janë të përfshira me parcelat ndërtimore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore, sipërfaqja për ndërtim, lartësia maksimale deri në varg, përqindja e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit, bruto sipërfaqja e zhvilluar për ndërtim, çmimi fillestar për m², çmimi total fillestar dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës.

1.G2 industri e lehtë dhe jo ndotëse - pasqyra tabelore nr. 1

Numri i parcelës ndërtimore	Numri i parcelës kadastrale	Emri i quajtur	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore (m ²)	Sipërfaqja e ndërtimit (m ²)	Lartësia maksimale deri në varg (m)	Përqindja e ndërtimit (%)	Bruto sipërfaqja e zhvilluar	Koeficienti i shfrytëzimit	Çmimi fillestar për m ² (denarë)	Çmimi fillestar total (denarë)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës (denarë)
GP1	Pjesë nga 199 dhe pjesë 201	Jastrebicë	3832.70	1040.49	8.00	27,15	/	0,54	61,00	233.794,00	233.794,00

- hapi minimal për ankand të tokës ndërtimore me qellim G2 industri e lehtë dhe jo ndotëse, është 10,00 denarë.

TË DREJTË NË PJESËMARRJE

Të drejtë në pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

- Persona fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD, si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të marrin të drejtën për pronësi të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.
- Persona juridik: persona juridik vendas, person juridik në pronësi të përzier, person juridik i themeluar nga person juridik dhe fizik të huaj, të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD por të cilat nën kushte të reciprocitetit mund të marrin të drejtën për pronësi të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik përmes mënyrës elektronike, përmes sistemit informativ të dhënë në internet faqen www.gradezno-zemijste.mk ku dokumentacioni i duhur parashtror në kopje të skanuar (në PDF formë), në të cilën është theksuar për cilën parcelë është fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë në përbërje të fletëparaqitjes, e kompletuar me dëshmitë të vijim (të parashtruara në original ose kopje të vërtetuara në noter):

- Fletëparaqitje nga parashtruesi, në të cilën janë të theksuara të dhënat për parashtruesin e fletëparaqitjes, të dhënat për tokën për të cilën bëhet fjalë në fletëparaqitjen dhe cili dokumentacioni parashtror në bashkëngjitje.
- Garanci bankare për seriozitet të ofertës për çdo parcelë ndërtimore e përcaktuar sipas pasqyrës tabelore të dhënë në këtë shpallje me afat të vlefshmërisë deri më 08.06.2019, me të cilën ofertuesi do të garantojë që nëse e merr statusin si ofertuesi më i volitshëm, do ta paguajë çmimin e arritur përfundimtar për tjetërsim të tokës ndërtimore në ankandin publik elektronik në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.
- Për personat fizik certifikatë të shtetësisë (jo më të vjetër se 6 muaj).
- Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës (jo më të vjetër se 6 muaj).
- Autorizim të rregulluar për autorizuesin i cili e përfaqëson personin juridik, gjegjësisht dëshmi për funksionin person përgjegjës i autorizuar për personin juridik.
- Deklaratë me të cilën parashtruesi i pranon kushtet e parapara në shpalljen.
- E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes të cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do të dërgohen emri i përdoruesit dhe shifra për qasje në internet faqen në të cilën do të zhvillohet ankand publik elektronik (për parashtruesit të cilët në fletëparaqitjen do të shkruajnë e-mail adresë të gabuar, Komuna Vrapçishte nuk e ka obligim të pranojë dhe të bëjë korigjime të saj)

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik, për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Komisioni pas skadimit të afatit për parashtrim të fletëparaqitjeve, përcakton a janë fletëparaqitjet e kompletuara dhe të parashtruara në pajtim me kushtet e shpalljes. Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të së njëjtave përmes mënyrës elektronike, në afat prej 24 orëve pas skadimit të afatit për parashtrimin e tyre, ku parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët kanë dorëzuar dokumentacion të plotë i'u dërgon edhe emër përdoruesi dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesit e fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar i'u dërgon njoftim për mospjesëmarrjen e tyre në ankandin publik.

Parashtruesit e fletëparaqitjeve janë të detyruar të kenë certifikatë digjitale elektronike (nënshkrim) që të mund të parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik dhe të marrin pjesë në të njëjtën.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelat ndërtimore të theksuara në pasqyrën tabelore nr.1 është 61,00 denarë për metër katror.

GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për çdo parcelë ndërtimore është e përcaktuar sipas pasqyrave tabelore të dhëna në këtë shpallje.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik sipas pasqyrës tabelore nr.1, mund të parashtrohen deri më 08.02.2019, në mënyrë elektronike përmes internet faqes në vijim www.gradezno-zemijste.mk.

Ankand publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim www.gradezno-zemijste.mk.

Ankand publik për GP1 do të fillojë më 12.02.2019, në ora 10:00, dhe i njëjti do të zgjat 15 minuta.

PROCEDURA

- Komisioni informon parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave përmes formës elektronike në afat prej 24 orëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e të njëjtave, ku parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgohet emër përdoruesi dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgohet kumtesë me arsyetimin se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
- Në ditën e mbajtjes së ankandit publik elektronik pjesëmarrësit kanë qasje në internet faqen me emër përdorues dhe shifër që e kanë marrë në e-mail adresë, të dërguar në formë të bashkëngjitur me paraqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik.
- Ankand publik elektronik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik, për secilin parcelë ndërtimore veç e veç.
- Ankandin publik elektronik e përcjell Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës së Vrapçishtit.
- Ankand publik elektronik fillon me publikimin e çmimit fillestar të tokës për metër katror, ndërsa realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve.
- Ankand realizohet "hap pas hapi" me ritjen e vlerës në çdo "hap" jo më pak se 10,00 denarë për Pasqyrën tabelore nr. 1.
- Ankand publik elektronik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në këtë shpallje, ku nëse në kalimin e dy minutave të fundit nga ana e pjesëmarrësve ofrohet ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta. Ankand publik vazhdon pa kufi derisa brenda intervalit kohor prej dy minutave ka ofertë të re.
- Pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin e ofertuesit më të volitshëm.
- Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik dhe në mënyrë elektronike ua dorëzon të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.
- Pas përfundimit të procedurës për ankand publik, Komisioni obligohet që në afat prej tre ditëve të punës të parashtrorë kërkesë për mendim deri te Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë në lidhje me propozim-tekstin e marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë.
- Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë obligohet që të parashtrorë mendim në lidhje me propozim-tekstin e marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga marrja e kërkesës për mendim. Nëse në afat prej 30 ditëve Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë nuk parashtror mendim, "do të konsiderohet për pozitive".
- Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë, Komisioni në afat prej tre ditëve të punës deri te ofertuesi më i volitshëm parashtror lajmërim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.
- Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga marrja e lajmërimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm obligohet që të paguajë mjetet dhe deri te Komisioni të parashtrorë dëshmi për pagesën e realizuar në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 10% të vlerës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës, por jo më shumë se 27.000,00 denarë si dhe dokumentacioni i tërësishëm i nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik (ë origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter).
- Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet brenda afatit të caktuar, garancia bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të arrihet marrëveshje dhe i njëjti nuk do të mund të merr pjesë në çdo ankand të ardhshëm të parcelës ndërtimore në fjalë.
- Nëse ofertuesi më i volitshëm i paguan mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankand publik brenda afatit të caktuar, ndërsa në bazë të dokumentacionit të parashtruar nuk mund të lidhë marrëveshje,

mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore nuk do t'i kthehen, garanca bankare e ofertës i aktivizohet dhe nuk do të lidhet marrëveshje.

16. Shuma e shpenzimeve të posaçme në procedurën për tjetërsim të tokës ndërtimore është 10% e verës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës, por jo më shumë se 27.000,00 denarë.

17. Në afat prej pesë ditëve të punës pas parashtrimit të dëshmisë për pagesën e realizuar dhe parashtrimit të dokumentacionit të kompletuar të nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik, Kryetari i Komunës së Vrapçishtit në emër të Republikës së Maqedonisë lidhë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë në formë elektronike përmes sistemit informativ.

18. Pas lidhjes së marrëveshjes Komuna e Vrapçishtit në afat prej një dite në mënyrë elektronike parashtror marrëveshjen deri te Departamenti për tatime, taksa dhe kompensime për përcaktim të tatimit të qarkullimit të patundshmërive. Blerësi obligohet që në afat prej 15 ditëve pas marrjes së vendimit për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive të paguajë tatimin dhe të parashtrorë dëshmi për pagesën e realizuar.

19. Pas parashtrimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të qarkullimit të patundshmërive, blerësi në afat prej 15 ditëve marrëveshjen në mënyrë elektronike e parashtror deri te noteri për kryerje të solemnizimit. Blerësi obligohet që solemnizimin ta realizojë në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të marrëveshjes te noteri kompetent.

20. Mosplotësimi i obligimeve nga pikat 17,18 dhe 19 të kësaj shpallje me faj të blerësit paraqesin bazë për ndërprerje të njëanshme të marrëveshjes ku 80% e shumës së përgjithshme të tjetërsimit nuk i kthehet blerësit.

21. Me marrëveshjen blerësi obligohet që në afat prej 9 muaj nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore që është me sipërfaqe mbi 5.000 m², gjegjësisht 12 muaj nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore që është me sipërfaqe mbi 5.000 m² të sigurojë leje për ndërtim të objekteve të parapara në pajtim me planin urbanistik sipas të cilit është tjetërsuar toka dhe të ndërtojë objektet në pajtim me planin urbanistik sipas të cilit është tjetërsuar toka, në afat prej dy viteve pas marrjes së lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtuar deri në 1.000 m², në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, gjegjësisht në afat prej katër viteve nga dita e marrjes së lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtuar mbi 1.000 m², në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, në të kundërtën, nëse blerësi nuk nxjerr leje për ndërtim brenda afatit të paraparë, gjegjësisht 4,5% nga çmimi i arritur i përgjithshëm në ankandin publik për tokën në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe secilin vit të ardhshëm të kalimit të afatit.

Ofertuesi më i volitshëm obligohet që të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim sipas marrëveshjes së arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore.

22. Përqindja minimale që duhet të jetë e ndërtuar në gjithsej sipërfaqen e zhvilluar për ndërtim të paraparë me planin urbanistik për parcelën e ndërtuar ndërtimore nuk duhet të jetë më e vogël se 30%.

23. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

24. Shpenzimet për procedurë noteriale dhe futje në evidencë të patundshmërive në Agjencinë për kadastrë të patundshmërive bien mbi blerësin e tokës ndërtimore.

25. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedurën për tjetërsim përmes ankandit publik nuk guxon ta japë tokën personave të tretë para plotësimi të obligimeve nga marrëveshja për tjetërsim të së njëjtës. Ndaleja për dhënie të tokës personave të tretë shënohet në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive.

26. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të parashtrorin apel deri te Komisioni në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik elektronik. Pas apelit me vendim Komisioni obligohet të vendosë në afat prej pesë ditëve pas pranimit të së njëjtës.

27. Kundër vendimit të sjellë nga ana e komisionit, i cili vendos në lidhje me apelin e parashtruar, pala ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Kryetari i komisionit
Besim Ramadani

Në propozim Ligjin për kafshët shtëpiake, i dorëzuar në Parlament, theksohet se pronarët e kafshëve shtëpiake (qenve shtëpiake) nëse refuzojnë, ose nuk i kastrojnë kafshët e tyre rrezikojnë të gjobiten me nga 100 euro. Ndërkohë, gjobat për personat juridik pritet të arrijnë deri në 700 euro

NISMË PARANDALUESE

TRAJTIM LIGJOR I KAFSHËVE SHTËPIAKE



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 8 janar - Me ndryshimet e reja të Ligjit për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve, dispozitat e të cilët pritet që javëve në vazhdim të votohen në Parlament, qentë patjetër do të duhet të pastrohen. Plotësimi i këtij ligji parasheh rritjen e gjobave për personat fizik dhe ata juridik të cilët nuk do t'ju përmbahen këtyre normave. Në arsyetimin ligjor thuhet se këto ndryshime bëhen me qëllim parandalimin e shumimit të pakontrolluar dhe të pakufizuar të shumë qenve endacak, pjesa dërmuese e të cilëve burojnë nga shumimi i kafshëve shtëpiake.

"Kur qentë shtëpiake të jenë në periudhën e riprodhimit, pronarët e tyre janë të obliguar që ti kastrojnë, në ambulancat e veterinarëve, spitalet apo klinikat tjera të autorizuara me ligj për ofrimin e shërbimeve për mbrojtje shëndetësore -veterinare. Në këto dispozita nuk përfshihen pronarët e qenve në qendrat të cilat kujdesin e

kanë të regjistruara. Të gjitha harxhimet në këto raste i bartin pronarët e qenve", thuhet në Propozimin Ligjin për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve. Grupi prej dhjetë deputetëve nga koalicioni LSDM-BDI, në propozim Ligjin për kafshët shtëpiake, i dorëzuar në Parlament, thekson se pronarët e kafshëve shtëpiake (qenve shtëpiake) nëse refuzojnë, ose nuk i kastrojnë kafshët e tyre rrezikojnë të gjobiten me nga 100 euro. Ndërkohë, gjobat për personat juridik pritet të arrijnë deri në 700 euro.

"Në rast se nuk respektohen dispozitat e nenit 27 të Ligjit për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve, personat fizik rrezikojnë të gjobiten. Gjoba prej 100 euro mund t'iu shqiptohet edhe në rast se pronarët e qenve një herë në viti nuk i realizojnë kontrollet në

ambulancat e veterinarëve, gjegjësisht nëse nuk shfaqin ndonjë tabelë e cila udhëzon në prezencën e qenve, nëse në vende publike nuk mbajnë maska. Gjoba po ashtu rrezikojnë të marrin edhe ata persona që nuk janë paraqitur se kanë pranuar një qen në shtëpitë tyre. Nga ana tjetër qendrat e kujdesit mund të gjobiten nëse nuk e ruajnë evidencën për kafshët shtëpiake katër vite pas kontrollit të Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë", thuhet në propozim Ligjin.

Sidoqoftë, përveç këtij ligji, në periudhën që vijon pritet të propozohen edhe tekste tjera ligjore që synojnë zgjidhjen e problemit të kafshëve endacak, të cilat janë prezente pothuajse në të gjitha qytetet e Maqedonisë. Qëndrimi i Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë është se kjo proble-

matikë nuk mund të zgjidhet vetëm me kastrimin e qenve, por se nevojitet ndalesë për shitjen e qenve dhe maceve nëpër shitore, gjegjësisht shitjen e tyre personave të mitur. Ndryshe, viteve të fundit qytetarët e Maqedonisë, krahas shumë problemeve komunale dhe urbane, shpesh herë janë ballafaquar me sulmet dhe kafshimet e qenve endacak. Si rezultat i këtyre sulmeve vitin e kaluar në qytetin e Gostivarit një vajzë e mitur, duke tentuar ti ikë sulmit nga qentë endacak, ra në lumin Vardar, me çka pas disa orës u gjete vdekur. Në mungesë të veprimeve adekuate institucionale, shumë qytetar të indinjuar dhe të frikësuar për sigurinë e të afërmeve të tyre, në parqe publike dhe vende të ngjashme vazhdojnë të hedhin substanca helmuese kundër qenve endacak.

KRONIKË

Dy të arrestuara në Gostivar, u kapën me kokainë

Në orët e para të mëngjesit të ditës së martë, në rrugën "Mladen Gruevski" në Gostivar janë arrestuar 21-vjeçarja Sh.O dhe 35 vjeçarja Z.R nga fshati Rostushë. Gjatë kontrollit të kryer ndaj tyre, është gjetur kokainë dhe dy femrat janë mbajtur në Stacionin policor në Gostivar për procedurë të më tutjeshme.

Incident në lagjen e Romëve

Të hënën mbrëma, një 17-vjeçar ka denoncuar se në rrugën "29 nëntori", në Tetovë, në të ashtuquajturën Lagja e Romëve, është prishur rendi dhe qetësia publike me zënkë fizike, në të cilën kanë marrë pjesë më shumë persona. Në vendin e ngjarjes, menjëherë janë dërguar pjesëtarët e policisë, të cilët kanë marrë masa adekuate për qetësimin e situatës dhe zbardhjen e kësaj rrahje, të cilët si shenjë paralajmërimi dhe ndarjes së pjesëmarrësve në këtë prishje të rendit, edhe janë shtënë edhe disa plumba në ajër. Në vendin e ngjarjes janë privuar nga liria R.K. 42 vjeçar, dhe S.K. 41 vjeçar nga Tetova, derisa dy persona të mitur të moshës 17 vjeçare, gjithashtu nga Tetova të involvuar në këtë rast, pas dhënies së ndihmës mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës, janë sjellur në Stacionin policor në Tetovë. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit, edhe atë në identifikimin e të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në këtë rrahje, motivet dhe të gjitha detajet në veçanti njofton policia e Tetovës.

Vjedh veturën, arrestohet 33-vjeçari

55-vjeçari A.J nga Gostivari, të martën mbrëma ka denoncuar se deri më tani, person i panjohur e ka marrë veturën e tij "Opel Astra" me targa të Gostivarit, e cila ka qenë e pa mbyllur dhe me çelësin në brendi të cilën e ka parkuar në parkingun përpara ndërtesës, në rrugën "Mara Ugrinova" në Gostivar. Menjëherë vetura është gjetur në lagjen "Cigllana 1", por në shumë vende me dëmtime të dukshme. Rasti është fotodokumentuar dhe për këtë vepër dyshohet 33 vjeçari E.P nga Gostivari, i cili është privuar nga liria njofton policia e Gostivarit.

Aksident në Tudencë, lëndohet 66-vjeçari

Të martën në mëngjes rreth orës 07 e 30 minuta, në rrugën lokale Kopanicë-Tudencë, në fshatin Tudencë, ka ndodhur aksident trafiku në të cilën kanë marrë pjesë dy vetura me targa të Tetovës edhe atë vetura e tipit "Shevrolet" e drejtuar nga 63-vjeçari J.J. nga Tetova dhe vetura e tipit "Fiat", të cilën e ka drejtuar 61-vjeçari Z.P. nga fshati Jançisht. Vozitësi i veturës "Shevrolet" me anë të një veture tjetër është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës, ku është mbajtur për mjekim të më tutjeshëm. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes, dhe punohet në përcaktimin e shkakut të aksidentit, rrethanat në të cilat ka ndodhur si dhe gjitha detajet në veçanti njofton Sektori për punë të brendshme përmes një kumtese me shkrim. (U.H)

Karburantet lirohen deri në 3 denarë

Shkup, 8 janar - Karburantet prej mbrëmë në mesnatë janë liruara për 2.5 denarë për një litër, vendosi Komisioni Rregullator për Energjetikë. Me vendimin bëhet zvogëlimi i çmimeve rafinerike dhe të çmimeve me pakicë të derivateve të naftës në mesatare prej 8.17, gjegjësisht për 5.51 për qind. Çmimet me pakicë të benzinave zvogëlohen për 2.5 denarë për një litër dhe çmimi i ri i EUROSUPER BS-95 do të jetë 58.5, ndërsa i EUROSUPER BS-98, 60.5 denarë për një litër. Karburantet dizel lirohen për tre denarë për një litër. Çmimi i ri me pakicë i EURODIZEL (D-E V) është 55 ndërsa i Vajit ekstra të lehtë për amvisëri (EL-1) 43.5 denarë për një litër. Me vendimin e KRRE për 2.227 denarë për një kilogram zvogëlohet edhe çmimi me pakicë i mazutit M-1 NS dhe tani do të jetë 25.949 denarë për një kilogram. Si arsye për uljen e çmimeve me pakicë të derivateve të naftës nga KRRE i theksojnë për 9.38 për qind çmimin mesatar më të ulët të naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara dhe për 0.274 për qind të kursit më të ulët të denarit në raport me dollarin.

Shkup, 19 lënduar në 22 aksidente

Shkup, 8 janar - Dy persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa 17 lëndime të lehta trupore në 13 prej gjithsej 23 aksidenteve të trafikut që kanë ndodhur në katër ditët e fundit në Shkup. Në 10 aksidente trafiku është shkakuar dëm material. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, policia ka sanksionuar 139 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 23 të cilët kanë drejtuar automjetet nën ndikimin e alkoolit, 35 para se ta fitojnë të drejtën e patentës së shoferit dhe 11 fillestarë. Nga komunikacioni është përjashtuar edhe një automjet i cili ka pasur probleme teknike, 34 automjete të pa regjistruara, ndërsa policia ka sanksionuar 211 automjete të

parkuara në mënyrë jo të drejtë. Me automjetin special "karrotrec" janë larguar 130 automjete. Janë sanksionuar edhe një këmbësori i cili ka kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësor, pesë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe, 15 kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, nëntë shoferë nuk u kanë dhënë të drejtë kalimi këmbësorëve në vendkalimet për këmbësorë, shtatë për reshtim jo të drejtë, tre për tejkalim jo të drejtë, një shoferë për mos dhënie të drejtë kalimi automjeteve në zonën të udhëkryqit, 16 për mos posedim të pajisjeve të parapara dimëror në automjet, tre për mos mbajtjen e rripit të sigurimit dhe 21 për shfrytëzim të telefonit celular.

RETRO: POLITIKA MAQEDONASE, NJË SFINGË E RREZIKSHME



Nga
Emin AZEMI

Politikanët maqedonas po punojnë për interesa të shqiptarëve. Vetëm një politikë e çmendur si kjo që aktualisht udhëhiqet nga Georgievski, mund të krijojë armiqësi me Perëndimin. Shqiptarët në këto raporte mund të jenë fituesit më të mëdhenj, jo vetëm moral. A ka mundur Georgievski ta refuzojë variantin e fundit të dokumentit të Leotarit dhe Perdjusë pa e fyer dhe shantazhuar Perëndimin? Sigurisht se po. Mirëpo në pyetje është diçka tjetër. Është ajo politika absurde e ekuidistancës, e trashëguar nga Gligorovi, në kohën e krizave në Kosovë, Bosnjë, Kroaci e Serbi. Ekuidistanca u pat shpikur atëherë vetëm sa për të kamufluar flartimet interne të kreut shtetëror maqedonas me të gjitha ato shtete e forca që nuk gëzonin simpati në Perëndim. Prandaj në kohën e lulëzimit të ekuidistancës së Gligorovit, në Maqedoni lulëzonte biznesi ilegal me Serbinë, por edhe me Greqinë. Në njërin anë Perëndimi i bënte bllokada regjimit të Millosheviqit, kurse në anën tjetër kompanitë dhe bankat maqedonase ishin urat më efikase të transaksioneve të pista financiare pikërisht të atij regjimi.

Në këtë mënyrë Maqedonia është paraqitur në botë në formën e njëfarë sfinge mashtruese - mirë me të gjithë jashtë, e keq me të gjithë brenda. Ky qëndrim hermafrodit i Maqedonisë rezultoi edhe në ndryshimin e Kushtetutës, pas presionit grek, prandaj maqedonasit kot krekosen se nuk do ta ndërrojmë Kushtetutën kur atë veç e kanë ndryshuar një herë. Që absurdi të jetë më i madh Kushtetuta e Maqedonisë u ndryshua për të kënaqur ambiciet e fqinjëve, kurse tani ajo kundërshohet të ndryshohet vetëm pse ndryshimin e saj e kërkojnë qytetarët e brendshëm të saj.

Asnjëherë nuk ka ndodhur të mobilizohen popat, kasapët, berberët, shkrimtarët, politikanët, gazetarët maqedonas, madje edhe atëherë kur Bullgaria nuk e ka pranuar identitetin e popullit maqedonas, as atëherë kur Serbia e ka mohuar autoqefalinë e kishës maqedonase, as atëherë kur Greqia ka mohuar emrin e shtetit, sa tani, kur shqiptarët kërkojnë që në shtetin e tyre, në institucionet e tyre, në universitetet e tyre të përdorin zyrtarisht edhe gjuhën shqipe. Një refuzim kaq rigjid ndaj kërkesave civilizuuese të qytetarëve të brendshëm dhe një inferioritet kaq i skajshëm ndaj

mohimeve që vijnë nga jashtë, flet për anomalitë e një politike dhe instrumentalizimin e një populli. Faturat e kësaj anomalie mund t'i pagujnë të gjithë, e më së tepërmi ata që forcën e tyre e mbështesin në principialitetin dhe durimin e tjetrit. Maqedonasit, me këtë eufori ksenofobike ndaj gjuhës shqipe munden të ngelin shembull i një destruktiviteti të paparë, me rrezik që të atakohet nga instrumentet e komunitetit ndërkombëtar. Millosheviq në Hagë, është modeli më ilustrativ i zbatimit të këtyre instrumenteve.

SHQIPTARËT PYESIN

A ka Uashingtoni dhe Brukseli spitale për shërimin e alergjisë maqedonase ndaj gjuhës shqipe?

Në vend se shqiptarët të shprehin pakënaqësi ndaj këtyre të drejtave të dozuara që u jepen dhe në vend se të pasonte ndonjë reagim më i ashpër i UÇK-së, në stilin se "përdorimin e gjuhës amtare shqipe mund ta siguronim edhe pa kapjen e armëve", tani ndodh e kundërta.

Maqedonasit reagojnë dhe ata para botës paraqiten si viktimë e ndryshimeve të reja kushtetuese. Viktimë e këtyre ndryshimeve tani paraqitet edhe koncepti i shtetit,

duke manipuluar opinionin e brendshëm dhe të jashtëm se gjoja zyrtarizimi i gjuhës shqipe po i jipka fund konceptit unitar të shtetit Presioni që mund t'i bëhet palës maqedonase nga ana e komunitetit ndërkombëtar pas refuzimit të dokumentit të fundit të ndërmjetësve Leotar e Perdju, është krahasuar nga kryeministri Georgievski me presionin që NATO i ka bërë Millosheviqit para dy viteve. "Deri më tani dëgjua kërcënime nga më të ndryshmet. Shpresoj se të premten apo të shtunën do të marrim edhe kërcënimin se do të na bombardojnë",-ka thënë Georgievski të mërkurën para gazetarëve.

Reagimet e palës maqedonase pas publikimit të versionit të fundit të projekt-dokumentit të marrëveshjes politike, i cili, në mes tjerash parashihet edhe zyrtarizimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet, janë iracionale, për vetë maqedonasit, por lehtësuere për shqiptarët. Propozimi i ndërkombëtarëve që mundohet të korrigjojë një gabim trashanik, sa i përket përdorimit të gjuhëve, e sidomos për popullatën shqiptare që përbën mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të banorëve të Maqedonisë, nga Georgievski është konsi-

A do të lejojë faktori ndërkombëtar që dialogu të konsiderohet i suksesshëm vetëm atëherë kur pala maqedonase të jetë plotësisht e kënaqur, gjegjësisht atëherë kur orekset maqedonase do të kënaqen nëse në Maqedoni vazhdon dominimi gjuhësor, arsimor, kadrovik, policor, ushtarak, ekonomik e fetar maqedonas mbi shqiptarët dhe jomaqedonasit tjerë



deruar "përzierje në punët e brendshme të Maqedonisë". Tekstin e këtij dokumenti, Georgievski e ka quajtur brutal, kurse punën e ndërmjetësve e ka kualifikuar si "stil kauboj" që "mundohen të thyjnë institucionet legale të shtetit." Georgievski vetëm sa nuk tha se Stejt Departamenti Amerikan dhe Bashkimi Evropian janë bërë stalla dhe poligone për stërvitjen e kaubojve të tipit të Robertsonit, Sollarës, Perdjusë, Leotarit etj.

SI VEPROJNË KAUBOJTË KUR I FYEN NJË PICIRRUK?

Mosdurimi ndaj politikës ndërkombëtare, që aktualisht mundohet të japë rezultate edhe në Maqedoni, ka vënë maje me akuzën e hapur të Georgievskit ndaj Perëndimit. "Ranë maskat. Tanimë është e qartë se këto aksione terroriste në Maqedoni seriozisht mbështeten dhe kanë përkrahje logjistike nga demokratët Perëndimorë, gjë që flet për një skenar për thyerjen e Republikës së Maqedonisë",- deklaroi kryeministri maqedonas.

Pas gjithë këtyre akuzave dhe shpifjeve nga më të ulëtat në adresë të Perëndimit, a thua do të vazhdojë edhe më tutje përkëdhelja e Geor-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë, 8 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

gievskit dhe politikanëve si ai, nga ana e diplomatëve të huaj. Kur një politikan i vogël, i një shteti të vogël dhe i një populli të vogël flet gjëra të pavërteta, që mundohet t'i ambalazhojë si pakënaqësi në adresë të diplomatëve Perëndimorë për gjoja lëshimet që u bëhen shqiptarëve, atëherë Perëndimi seriozisht duhet të mendojë se ku ka investuar deri më tani dhe a duhet edhe më tutje t'i japë përkrahje blanko politikës maqedonase. Ose si veprojnë kaubojtë e vërtetë kur i fyen një picirruk?

Kur një segment mjaft atraktiv dhe civilizues, siç është përdorimi i gjuhëve, kontestohet me një fjalor të tillë barbar dhe kur ekzistimi i shtetit vihet në pikëpyetje (artificialisht) nëse edhe gjuha shqipe merr status zyrtar, kjo flet për çmendurinë që e ka kapluar politikën zyrtare maqedonase, e cila nuk e ka edhe sensin më të vogël se ku mund të shpiejë vendin një sjellje e tillë iracionale. Në vend se shqiptarët të shprehnin pakënaqësi ndaj këtyre të drejtave të dozuara që u jepen dhe në vend se të pasonte ndonjë reagim më i ashpër i UÇK-së në stilin se, "përdorimin e gjuhës amtare shqipe mund ta siguronim edhe pa kapjen e armëve",- tani ndodh e kundërta. Maqedonasit reagojnë dhe ata para botës paraqiten si viktimë e ndryshimeve të reja kushtetuese. Viktimë e këtyre ndryshimeve tani paraqitet edhe koncepti i shtetit duke manipuluar opinionin e brendshëm dhe të jashtëm se gjoja zyrtarizimi i gjuhës shqipe po i jipka fund konceptit unitar të shtetit. E vërteta është krejt tjetër. Zyrtarizimi i gjuhës shqipe mund t'i jep fund vetëm konceptit shovenist të polikanëve maqedonas, të cilët kur flasin për gjuhën shqipe, flasin me urrejtje dhe këtë e bëjnë duke e favorizuar artificialisht rëndësinë e gjuhës maqedonase. Politikanët, intelektualët, gazetarët maqedonas as që duan të dëgjojnë për gjuhën shqipe, dhe duke refuzuar atë ata refuzojnë edhe popullin shqiptar në Maqedoni. Kjo vërteton faktin se maqedonasit duan të komunikojnë me shqiptarët vetëm sipas rregullave që ata i paramendojnë. Ata e duan bashkëjetesën me shqiptarët vetëm duke komunikuar maqedonisht dhe shqiptari është i obliguar të dijë maqedonisht për të mbetur gjallë në këtë alamet shtet.

MAQEDONIA, FEDERATË E MAQEDONASIT TË PRIVILEGJUAR DHE SHQIPTARIT TË DISKRIMINUAR

Koncepti qytetar, i preferuar nga Georgievski dhe kompania, nënkupton qytetarin maqedonas që në mëngjes ngrihet me bindjen se gjuha shqipe duhet të përdoret vetëm në familje, që në drekë e zhvillon idenë se shqiptarët nëpër

komuna duhet të shtypen me policë që i dërgon Shkupi dhe ngrysen me kënaqësinë që ia jep koncepti qytetatar se në Maqedoni duhet të funksionojë një tip tjetër i federatës së qytetarëve me më shumë të drejta dhe i qytetarëve me shumë më pak të drejta. Qytetari maqedonas nuk e di se ky tip i federatës aktualisht funksionon për mrekulli dhe atë e përbëjnë lagjet "Dizhon" dhe "Aerodrom", "Cerovë" dhe "Kozle", "Gazi Babë" dhe "Lisiçe", "Vizbeg" dhe "Vodno" në Shkup.

Diferencat sociale, urbanistike, infrastrukture të kësaj federate nuk mund të shihen vetëm nga aeroplanët rus të tipit SUHOJ, por mund të shihen për mrekulli nga helikopterët e NATO-s, që fluturojnë ulët.

Kot politikanët, gazetarët, priftërinjtë, shkrimtarët, akademikët maqedonas e çajnë gurmazin kur thonë se Maqedonia do të ngelë unitare dhe nuk do të lejojnë federalizmin e saj, kur një federalizim i tillë po ndodh në praktikë në mes të lagjeve me pusa uji dhe baltë, me rrugë të paasfaltuara dhe të pandriçuara, me mungesë të telefonisë, pa çerdhe fëmijësh e ambulanca, në njërën anë, dhe lagjeve me parqe dhe gjelbërime të kultivuara, me pishina dhe me fitnes-klube, me fusha të improvizuara sportive dhe me çerdhe fëmijësh, me restorante luksoze dhe diskoteka për të rinj, me trotuare dhe llambadarë vizlues nëpër trotuare, me vila dhe shtëpi me plan (shumica të ndërtuara me ryshfete të marra nga hallexhinjtë shqiptarë), në anën tjetër.

Ky tip i federatës në mes të qytetarëve që ecin rrugëve të pandriçuara dhe atyre të ndriçuara, në mes të qytetarëve që jetojnë në shtëpi gati për t'u rrezuar dhe aty-

re që jetojnë në pallate 3 katëshe, në mes të qytetarëve që mezi sigurojnë t'i shkollojnë fëmijët deri në klasën e tetë dhe atyre që fëmijët e tyre i dërgojnë në Londër, Paris, Nju Jork, Vjenë për shkollim, në mes të qytetarëve që presin me vite në byron për punësim dhe qytetarëve të cilët familjarisht punojnë nëpër "Skopska Pivara", nëpër "Stopanska" e "Komercijalna Banka", nëpër "Alkaloida", nëpër "Ohisa", nëpër sportele të administratës shtetërore etj., ka funksionuar këtu e 50 vjet në Maqedoni dhe shqiptarët gjithmonë kanë shpresuar se procedurat demokratike do t'u ndërrojnë atyre statusin e qytetarëve të rendit të dhjetë. Prandaj të gjithë ata që akuzojnë shqiptarët se janë për federalizim të Maqedonisë rrejnjë. Përkundrazi, shqiptarët janë për eliminimin e federatës në mes të qytetarit maqedonas, që jeton në pallat, me oborr të mbuluar me gjelbërim, dhe të rrethuar me llambadarë të "Elektrostopanstvos" dhe gjoja qytetarit shqiptar që jeton në një kasollë në "Dizhon", që pret për çdo ditë, si lepuri në kaçubë, vendimin për rrenimin e shtëpisë. Në Maqedoni edhe maqedonasit jetojnë në shtëpi pa leje, por atyre nuk u prishen shtëpitë, sepse ata që urdhërojnë prishjen e shtëpive janë maqedonas, e maqedonasi nuk ia prish maqedonasit shtëpinë. Ky është koncepti qytetar i shtetit, sipas Georgievskit, Trajkovskit, Cërvenkovskit, Andovit etj.

SHQIPTARI DUHET TË BËHET MAQEDONAS PËR TË QENË QYTETAR!

Si do të duket dialogu politik pas këtyre reagimeve të politikanëve maqedonas? Për çka do të bisedojnë liderët shqiptarë, nëse jo për gjuhën, jo për kompetencat e pushtetit vendor mbi po-

licinë, jo për mundësimin e organizimit të arsimit universitar në gjuhën shqipe. A do të lejojë faktori ndërkombëtar që dialogu të konsiderohet i suksesshëm vetëm atëherë kur pala maqedonase të jetë plotësisht e kënaqur, gjegjësisht atëherë kur orekset maqedonase do të kënaqen nëse në Maqedoni vazhdon dominimi gjuhësor, arsimor, kadrovik, policor, ushtarak, ekonomik e fetar maqedonas mbi shqiptarët dhe jomaqedonasit tjerë.

Në anën tjetër a do të pranojnë shqiptarët, që kërkesat e tyre së pari të testohen se si tingëllojnë në veshin e një maqedonasi të thjeshtë. Me fjalë të tjera, shqiptarët për një moment duhet të bëhen maqedonas, për t'u vërtetuar se sa rëndë është të kesh pranë një bashkëfolës që komunikon shqip.

Në fakt ky është koncepti qytetar sipas kutit të Georgievskit, Trajkovskit, Cërvenkovskit, që shqiptarët të bëhen maqedonas për t'i kuptuar sikletet maqedonase kur dëgjojnë fjalë shqipe dhe mundësisht has shqiptar të mbeten vetëm nëpër shtëpi private (pa lejet e Ballkovskit), në pazar të hajvanëve, në ndonjë synet dygyni, në kanagjegje etj. Të jesh qytetar, sipas variantit që propozojnë politikanët maqedonas, është të heqësh dorë nga identiteti yt nacional dhe të vishesh me petkun e një identiteti tjetër nacional.

Pra, patjetër shqiptarët duhet të frymojnë maqedonisht, të flasin maqedonisht, të flejnë maqedonisht, të dhiejnë maqedonisht, të shohin ëndrra maqedonisht, t'i shkollojnë fëmijët maqedonisht, të pijnë ujë maqedonisht, të notojnë në Matkë maqedonisht, të hajnë akulllore maqedonisht, të zënë peshq maqedonisht, të fi-

shkëllojnë maqedonisht, të gjëmojnë në VC maqedonisht, të pordhin maqedonisht, të flasin në Parlament maqedonisht, të komunikojnë maqedonisht me të afërmit në Shutkë dhe në Idrizovë, të thithin ajër maqedonisht, të rrëshqasin në borë maqedonisht, të këndojnë maqedonisht (se këngët shqipe po ia mbushin bateriat UÇK-së), të tancojnë maqedonisht, t'i qethin flokët maqedonisht, të përshëndeten maqedonisht, t'i ujisin arat me shi maqedonas, të rreziten buzë bregdetit të liqenit të Ohrit nën diellin maqedonas, të hajnë bukën me djath maqedonas, të freskojnë ballin me ajër maqedonas, të shohin vetëm filma maqedonisht të financuar nga shteti, të shohin prej Struge e Kumanove kryqin ortodoks mbi Vodno të Shkupit etj.

KUR ALERGJIA SHNDËRROHET NË EPIDEMI

Alergjia maqedonase ndaj gjuhës shqipe, ka të ngjarë që të shndërrohet në një sëmundje të rrezikshme, me pasoja katastrofale për të gjithë ne. Ajo që është më tragjike në gjithë këtë rrefim, është stadiumi shpirtëror e shëndetësor i opinionit maqedonas. Në fakt shpërndarësit e alergjisë, që aktualisht ndodhen nëpër kabinetet e qeverisë, presidencës, parlamentit, sinodit të shenjtë të KOM, nuk mbajnë shumë llogari për shëndetin kolektiv të maqedonasve.

Aq sa është joreale frika nga përdorimi i gjuhës shqipe, aq më reale mund të bëhet sëmundja e maqedonasit, që shumë lehtë mund të kalojë edhe në ksenofobi esktrême.

Një qytetar i lajthitur dhe i painformuar maqedonas i Shtipit, kur dëgjon nga goja e kryeministrit se sa e rrezikshme mund të bëhet jeta në Maqedoni nëse lejohet zyrtarizimi i gjuhës shqipe, ai do të përdorë të gjitha mjetet për ta larguar këtë rrezik. Stili ballkanik i largimit të rreziqeve të tilla nënkupton djegien e pronave të shqiptarëve, organizimi i bandave paramilitare, kidnapimi i shqiptarëve etj. Në këtë mënyrë një alergji e tjeshtë ndaj një vlere civilizuese, siç është gjuha shqipe, mund të shndërrohet në një epidemi të rrezikshme, me përmasat e mosdurimit ndëretnik, refuzimit të gjithçkasë që s'është maqedonase dhe ortodokse, shkatërrimit të gjithkasë që është shqiptare e kështu me radhë.

Pyetjen e vetme që mund ta bëjnë shqiptarët aktualisht është se a ka në Uashington apo në Bruksel ndonjë spital që mund të shërojë këtë lloj të alergjisë maqedonase.

(Editorial i botuar në FAKTI, korrik 2001)



Nga njëra anë, janë jo-muslimanët që kryejnë akte terrorizmi në bazë të besimeve personale apo edhe fetare, dhe që perëndimorët i shohin si dishepuj. Nga ana tjetër, është çdo mysliman që i nënshtrohet propagandës së bazuar tek idetë jo-islamike dhe jo-fetare të Shtetit Islamik. Dhe ekziston një rreth i ngushtë myslimanësh, që thotë se veprimet terroriste se rrjedhin nga mësimet kuranore

Nga Sajad ABEDI

Aktet e përhapura të përhapura terroriste, dhe ngjarjet katastrofike të vitit 2016 në Evropë, kanë zbuluar qasje të reja të grupimeve ekstremiste dhe radikale, të cilat kanë shkaktuar frikë në mesin e perëndimorëve. Hetimi i akteve shkatërrimtare të z viteve të fundit, ka treguar se operacione të tilla terroriste, janë bazuar në qasje të rrjetëzuara dhe të koordinuara. Pra, celulatat terroriste i kryejnë operacionet e tyre destruktive, bazuar në një plan të përbashkët të koordinuar. Në rrethana të tilla, është e mundur të vëzhgohen sjellje të tilla, duke pasur parasysh familjaritetin e rojeve të sigurisë dhe agjencive të inteligjencës në Evropë, por është e vështirë të ndryshohen qasjet për monitorimin e veprimeve të tilla si ato të vitit të kaluar.

Në vend se të marrin masa kolektive, terroristët përdorin mjetet e veprimeve destruktive në mënyrat e tyre të reja. Në një situatë të tillë, një person vret në vende publike, në vend se të komunikojë me mbështetësit ose anëtarët e rrymave terroriste si ISIS-it. Për një qasje të tillë bëhen përgjegjës ngjarje si Kryqëzata Naziste Franceze, ose tubimi i njerëzve në Gjermani. Natyrisht, përdorimi i metodave të tilla, dhe përdorimi i automjeteve të transportit publik, madje edhe shkopinjeve dhe pajisjeve të ndryshme, u ka krijuar shumë vështirësi agjencive të sigurisë dhe atyre të inteligjencës në zbulimin e elementëve kriminalë.

Dëshmitë sugjerojnë se në qasjet e reja, ISIS-i po tenton të përdorë çdo mjet për të arritur qëllimet e tij, dhe është e natyrishtme që në rrethana të tilla, koncepti i sigurisë në Evropë të ketë pësuar një ndryshim. Nga një perspektivë tjetër, përdorimi i praktikave të tilla, tregon se Shteti Islamik është

GABIMI STRATEGJIK I PERËNDIMIT NË LINDJEN E MESME



duke synuar të përdorë çdo mjet për të dëshmuar fuqinë e tij. Xhihadistët urdhërojnë që rekrutët të mos jenë të detyruar domosdoshmërisht të udhëtojnë për diku tjetër. Por agjentët proactive, mund t'i orientojnë lëvizjet e tyre subversive në të njëjtin vend. Faktet tregojnë se "ujqërit e vetmuar" që përdoren nga grupet terroriste të ISIS, bazohen tek nxitja e kësaj kauze. ISIS përpiket gjithnjë të organizojnë njerëz nga të gjitha cepat e botës, për të kryer akte terroriste. Ata njihen si "ujqër të vetmuar" për shkak të natyrës së izolimit dhe frustrimit psikologjik. Kjo është arsyeja se përse, ky grup konsiderohet aktualisht si organizata terroriste më e rrezikshme në botë.

Në situatën aktuale, edhe pse mundësia e përmbyesjes dhe mposhtjes së ISIS-it në rajon dhe eliminimi i rrezikut të formimit të një Emirati Islamik të Irakut dhe Sha-

malit, duket i mundshëm, është e rëndësishme të kuptohet se grupimet e ndryshme, përfshirë ISIS-in dhe terroristët e organizuar grupe, bazohen tek një ideologji e caktuar. Duket se në një rast të tillë, shpërbërja e organizatës nuk do të zhdukë idetë e ISIS-it, por ata që kanë një formim të tillë, do të ngrenë rrjete nëntokësore, dhe do të vazhdojnë operacionet e tyre terroriste. Ndërsa politika e rreme e Perëndimit për përdorimin e dyfishtë të terrorizmit kundër zhvillimeve në rajon, veçanërisht në Irak, Jemen, Siri dhe Libi, është një kontribues i madh për terrorizmin, emigrimin e qytetarëve nga vende të ndryshme në Evropë nga Siria, dhe rikthimin e terroristët perëndimorë në Evropë.

Sot, më shumë se çdo vend tjetër Evropa është objekt i sulmeve të ISIS-it, unioni që në zhvillimet në Siri mori pozicionet më të

forta në mbështetje të grupeve të armatosura të papërgjegjshme, dhe disa grupeve terroriste. Ne jemi tashmë dëshmitarë të një uniteti të pashenjtë midis rrymave dukshëm laike që pretendojnë lirinë, me rryma radikale fashiste, dhe konsensusin e tyre mbi kufizimin e grupeve islamike dhe shtypjen e muslimanëve. Në fakt, tani, Perëndimi nuk kapet vetëm pas incidenteve terroriste të ISIS, por gjithashtu kërcënohet nga njerëz ekstremistë të djathtë, që janë zotuar të ndalin hyrjen e myslimanëve në vendet e tyre, për shkak të islamofobisë. Të njëjtët grupime, që i kanë trajtuar azilkërkuesit, si parulla me synim fitimin e zgjedhjeve.

Nga njëra anë, janë jo-muslimanët që kryejnë akte terrorizmi në bazë të besimeve personale apo edhe fetare, dhe që perëndimorët i shohin si dishepuj. Nga ana tjetër,

është çdo mysliman që i nënshtrohet propagandës së bazuar tek idetë jo-islamike dhe jo-fetare të Shtetit Islamik. Dhe ekziston një rreth i ngushtë myslimanësh, që thotë se veprimet terroriste se rrjedhin nga mësimet kuranore. Së bashku me këtë, duhet të theksohet se Perëndimi është plotësisht i vetëdijshëm për rolin e Arabisë Saudite në mbështetjen aktuale të terrorizmit. Provat flasin qartë për mbështetjen financiare dhe shpirtërore të vendit për selefistët xhihadistë që nga vitit 2001 dhe Sefelistët Tekfirë që nga viti 2011.

Kjo pohohet edhe në një raport 28-faqësh i Senatit Amerikan. Megjithatë, nuk bëhet asnjë përpjekje nga vendet perëndimore për të ushtruar presion mbi Arabinë Saudite, apo për të ndryshuar marrëdhëniet politike, ushtarake dhe ekonomike me vendin. Në fillim të formimit të ISIS-it, Perëndimi shpresonte që me shkuarjen e islamistëve radikalë në Siri dhe Irak, dhe me shfaqjen e konflikteve mes vendeve islamike, detyra e Tekfiristëve do të ishte plotësisht e përcaktuar, dhe vendet e rajonit do të të përfshiheshin në konfliktet fisnore. Natyrisht, në Perëndim u mendua naivisht se pasiguria e rajonit do të ofronte një platformë për islamizmin, dhe siguronte pranimin e tyre më aktive në Lindjen e Mesme dhe në Azinë Perëndimore. Por më pas pamë që kjo u kthye në bumerng për Perëndimin dhe solli ISIS-in në zemër të Evropës.

Natyrisht, jo të gjitha sulmet terroriste në Evropë, mund t'i atribuohen organizimit të ISIS-it. Dhe duket se premisa themelore e terroristëve, bazohet kryesisht tek mendimi dhe arsyetimi i tyre, si për shembull problemet familjare dhe mendore, mbi veprimet subversive. Megjithatë, ISIS-i përdor të gjitha kapacitetet e saj mediatike, për të përfutur nga këto veprime, dhe është përpjekur ta zmadhojë aftësitë e saj operacionale, duke caktuar si përgjegjës individë që ndonjëherë kanë vdekur si pasojë e veprimeve terroriste dhe sulmeve vetëvrasëse.

Nga ana tjetër, terrorizmi duhet të shihet si një çështje globale, dhe në të njëjtën kohë duhet të theksohet se politika e jashtme e disa vendeve dhe ndërhyrja e tyre në punët e vendeve të tjera, është një nga faktorët e shfaqjes dhe përhapjes së terrorizmit. Këto vende, duhet të rishikojnë politikën e tyre, për të garantuar një bazë realiste për eliminimin e terrorizmit.

(bota.al)



MOGHERINI UA KËRKON EKIPIT NEGOCIATOR HEQJEN E TAKSËS NDAJ SERBISË



“Taksat janë i vetmi mjet që Kosova e ka si politikë e jashtme për të bërë presion ndaj Serbisë. Zonja Mogherini e përmendi që kjo nuk është në frymën e dialogut dhe se duhet të krijohet klima, e ne i thamë që Kosova nuk është ajo që e ka krijuar këtë klimë”, theksoi Shpend Ahmeti

Kryesuesit e ekipit negocia-tor për dialogun Kosovë-Serbi, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti janë deklaruar pas takimit që kanë pasur të martën me ndërmjetësuesen e dialogut mes dy vendeve Federika Mogherinin.

Shpend Ahmeti duke komentuar deklaratën e presidentit Hashim Thaçi për gatishmërinë që Kosova ta heqë taksën ndaj Serbisë, tha se taksat nuk është vendim i delegacionit por është i qeverisë.

“Është e qartë edhe për BE-në që taksat nuk hiqet në të thatë. Është shumë e qartë. Taksat janë i vetmi mjet që Kosova

e ka si politikë e jashtme për të bërë presion ndaj Serbisë. Zonja Mogherini e përmendi që kjo nuk është në frymën e dialogut dhe se duhet të krijohet klima, e ne i thamë që Kosova nuk është ajo që e ka krijuar këtë klimë gjatë muajve të tërë të një fushate tepër agresive që kulmoi me fushatën në Interpol”, theksoi Ahmeti.

Ndërsa edhe Fatmir Limaj deklaroi se duhet të pushojnë arsyet për heqjen e taksës.

“Kjo nuk është e njëanshme. Në kushte të tilla ne jetojmë qe 10 vjet e më tepër me Serbinë dhe askush nuk është lodhë me atë punë. Ka qindra gjëra që

Serbia nuk i ka respektuar. Ne tani jemi në një moment kut të gjithë duhet ta krijojmë klimën për dialog, jo vetëm Kosova. Në një marrëveshje gjithëpërfshirëse nuk do të ketë më nevojë për taksë.

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi janë jonormale dhe ne kemi ardhur këtu dhe dialogu është për të krijuar një situatë normale dhe situata normale është reciprociteti mes dy vendeve tona”, shtoi Limaj.

Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian, Federika Mogherini, ka folur pas takimit që pati të martën në Bruksel me ekipin shtetëror për dialog, ekip

ky i kryesuar nga Fatmir Limaj e Shpend Ahmeti.

Në një njoftim zyrtar, përfaqësuesja e BE-së, Mogherini ka thënë se ka shfrytëzuar takimin për të kërkuar sërish që të hiqet taksat e vënë ndaj produkteve serbe.

Mogherini ka thënë se duhet të krijohet një klimë që i kontribuon fqinjësisë së mirë, ku sipas saj marrëveshjet e arritura në të kaluarën duhet të respektohen e implementohen dhe veprimet dhe deklaratat që nuk janë në pajtim me interesin e përgjithshëm dhe objektivat strategjikë për rajonin duhet të shmangen.

GREQIA ÇON HIMARËN NË BE



S'ka integrim pa respektuar minoritetin!

Ministria e Jashtme greke i ka kërkuar përfaqësueses së BE, Federica Mogherinit dhe komisionerit Johannes Hahn që ta trajtojnë me seriozitet çështjen e minoritetit grek në Shqipëri.

Në letrën drejtuar nënkryetarit të parlamentit grek George Sourla, në lidhje me informacionin e kërkuar prej këtij të fundit, zv/ministri i Jashtëm grek, George Katrougalos shprehet se e ka trajtuar me seriozitet çështjen e pronave të minoritetit grek në Himarë dhe se po e ndjek atë me shumë kujdes.

Katrougalos thekson gjithashtu se i ka kërkuar përfaqësuesve të BE që t'i kushtojnë rëndësi çështjes së minoritetit grek pasi është dhe një pikë që do t'i shërbejë integritetit të Shqipërisë në BE.

“Ministria e Jashtme greke po ndjek me shumë vëmendje çështjen e minoritetit grek në Himarë në lidhje me parcelat e tokës. Ne kemi informuar përfaqësuesit e komunitetit kombëtar dhe në veçanti Frederica Mogherinin dhe Johannes Hahn, të cilëve u kërkova që ta trajtojnë me seriozitet dhe t'i kushtojnë rëndësi gjendjes së minoritetit grek. Dhe i kemi kërkuar dhe palës shqiptare që të respektojë të drejtat e minoritetit grek jo vetëm për të ruajtur marrëdhënien dypalëshe por edhe për shkak të integritetit në Bashkimin Evropian.”/ Vizionplus

Publicitet

SHMK “Orde Çopella” Prilep rr.Samoilova nr. 39 Prilep tel: 048/422-095

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1 dhe 2 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve nga shkollat e mesme, ndërsa në pajtim me nenin 24, paragrafi 10 dhe 11 nga Ligji për arsim të mesëm, Kryetari i Komisionit për përzgjedhje të ofertave, ndërsa në pajtim me vendimin 02-334/2 të datës 14.12.2018 për realizim të ekskursionit shumëditor në vitin e tretë publikon:

SHPALLJE

për përzgjedhje të ofertave për realizim të ekskursioneve përfundimtare

Shkolla e mesme komunale “Orde Çopella”- Prilep në pajtim me Programin për realizim të ekskursioneve përfundimtare (shumëditore) për nxënësit e vitit të tretë në vitin shkollor 2018/2019 dhe mendimit të marrë nga Këshilli i Prindërve dhe Byroja për zhvillim të arsimit organizon:

1. Ekskursion përfundimtar shumëditor për nxënësit e vitit të tretë jashtë R. Maqedonisë në relacionin Prilep-Igumenicë-Bari ose Brenidizi, Neapol-Romë me Vatikan-Milano-Venecie-Veronë-Lido di Jesolo.

Në kërkesën për oferta mund të paraqiten persona juridik të cilët i plotësojnë kriteret në vijim:

- të jenë të regjistruar sipas dispozitave pozitive në R. Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse turistike, - të ketë të realizuar me sukses së paku 3 (tre) ekskursione të nxënësve dhe aktivitetet tjera të lira në 3 (tre) vitet e fundit,

- t'i plotësojnë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, sipas Ligjit për siguri të komunikacionit të rrugëve dhe Rregullores për kërkesa teknike të veçanta të automjeteve me të cilat transportohen grupet e fëmijëve, - në çmimin e ekskursionit të përfshihen shpenzimet për rrugë, ushqim, akomodim dhe vizitë të lokacioneve, të përfshihet edhe sigurimi rrugor themelor dhe standard pa franshizë, - të theksohet çmimi për organizim të mbrëmjes për argëtim, - ekskursioni do të realizohet në muajin Prill ose Maj në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) ditëve me së paku 3 (tre) fjetje në hotele me së paku 3 yje, edhe atë dy fjetje me mëngjes dhe darkë në Romë dhe një fjetje me mëngjes dhe darkë në Lido di Jesolo

- kriteret për zgjedhje të ofertës më të mirë janë:

- çmimi më i ultë;
- numri më i madh i kësteve mujore;
- numri më i madh i ofertave falas për nxënësit e prekur social

Ofertuesi i përzgjedhur duhet të sigurojë udhëheqës, sigurim të nxënësve dhe person nga drejtimi shëndetësor (mjek).

Dokumentacioni me ofertën të parashtrohet në shkollën në afat prej 5 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes në mediat publike në zarf të mbyllur me shenjë “Komisioni për zgjedhjen e ofertave për ekskursione përfundimtare”. Ofertat e pa kompletuara dhe të parashtruara me vonesë nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komisionit SHMK “Orde Çopella” Prilep Goran Vezenkoski

Në bazë të nenit 14, paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 12 nga Vendimi për themelimin e Qendrës për zhvillim të Rajonit planor të Shkupit nr. 02-88/8 të datës 09.11.2011 dhe nenit 4 nga Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në Qendrën për zhvillim të rajonit planor të Shkupit nr. 01-93/1 të datës 12.12.2011, dhe Vendimit të Udhëheqësit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor të Shkupit, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE për punësim të:

1. Një (1) realizues/e për kohë të pacaktuar për vendin e punës: Këshilltar për normativë, furnizime publike, çështje financiare dhe administrative - PSP Fakulteti juridik;

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë për vendin e punës së theksuar, është e nevojshme t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Ligj:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me vendim gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- të ketë 2 (dy) vite përvojë të punës,
- të ketë njohuri të Gjuhës angleze ose tjetër gjuhë botërore,
- të ketë njohuri të punës me kompjuterë

Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë të punës nga dita publikimit.

Për vendin e punës të lartpërmendur është me orar të plotë të punës prej 40 orë në javë, orari i punës nga e hëna deri të premtën, neto pagesa themelore është 25.000,00 denarë.

2. Kandidatët janë të detyruar të parashtrorin dëshmi përkatëse në formë origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, në pajtim me kushtet edhe atë:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë
- Diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit e cila kërkohet për vendin e punës
- Shtetësi
- Certifikatë që nuk ka të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës - jo më të vjetër se 6 muaj
- Dëshmi për njohjen aktive të gjuhës angleze ose ndonjë tjetër gjuhë botërore, certifikatë, diplomë ose vërtetim
- Dëshmi për njohjen e punës me kompjuterë, certifikatë, diplomë ose vërtetim.

Dokumentet e kërkuara parashtrohen në zarf të mbyllur me shenjë “Të mos hapet” në adresën në vijim:

Qendra për zhvillim të rajonit planor të Shkupit rr. Dimitrie Cupovski nr.13, Shkup Arkivi i Qendrës (me shenjë “për shpallje”)

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni jo i kompletuar dhe i vonuar nuk do të shqyrtohen.

Kontakt telefoni 02/ 3 244 - 033

Qendra për zhvillim të Rajonit planor të Shkupit

TURQIA, KRAH SHBA-ve KUNDËR ISIS

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan përsëriti vendimin muajin e kaluar të homologut amerikan Donald Trump, për të tërhequr trupat amerikane nga Siria, por tha se tërheqja duhet të bëhet me kujdes dhe me "partnerë të vërtetë"



ndërkombëtare dhe popullit sirian", ka shkruar liderin turk.

"Turqia, e cila ka ushtrinë e dytë më të madhe aktive në NATO, është i vetmi shtet me fuqi dhe angazhim për ta bërë këtë detyrë", shtoi Erdogan.

Në një njoftim të papritur, Trump tha më 19 dhjetor se ISIS u mund në Siri dhe njoftoi tërheqjen e 2,000 trupave nga shteti.

Ky veprim shkaktoi reagime të shumta, në radhë të parë nga partnerë si Franca dhe Britania e Madhe të cilët kanë paralajmëruar se ISIS nuk është i mundur. Nga ana tjetër, Sekretari i Mbrojtjes James Mattis dhe dorëheqjen pas padakortësisë me vendimin.

Në ditët e fundit, administrata

Trump shpjegoi se tërheqja nga verilindje të Sirisë nuk do të ndodhë shpejt dhe administrata e presidentit amerikan duket se ka ndryshuar tonin duke thënë se lufta kundër ISIS nuk është ende e gjatë.

Në anën tjetër, Turqia nuk mund të pranojë komentet e fundit nga John Bolton, këshilltar i sigurimit kombëtar të presidentit të SHBA Donald Trump, se Ankaraja duhet të bjerë dakord të mbrojë aleatët kurdë të Uashingtonit në Siri, tha presidenti turk Recep Tayyip Erdogan. Duke folur para anëtarëve të Partisë së tij AK në parlament, Erdogan tha se Bolton bëri një "gabim serioz" duke bërë thirrje për kushte të reja tërheqjeje nga Siria dhe se Turqia nuk mund

të pranonte një kompromis mbi milicinë kurde të YPG.

Erdogan tha se përgatitjet turke për një ofensivë të re ushtarake kundër grupeve terroriste në Siri u përfunduan në masë të madhe. Presidenti turk gjithashtu shtoi se lufta kundër milicisë kurde të YPG kundër Shtetit islam ishte një "gënjeshtrë e madhe".

Këshilltari i Sigurisë Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Bolton, u takua sot me Ibrahim Kalin, këshilltar i presidentit turk Recep Tayyip Erdogan për të diskutuar fatin e kurdëve sirianë. Ata diskutuan për dy orë në kompleksin presidencial në Ankara, njofton AP.

Bolton tha se kishte kërkuar garanci nga Turqia për të mos sulmuar milicinë kurde në Siri, aleatin e SHBA në luftën kundër Shtetit islam. Ai tha se ky ishte "një kusht" për tërheqjen e planifikuar të forcave amerikane nga verilindja e Sirisë nga presidenti i SHBA, Donald Trump.

Turqia e konsideron njësinë e mbrojtjes së popullit kurd të Sirisë (YPG) një grup terrorist. Bolton pret të takohet me presidentin turk, edhe pse nuk është e qartë nëse do të vijë deri te ky takim.



Rusia, frika më e madhe e Gjermanisë

SHBA, aleati më i afërt strategjik i Gjermanisë, është renditur çuditërisht afër Rusisë në listën e vendeve që gjermanët kanë më shumë frikë, duke lënë pas Korenë e Veriut dhe vende të tjera. Të dhënat vinë nga një sondazh i realizuar nga Foras. Çuditërisht, deri në 55 për qind e gjermanëve besojnë se SHBA është pothuajse një kërcënim i barabartë për vendin e tyre si Rusia, e cila shënoi 56 për qind në studimin e fundit nga sondazhi i Foras, raporton Bild. Gjermanët si duket kanë ndryshuar perceptim për Korenë e Veriut, të cilën nuk e shohin më si rrezik. Për shembull, vetëm 27 për qind e gjermanëve ndjehen të kërcënuar nga Koreja e Veriut, e cila deri vonë ishte burimi kryesor i lajmeve të armëve bërthamore. Ajo pasohet nga Turqia (24 për qind) dhe Arabia Saudite (23 për qind).

Kina konsiderohet një kërcënim për vetëm 16 për qind të të anketuarve. SHBA, aleati i vjetër i Gjermanisë dhe partneri kryesor tregtar, kryesisht i frikëson njerëzit e moshës së mesme, ndërsa gjermanët e anketuar që thonë se Rusia ishte një rrezik për paqen ndërkombëtare përfshinin të anketuarit më të rinj të moshës 18-29 vjeç, si dhe ata në viteve '60. Sondazhi siguron një skicë interesante të simpativë politike të të anketuarve.

Gjibraltari kundër ndarjes së sovranitetit ndërmjet Londrës e Madridit

Shefi i Qeverisë së Gjibraltarit Fabian Picardo të hënën ka hedhur poshtë mundësinë e ndarjes së sovranitetit të këtij territori ndërmjet Londrës e Madridit pas daljes së Britanisë së Madhe nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Kryeministri spanjoll Pedro Sanchez ka deklaruar se dëshiron negociatë për sovranitet të përbashkët në territorin britanik pas Brexitit që pritet të hyjë në fuqi më 29 mars të këtij viti.

"Gabojnë ata në Spanjë, pa marrë para sysh përkatësinë politike, që mendojnë se do të pranojmë kompromis për sovranitetin. Koncepti i ndarjes ose i tkurrjes së sovranitetit është i gjykuar me



dështim", ka thënë Picardo, përcjell al Jazeera. Kryeministri i Gjibraltarit ka shtuar se Brexit nuk do ta ndryshojë situatën. Propozimi për ndarje të sovranitetit nuk është i ri. Këtë në vitin 2001 dhe 2002 e ki-

shin propozuar Londra e Madridi, por ai u hodh poshtë me referendumin e banorëve të Gjibraltarit në vitin 2002. Edhe ky territor britanik do të dalë nga BE-ja më 29 mars.

Italia dhe Polonia në bisedime për krijimin e ligës anti-BE

Polakët dhe sundimtarët e krahut të djathtë të Italisë duhet të çimentojnë "marrëdhëniet e tyre të veçanta" në një takim në Varshavë, i cili mund të bëjë një forcë të re kundër BE-së, një forcë të madhe në Parlamentin e ardhshëm Evropian.

Gjatë takimit mes shefit të partisë në pushtet polak Jaroslaw Kaczynski dhe ministrit të brendshëm italian dhe zëvendëskryeministrit Matteo Salvini në kryeqy-

tetin polak të mërkurën (9 janar) mendohet se do të diskutohet anëtarësimin e Polonisë në grupin e ri të EP Salvini, sipas të përditshmes italiane La Repubblica.

Vizita e Matteo Salvinit është "shenjë e marrëdhënies të veçanta", tha ministri i jashtëm polak.

"Është një takim në nivelin më të lartë. Nëse presidenti Kaczynski takohet me një politikan tjetër, është një shenjë e një marrëdhë-




nieje të veçantë, kështu që ne po e trajtojmë atë", tha të shtunën mi-

nistri i jashtëm polak Jacek Czaputowicz.



Zyrtarët britanikë dhe evropianë po diskutojnë mundësinë e shtyrjes së Brexitit

Zyrtarët britanikë dhe evropianë po diskutojnë mundësinë e shtyrjes së procesit formal të daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian. Këto diskutime po zënë vend për shkakun se zyrtarët kanë frikë se një marrëveshje për Brexitin nuk do të mund të miratohet deri më 29 mars, raporton Daily Telegraph, duke cituar burime të pidentifikuara. Kryeministrja, Theresa May, ka përjashtuar në mënyrë të përsëritur vonimin e Brexit, megjithëse ajo ka paralajmëruar gjithashtu ligjvënësit britanik, se nëse ata, refuzojnë marrëveshjen e saj, atëherë Brexit mund të "dalë nga binarët" ose që Mbretëria e Bashkuar mund të largohet pa një marrëveshje. "Ne po e lëmë Bashkimin Evropian më 29 mars dhe nuk po shikojmë mundësinë e shtyrjes" ka thënë sekretari britanik për Brexitin, Stephen Barclay, transmeton rel.



Nga Carlo JEAN

DESTABILIZIMI I SHKAKTUAR NË LINDJE TË MESME NGA HUMBJA E ISIS-IT

FUNDI I ËNDRRËS KURDE



Sfida e paraqitur nga ISIS bashkonte si koalicionet laramane që luftonin në Irak e në Siri, ashtu edhe në brendësi të shteteve dhe të grupeve joshtetërore që e përbënin. Me projektin e tij për të anuluar kufijtë midis shteteve, Kalifati paraqiste një sfidë globale ndaj aseteve gjeopolitike të Lindjes së Mesme të imponuara nga Britania e Madhe e nga Franca në mbarim të Luftës së Parë Botërore (marrëveshja Sykes - Picot). Shpartallimi i ISIS-it ka qenë destabilizues edhe brenda vetë koalicioneve të ndryshme, pasi komponentët dhe grupet e tyre janë ndarë në grupe e klane në luftë brenda dhe midis njëri tjetrit. Janë të pamëshirshëm dhe bëjnë lojë dyfishe. Nuk njohin limitet e mundësive të tyre. Shtetet e Bashkuara dhe Rusia nuk dinë si të shkëputen nga ky lëmsh. Nuk mund të tërhiqen pa humbur fytyrën. Kërkojnë ta zgjidhin kaosin me mjete ushtarake, por e dinë mirë se vetëm kompromiset politike mund ta zgjidhin. Kështu, konflikti në Siri, por edhe ai në Irak, janë të destinuara që të vazhdojnë ende gjatë. Rajoni i Gjysmëhënës është bërë një teatër lufte në të cilën ndeshen fuqi të mëdha dhe aktorë rajonalë, Turqia, Irani, por edhe Izraeli.

Çështja kurde duhet shqyrtuar në një kontekst të tillë. Me humbjen territoriale - por jo ideologjike - të ISIS-it, me reagimet negative ndaj referendumit të shtatorit 2017 lidhur me pavarësinë e Kurdistanit iraken dhe me ndërhyrjen e Turqisë në Siri (operacionet "Mburoja e Eufratit" dhe "Dega e Ullirit"), është hapur një fazë e tretë e konfliktit. Çështja kombëtare kurde është bërë më qendrore se më parë. Fillimisht kurdët furnizonin këmbësori të shkëlqyer për të shpartalluar ISIS-in. Me humbjen e këtij të fundit dhe me hyrjen prepotente në lojë të Turqisë, dobishmëria e tyre është zvogëluar. Janë bërë prioritarë interesa të reja. Në fazën e tij të parë, konflikti në Siri ishte një luftë civile, e ngjashme me atë libiane kundër Kolonelit Gheddafi. Në të dytën ka qenë sidomos një luftë me bedel midis bllokut sunit dhe atij shiit. Fazë e tretë e sotme konsiston në një konflagracion kaotik midis fuqive globale e rajonale dhe midis interesave etnike, tribale dhe klanore, që u është mbivendosur dy të parave. Entitetet e ndryshme në luftë janë njëkohësisht aleatë e armik dhe janë të copëzuara në brendësinë e tyre. Asnjëri nuk i beson tjetrit. Situata është hobbësiane, luftë për vdekje e të gjithë kundër të gjithë-

ve. Është e komplikuar nga fakti që proceset e paqes janë dy. Njëri në Astana - Sochi, i sponsorizuar nga Rusia, Turqia dhe Irani. Tjetri në Gjenevë, i mbështetur nga Kombet e Bashkuara dhe sidomos nga Shtetet e Bashkuara dhe Arabia Saudite.

COPËZIMI I KAMPIT KURD

Copëzimi i kurdëve zbrit në historinë e tyre. Qenë një popull nomad, i dedikuar pas blegtorisë dhe i ndarë në klane dhe tribù. Katër janë shtetet në të cilat ka pakica të konsiderueshme të 30 - 35 milion kurdëve: Turqia, në të cilën ndodhen 14.7 milion dhe shkojnë në 15% të popullsisë; Irani, me 8.1 milion dhe 10%; Iraku, me 5.5 milion dhe 17.5% dhe Siria, me 1.7 milion dhe 9.7%. Bëhet fjalë për pakica të konsiderueshme mjaft të përqendruara në disa province, port e përhapura në territoret e të katër shteteve, sidomos në qytetet e mëdha. Stambolli është qyteti më i madh kurd. Veç kësaj, ekziston një diasporë prej mbi 2 milion kurdësh, sidomos në Gjermani. Kur flitet për komb kurd, i referohet një realiteti joekzistent, në mos fantazive dhe ëndrrave të "pararojave" intelektuale. Kurdët sirianë dhe irakenë janë thellësisht të përçarë edhe në provincat ku përbëjnë shumicën e popullsisë. Disa, si ata të PKK-së së Abdullah Oçalanit, ëndërrojnë një unitet kulturor dhe administrativ për ta realizuar në mënyrë realiste në bashkëpunim me shtetet e ndryshme të rajonit. Jo një shtet të vërtetë unitar, siç parashikohej nga Traktati i Sèvres.

Të tjerë një autonomi të gjerë faktike, si ajo e parashikuar nga Masoud Barzani për Kurdistanin iraken. Me referendumin fliste pavarësia, por jo shkëputja nga Bag-

dadit. Autonomia administrative, kulturore dhe ekonomike dyshohet se është një hap i parë drejt një shteti sovran. Është një linjë më realiste, e adoptuar edhe nga kurdët sirianë, për të pasur mbështetjen ndërkombëtare, e domosdoshme pasi kurdët nuk posedojnë forcën e nevojshme për ta fituar vetë, pavarësisht vlerës së milicive të tyre: të padisponueshëm edhe për një marrëveshje me Bashar al-Assad kundër Turqisë. Në këtë moment, Ankara ja i sulmon në enklavën veriperëndimore të Afrinit, duke pohuar se YPG-ja është e lidhur me PKK-në. Në të ardhmen, mendohet ta sulmojë edhe në Manbij, në perëndim të Eufratit, e më pas në Rojava, rajonin qendror të vendbanimeve kurde në verilindje të Sirisë. Por si në Siri, ashtu edhe në Irak, kurdët janë të përçarë midis tyre.

PËRÇARJET E KURDËVE NË IRAK

Përçarjet e kurdëve irakenë kanë rezultuar të dukshëm në kundërvënien midis partisë klanit Barzani (KDP) dhe asaj të klanit Talabani (PUK), të shfaqura qysh në vitet '90, me përlëshje të armatosura të përgjakshme, që kishin ndarë më dysh dy entitete të qarta. Thujse për asgjë kanë shërbyer si Marrëveshja e Bashkimit e 2002 - 2006, ashtu edhe krijimi i Partisë së Ndryshimit (OC-CAR), me origjinë nga një shkëputje prej PUK-ut. E votuar nga të rinjtë më të arsimuar, ajo kishte siguruar menjëherë një konsensus elektoral të konsiderueshëm (në 2012, 38 parlamentarë nga 111). Ajo kërkonte bashkimin e milicive të peshmergave, të mbajtura në varësi të KDP-së e të PUK-ut, atë të bankave, të transporteve e të TLC-ve dhe luftën kundër korrupsio-

nit. Copëzimi u bë më i fortë me ndarjen faktike e ndodhur në KDP, prej kundërvënies ekzistuese midis djalit të Masoud Barzani, Masrour, që kontrollonte peshmergat, dhe kushëririt të tij Nechirvan, që dominonte ekonominë. Vazhdonte përplasja midis KDP-së dhe PUK-ut, e zbutur vetëm prej kërcënimit të ISIS-it. Për shembull, e dyta ju kundërvu kërkesës së Barzani bërë Turqisë për stërvitjen e peshmergave, përpara sulmit në Mosul. Edhe PUK-u u nda në 2016 në vijim të sëmundjes së kreut të drejtuar nga gruaja e tij dhe në një të dytë të drejtuar nga dy bashkëpunëtorë të tij. Për pasojë, një përçarje e tij u mundësoi qeverive të Bagdadit e të Teheranit që të përzihen në çështjet e brendshme politike të qeverisë rajonale të Kurdistanit. PUK-u dhe Gorran-i qenë kundër referendumit të dëshiruar nga Barzani në shtatorin e 2017. E para, duke u mbështetur tek Bagdadi dhe Irani, ishte në favor të një linje më të matur dhe kundër lidhjeve të tepruara me Turqinë. Donte t'i balancoje me mbështetjen e Teheranit. Referendum shënoi një pikë kthese. Ngjalli një reagim të fortë jo vetëm të qeverive të Bagdadit dhe Teheranit, por edhe të asaj të Ankarasë, jo vetëm me ndalimin e fluturimeve në Erbil, por edhe me kërcënime embargoje. Ushtria e Bagdadit dhe milicitë Shiite irake-ripushtuan pothuajse të gjithë territoret e pushtuara nga kurdët në luftën kundër ISIS-it, në mënyrë të veçantë Kirkukun, "Jeruzalemin kurd" dhe vendburimet e pasura me naftë të tij. PUK-u u dha urdhër peshmergave të tij që të mos rezistonin dhe u dha impuls të ri iniciativave çtensionuese të tij me Bagdadin dhe me Tehera-

Kurdët kanë humbur një prej pasurive të tyre më të çmuara të tyre: simpatinë, të cilën e gëzonin në Perëndim prej vlerës së demonstruar dhe luftëtarëve të tyre në luftën kundër ISIS-it, si edhe nga një fushatë e shkëlqyer mediatike që i paraqiste si demokratët dhe tolerantët e vetëm të Lindjes së Mesme. Demokratë janë pak. Njohin të gjithë një formë të çuditshme demokracie klanore e tribale, që nuk pyet për asnjë opozitë. Tolerantë janë edhe më pak, siç e demonstrojnë spastrimet brutale etnike të praktikuar në territoret e pushtuara prej ISIS-it. Kauza kombëtare kurde mund të lindë vetëm pas një periudhë të gjatë

nin. Masoud Barzani u dorëhoq nga President në fund të tetorit, duke pretenduar se ishte politikisht i izoluar dhe se ishte braktisur edhe nga Shtetet e Bashkuara, në mbështetjen e të cilave kishte shpresuar shumë, edhe si mirënjohje prej ndihmës së dhënë në luftimin e ISIS-it dhe kundërshtimin e tij ndaj Iranit. E ardhmja e Kurdistanit varet tashmë nga aftësia e tri partive për të gjetur një kompromis dhe për ta gjetur edhe me Bagdadin për të shpëtuar sa më shumë që të jetë e mundur nga autonomia e rajonit. Vetëm Arabia Saudite i mbështet, duke qenë se konsideron që kurdët, të cilët janë sunitë, do ta kufizonin pushtetin e qeverisë shiite të Bagdadit.

KURDËT SIRIANË

Kurdët sirianë janë më pak të copëzuar sesa ata irakenë. Janë edhe pse nuk u duhet të zgjedhin midis Turqisë dhe Iranit. E dinë se armiqësia e Ankarasë nuk do të zbutet dhe se opinion patriotik turk është kundër autonomisë së Rojavas, e konsideruar një armik ekzistencial, akoma më e rëndë

sesa rindërtimi i Sirisë alawite. Me shqetësimin e Shteteve të Bashkuara, Turqia lidhet gjithnjë e më shumë me Rusinë, nga e cila ka pasur miratimin për operacionet "Mburoja e Eufratit" dhe "Dega e Ullirit", pavarësisht lidhjeve tradicionale midis kurdëve dhe Moskës, që i takojnë Luftës së Ftohtë, kur Rojava përbënte bazën e PKK-së nga ku sulmohej Turqia, anëtare e NATO-s. për këtë arsye, drejtuesit kurdo-sirianë kanë rilidhur raportet me al-Assad. Në realitet nuk qenë prishur asnjëherë. Nga viti 1978 kishin një zyrë në Damask dhe, gjatë luftës civile, kishin bashkëpunuar shumë herë me ushtrinë qeveritare, pavarësisht raporteve të mira me Shtetet e Bashkuara dhe rreshtimin e disa mijëra forcave speciale amerikane, si për të përcaktuar objektivat për avionët amerikanë, ashtu edhe për të stërvitur YPG-në. kurdët sirianë nuk e kanë vënë asnjëherë në diskutim unitetin e vendit. Kërkojnë vetëm autonominë, të cilën regjimi alawit duket i gatshëm që t'ua japë, në mos tjetër për faktin që forcat kurde do t'i nevojiten Damaskut për t'i rezistuar pretendimit të Ankarasë në krijimin e një rripi sigurie në territorin sirian, në jug të kufijve jugorë të saj.

Por edhe midis kurdëve sirianë po shfaqe një përçarje "luftëtarë dhe tregtarë". Këta të fundit, krahasuar me të parët kërkojnë përshpejtimin e mirëkuptimit me Damaskut dhe zbutjen e armiqësisë ndaj Turqisë. Prej tyre varen trafiqet, sidomos kryesorja e tyre, domethënë kontrabanda e naftës. Mendojnë edhe se niveli i tyre i sigurisë mund ta rrisë rikapjen e kontrollit të arabëve sunitë nga ana e al-Assad, të cilët janë mazhoritarë dhe janë të ndarë etnikisht nga kurdët. Edhe në Siri po verifikohet fenomeni i ndodhur në pjesë të tjera të botës arabe: pakicat etnike dhe fetare ndjehen më shumë të ruajtura nga regjimet autoritare sesa nga ato të ashtuquajtura demokratike, që tentojnë të transformohen në diktatura brutale të shumicave.

Ashtu si në Irak, evoluimi i situatës në Siri është i paparashikueshëm. Varet nga ndërhyrja e fuqive të huaja globale, si Rusia e Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe të atyre rajonale. Realiteti është se kurdët janë vetëm pjesërisht padronë të fatit të tyre. Është për të pyetur nëse lëvizja kombëtare kurde ose, të paktën, kërkimi i autonomive substanciale rajonale do të munden vallë ta rimarrin veten nga katastrofa e dështimit të referendumit të Masoud Barzani, bast i rrezikshëm dhe i keqorganizuar, që të gjithë mbështetësit e kauzës kurde kishin kërkuar më kot ta bindnin që të hiqte dorë, edhe me kujtimin e dështimit të babait të tij, ndërtues në 1945 i republikës kurde të Mahabadit në Kurdistanin iraken.

LËMSHI I INTERESAVETË

NDJEKURA NGA FUQITË E HUAJA

Rusia dhe Shtetet e Bashkuara janë të impenjuara drejtpërdrejtë në konflikt. Rivaliteti i tyre, i dëshmuar edhe nga ekzistenca e dy proceseve të paqes: ai i Astanas dhe ai i Gjenevës - ka limite të caktuara. Duan të shmangin përplasjet midis forcave respektive dhe eskalimin e pashmangshëm pasues. Pastaj, të dyja nuk duan që sistemimet e ardhshme të Lindjes së Mesme të parashikojnë ndonjë modifikim të kufijve. E dinë se një gjë e tillë do të hapte "Kutinë e Pandorës" e konflikteve të reja.

Së fundi, të dyja do të donin të deklaronin "mission accomplished" dhe të tërhiqeshin nga rajoni i trazuar, por pa mundur që Moskës të pranojë të ridimensionojë përfitimet e arritura me ndërhyrjen e aj (baza detare dhe ajrore; qëndrim në pushtet i al-Assad dhe i alawitëve). Nga ana e tyre, Shtetet e Bashkuara as nuk mund t'i braktisin krejtësisht aleatët e tyre besnikë kurdo-sirianë, as nuk mund t'i lënë terren të lirë Iranit, edhe prej kërcënimit që do t'i paraqiste sigurisë së Izraelit dhe prej probabilitetit të një konflikti edhe bërthamor midis të dy vendeve. Përveç interesave strategjike, ato taktike të të dyjave vendeve janë të kundërta dhe shpesh kontradiktore në vetë brendësinë e tyre. Në mbështetje të al-Assad dhe të integritetit territorial sirian, Putini nuk do t'i komprometojë raportet e bashkëpunimit me Turqinë, që e vënë në provë të rëndë përkatësinë e Ankarasë në NATO. Veç kësaj, nuk mund të anulohen krejtësisht mirëkuptimet tradicionale me kurdët sirianë, të lidhu me Bashkimin Sovjetik gjatë gjithë Luftës së Ftohtë, duke i përdorur si thikë pas shpine në anën jugore të Turqisë, shtylla jugore e Aleancës Atlantike. Për saktësi, një periudhë e tillë i përket fakti që YPG-ja është kaq shumë e lidhur me PKK-në.

Edhe Shtetet e Bashkuara duhet të gjejnë një kompromis midis objektivit për të mbrojtur kurdët e Rojavas, atij për të mos

prishur raportet me Turqinë dhe atij për të promovuar një ndryshim regjimi në Damask. Natyrisht, shpresojnë që Moskës të ngecë në Siri. Kjo shpjegon reagimin brutal të aviacionit amerikan kundër kompanisë private ushtarake ruse "Wagner", e cila ka pësuar dhjetëra, në mos qindra, të vdekur, duke e detyruar Putinin që të deklarojë, midis ilaritetit të përgjithshëm, se Shtetet e Bashkuara nuk kishin shkaktuar humbje midis ushtarëve rusë. Pastaj, Rusia duhet të shmanget nga iniciativat e Turqisë dhe Iranit, duke kërkuar me një lloj shkathtësie të mos bëjë askënd të pakënaqur.

TURQIA

Konflikti sirian ka shënuar dështimin e politikës së mëparshme të jashtme turke dhe fundin si të tendencave neo-otomane, ashtu edhe ëndrrën e saj për dominim mbi një "turkosferë sunitë", pas kontrasteve të lindura me Arabinë Saudite dhe Egjiptin, që i konsiderojnë kërcënim mirëkuptimit midis Ankarasë e Teheranit dhe mbështetjen e dhënë Vëllazërisë Myslimane. Erdoganit i është dashur të heqë dorë nga ëndrra e dominimit të bllokut sunit, nga projekti për ta përzënë al-Assad dhe atij për të krijuar nga Mesdheu në Irak një brez sigurie të thellë 30 kilometra në jug të kufijve turkë. Duken shekuj qysh kur Erdogani ligjëronte mbi fshirjen e Marrëveshjes Sykes-Picot dhe mallkonte "spionin britanik" Lorenci i Arabisë, tradhtar i kauzës arabe. Më pas Erdogani ka hyrë drejt përplasjes me Shtetet e Bashkuara, NATO-n dhe Bashkimin Europian, duke filluar nga grushti i shtetit i dështuar i korrikut 2016, nga refuzimi amerikan për t'i dorëzuar klerikun Cyprien dhe heqjes dorë nga stërvitja dhe armatimi i një roje kufitare prej 30000 efektivësh dhe të kufizimi i vendosur ndaj lirive civile e politike në Turqi, që kanë goditur rëndë pikërisht elementët më pro-perëndimorë.

Nuk i ka mbetur mundësi tjetër përveçse të kërkojë mbështetjen e Moskës dhe të Teheranit, do-

methënë më armiqtë tradicionale të Perandorisë Otomane, anipse duke qenë i bindur se një dominim iranian në Siri, të paktën në perspektivë, do të jetë kundër ambicieve turke për t'u bërë hegjemoni rajonal në Lindje të Mesme dhe që nuk mund të besojë plotësisht në mbështetjen e të zhdërvjellëtit Vladimir Putin. Ndoshta Erdogani shpreson që ta përfshijë Kinën në Lindje të Mesme në mbështetje të Turqisë, edhe pse Pekini është i preokupuar nga influence në rritje indiane në Iran. Në një vizion të tillë, Lindja e Mesme do të bëhej teatër përplasjeje - konfrontimi midis dy gjigantëve aziatikë, që do ta prishte situatën e ngërçit nga e cila Shtetet e Bashkuara dhe Rusia duket se nuk janë në gjendje të dalin.

IZRAELI

Në konfliktin sirian është përfshirë tashmë edhe Izraeli. Shteti hebre nuk mund ta pranojë krijimin e një "ure tokësore" midis Iranit dhe hizballahëve libanezë, gjë që do të forconte si influencën iraniane mbi Gazan dhe Hamasin, por edhe rrezikun për të humbur Lartësitë Golan, nga ku nxjerr një pjesë të konsiderueshme të ujit të tij. Në veçanti Jerusalemi, që i kujton mirë kapacitetet ushtarake të Hizballahut në konfliktin e 2006, i frikësohet armatimit raketor të "Luftëtarëve të Zotit". Kështu që i bombardon shpesh raketat dhe raketalëshueset e dhëna nga Irani dhe magazinat e armëve që Hizballahu posedon në territorin sirian. Sigurisht ka planifikuar një luftë të re rrufe. Ajo mund të mos jetë e kufizuar në territorin sirian, por do të shtrihej me shpejtësi në të gjithë Lindjen e Mesme, duke e vënë Uashingtonin dhe Moskën përballë nevojës së zgjedhjeve të vështira. Jerusalemi synon mbi aleancën faktike me Arabinë Saudite, që do të gëzohej për një poshtërim të armikut ekzistencial të saj, Iranit. Për një iniciativë të tij, Jerusalemi do të kishte të paktën mbështetjen e heshtur edhe nga ana e Turqisë, duke e vënë Moskën përballë nevojës së zgjedhjeve të vështira.

KONSIDERATA PËRMBYLLËSE

Lufta në Siri është e destinuar që të zgjasë akoma dhe të ndërkombëtarizohet gjithnjë e më shumë. Evenimenti që mund ta tejkalojë ngërçin aktual - përjashtojë ndërhyrjen fantazi të Kinës dhe të Indisë - do të ishte një konflikt midis Izraelit dhe Iranit. Në një rast të tillë, shumë vështirë që Shtetet e Bashkuara dhe Rusia mund të rrinë duarkryq. Do të përfshiheshin në lëmshin e Lindjes së Mesme. Asgjë nuk të bën të parashikosh se situatë do të përmirësohet shpejt. Diplomacia multilaterale është e pafuqishme. Të gjithë deklarojnë se duan të pushojnë një konflikt mjaft brutal. Nuk mund ta bëjnë si prej faktit që fraksionet lokale luftojnë për mbijetesën e tyre dhe pse mendojnë se mund ta garantojnë vetëm më armë, ashtu edhe pse aktorët e jashtëm kanë interesat e tyre divergjente. Ithtarët e ndryshëm të armëpushimeve dhe paqeve i vendosin shkopinj në rrota njëri tjetrit. Lufta po humbet progresivisht çdo konotacion fetar, është bërë gjeopolitike, e karakterizuar nga lufta për pushtetin rajonal dhe atë në brendësi të grupeve të ndryshme.

Edhe prej përçarjeve të tyre, pavarësisht kapaciteteve dhe vlerës së tyre ushtarake, kurdët sirianë, ashtu edhe irakenë, gjenden në mes disa zjarresh, shpresat për të ndërtuar një shtet kurd, si ai i parashikuar në Traktatin e Sèvres, por edhe për të bashkuar kurdët e Rojavas me ata irakenë-gjë e pranuar, por jo e mirëqenë që të dyja palët e duan - tashmë kanë perënduar. Qenë ushqyer nga bindja se e kishin fituar meritën me luftën kundër ISIS-it dhe nga besimi i vendosur në aleancën me Shtetet e Bashkuara. Të dyja kanë rënë me përfundimin e luftës kundër ISIS-it, me izolimin ndërkombëtar ku janë gjendur, me presionet e forta të Irakut, Iranit dhe Turqisë, të ushtruara sidomos pas referendumit të shkëshilluar të pavarësisë së Kurdistanit iraken nga Bagdadi. Kurdët kanë humbur një prej pasurive të tyre më të çmuara të tyre: simpatinë, të cilën e gëzonin në Perëndim prej vlerës së demonstruar dhe luftëtarëve të tyre në luftën kundër ISIS-it, si edhe nga një fushatë e shkëlqyer mediatike që i paraqiste si demokratët dhe tolerantët e vetëm të Lindjes së Mesme. Demokratët janë pak. Njohin të gjithë një formë të çuditshme demokracie klanore e tribale, që nuk pyet për asnjë opozitë. Tolerantët janë edhe më pak, siç e demonstrojnë spastrimet brutale etnike të praktikuar në territoret e pushtuara prej ISIS-it. Kauza kombëtare kurde mund të lindë vetëm pas një periudhë të gjatë.

(Gjenerali në rezervë Carlo Jean është Docent i Gjeopolitikës në Link Campus University dhe President i Qendrës Studimore të Gjeopolitikës Ekonomike)



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2014...120/2018), Drejtori i SHFK "Vasil Gllavinov" Veles më datë 03.01.2019 solli Vendim për publikim të

SHPALLJE
për plotësim të vendeve të lira të punës
për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019

- Mësimdhënës të historisë në gjuhës shqipe – 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të mësimi klasor - në gjuhën shqipe – 10 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë, Slivnik dhe Klukovec me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të gjuhës angleze në SHP f.Buzallkovë në paralelet shqipe – 2 realizues për 20 orë të fondit javor me pagesë bazë prej 21.600,00 den
- Mësimdhënës të gjuhës angleze – 1 realizues për 20 orë të fondit javor me pagesë bazë prej 21.600,00 den
- Mësimdhënës të informatikës për mësimin në gjuhën shqipe – 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të etikës së religjioneve për mësimin në gjuhën shqipe – 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të etikës së religjioneve - 1 realizues për 4 orë të fondit javor me pagesë bazë 4.850,00 denarë.
- Mësimdhënës të gjuhës shqipe në SHP f.Buzallkovë - 1 realizues për 20 orë të fondit javor me pagesë bazë 21.600,00 denarë.
- Mësimdhënës të arsimi fizik dhe shëndetësor – në gjuhën shqipe 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të matematikës për mësimin në gjuhën shqipe – 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHP Buzallakovë me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të artit figurativ për mësimin në gjuhën shqipe – 1 realizues për 20 orë të fondit javor me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mësimdhënës të etikës – 1 realizues për 6 orë të fondit javor me pagesë bazë prej 6.925,00 den.
- Mësimdhënës të mësimi klasor – 1 realizues për 20 orë të fondit javor në SHFK "Vasil Gllavinov" Veles me pagesë bazë prej 21.600,00 den., deri në kthim të punonjësit nga pushimi mjekësor.
- Mësimdhënës të mësimi klasor – qëndrim- 1 realizues për 20 orë të fondit javor me pagesë bazë prej 21.600,00 den., zëvendësim për drejtor.
- Defektolog – 1 realizues për 40 orë pune me pagesë bazë prej 21.600,00 den.
- Mirëmbajtës i higjienës - 1 realizues për 40 orë të punës me pagesë bazë 12.174,00 denarë, deri në kthim të punonjësit nga pushimi mjekësor.

Fillimi i orarit të punës për kandidatët është në pajtim me orarin e orëve për vitin shkollor 2018/2019, përveç kandidatëve me numër rendor 15 dhe 16 orari punës së të cilëve është prej ora 07.30 deri në ora 15.30.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP duhet të plotësojë edhe kushtet e posaçme të parapara në nenin 80 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008....64/2018) ndërsa në pajtim me normativin për kuadrin mësimor, ndërsa kandidatët me numër rendor 16 të kenë të mbaruar arsimin fillor.

Dokumentet e duhura të parashtrihen në arkivin e shkollës.
Shpallja zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit, zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve.

Drejtor,
Sashko Çokov

Në bazë të nenit 21 paragrafi 11 të Ligjit për qasje ndaj objekteve të ndërtuara pa leje, Komuna e Kërçovës e shpall këtë Aktvendim për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje:
Kryetari i Komunës së Kërçovës, duke vendosur pas kërkesës së Jovan Stefanoski nga Kërçova, rr. "Pitu Guli" nr.15, të dorëzuar nën PA.1 nr. 10-2219/11 të dt. 24.08.2011, në bazë të nenit 21, paragrafi (2) të Ligjit për veprim me objektet e ndërtuara pa leje, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.23/11, 54/2011, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15, 31/16 dhe 190/17), ndërsa në lidhje me nenin 205, paragrafi 1 dhe neni 209 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.38/2005, 110/08 dhe 51/2011), e sjellë këtë:

A K T V E N D I M

- PËRCAKTOHET statusi juridik i objektit pa leje:
Shtëpi banimi që gjendet në rr. "Pitu Guli" nr.15, PK nr.5114/3, Fletëpronësia nr. 56863, KK Kërçovë 9, i cili objekt është i shënuar si ndërtesa nr.1, hyrje 1 dhe atë: hapsirë banimi në përdhësë, banesë 1, sipërfaqe e brendshme 60 m²; sipërfaqe ndihmëse në përdhësë, banesë 1 prej 9m²;hapsirë banimi në kat 1, banesa 2, sipërfaqe e brendshme prej 62 m²; sipërfaqe ndihmëse në kat 1-rë, banesë 2 prej 8 m², dhe - Objekt ndihmës që gjendet në rr. "Pitu Guli" nr.15, PK nr. 5114/3, Fletëpronësia nr. 56863, KK Kërçovë 9, i cili objekt është i shënuar si ndërtesa nr.2, hyrje 1 dhe atë: hapsirë ndihmëse në përdhësë, sipërfaqe e brendshme 25 m²,
- Ose, e tëra, në sipërfaqe të brendshme të përgjithshme prej 164m².
- Si bartës i të drejtës së pronësisë të objektit nga pika 1, e dispozitivit të këtij aktvendimi, përcaktohet Jovan Stefanoski nga Kërçova, rr. "Pitu Guli" nr.15, me NAVQ. *****.
- Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi, është elaborati gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm (elaborat gjeodezik për qëllime të veçanta) nr. 04-619/3, të dt. 16.06.2016, nga "Kat Plus" SHPK Kërçovë.
- Pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, i njëjti paraqet bazë ligjore për regjistrimin e të drejtës së pronësisë, të objektit, në fletoren publike për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive dhe gjatë regjistrimit, shënohet se objekti ka fituar status juridik, në përputhje me Ligjin për veprim me objektet e ndërtuara pa leje.

Arsyetim

Kërkuasi, Jovan Stefanoski nga Kërçova, rr. "Pitu Guli" nr.15, dorëzoi kërkesë për përcaktimin e statusit juridik të objekteve pa leje: Shtëpi banimi dhe objekt ndihmëse, të cilat gjenden në rr. "Pitu Guli" nr.15, PK nr. 5114/3, Fletëpronësia nr. 56863, KK Kërçovë 9, në sipërfaqe të përgjithshme të brendshme prej 164 m².

- Kërkuasi dorëzoi:
- Kopje të letërnjoftimit;
 - Deklaratë të vërtetuar te noterilica Korunoska Bogeski, RVV.nr. 6304/18, të dt. 19.09.2018;
 - Elaborat gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objekteve të ndërtuara pa leje, nr. 04-619/3, të dt. 16.06.2016, nga "Kat Plus" SHPK Kërçovë.
 - Certifikatë për shqyrtim historik nga shkresat e kryera për PK.nr.5114/3, KK Kërçovë 9 nga dt.22.11.2018
- Është përgatitur procesverbal për shqyrtimin e kryer në vendndodhje PA. nr. 10-2219/11, të dt. 13.04.2018.
Toka, PK nr. 5114/3, Fletëpronësia nr. 56863, KK Kërçovë 9, është në pronësi të kërkuasit Zhivka Mateska 104/728, Trajkoska Natasha 14/728, Noveska Maja 14/728, Petre Vojteski 28/728 dhe Republika e Maqedonisë në 568/728 pjesë ideale në të cilën pjesë të drejtë përdorimi kanë personat Vojteski Petre me 75/728, Slavova Vojteski me 104/728, Natasha Trajkoska 38/728, Nenad Trendafiloski me 35/728, Horvat Jamina me 35/728 dhe Kërkuasi Jovan Stefanoski me 35/728 dhe kërkuasi Jovan Stefanoski të 35/728 pjesë ideale.
Është pranuar pajtim për përcaktimin e statusit ligjor të objektit pa leje nga AD Mepso Shkup nr. 10-6683/1 nga 07.11.2018.
Objekti paraqet tërësi ndërtimore dhe funksionale.
Qëllimi i objekteve është shtëpi banimi dhe objekt ndihmës, gjegjësisht qëllimi i tokës është banim në shtëpi banimi.
Janë të përbushura kushtet për përfshirjen e objektit pa leje, në dokumentacionin urbanistik të planifikuar, në pajtim me standardet për përfshirje të objekteve pa leje, në dokumentacionin urbanistik të planifikuar.
Është dhënë pajtim urbanistik PA.1 nr. 10-2219/11, i dt.15.11.2018.
Është sjellur konkluzion për kompensimin, për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje, PA.1 nr.10-2219/11, të dt.06.12.2018, dhe kompensimi është paguar me fletëpagesë nga data 25.12.2018, përmes Postës 6250 Kërçovë.
Kryetari i Komunës së Kërçovës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, shqyrtimit në vendndodhje dhe shqyrtimin në pajtimin urbanistik, konstatoi se janë plotësuar kushtet për sjelljen e aktvendimit, për përcaktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar të paligjshëm.
Në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.
- Udhëzim për mjetin juridik:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga lëmia e rregullimit të hapësirës.
Taksa në pajtim me Ligjin për taksat administrative, në vlerë prej 250 den., është paguar dhe bashkangjitur me kërkesën.

Komuna e Kërçovës, PA.1 nr.10-2219/11, të dt. 26.12.2018

Dorëzuar deri te

-Kërkuasi

-Arkivi

Përgatiti:

Goce Treneski

Kontrolloi:

Vjollca Abazi

KOMUNA E KËRÇOVËS
KRYETAR,
Fatmir Dehari

Shpenzimet për shpalljen dhe dërgimin e këtij Aktvendimi do jenë barrë e parashtruesit për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje.
Kjo shpallje do të konsiderohet si dërgesë e rregullt e Aktvendimit të lartshënuar deri te të gjithë pronarët dhe pronarët e tokës mbi të cilën është ndërtuar objekti pa leje.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr.62/2005 dhe 113/2014), nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr.27/2014,199/2014 dhe 27/2016), Pëlqimit nga Ministria e arsimit dhe shkencës nr.12-9303/4 të datës 25.12.2018 SHFK. "Faik Konica" f.Sllupçan më datë 08.01.2019 publikon:
Numri i arkivimit: **04 -06/1**
Data: **08.01.2019**

SHPALLJE

për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019			
1.	Një	(1)	Arsimtar të mësimi klasor për punë në shk.qendrore,zëvendësim i drejtorit të shkollës deri sa të kthehet në vendin e tij të punës,por më së voni deri më 31.08.2019 me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
2.	Një	(1)	Arsimtar të mësimi klasor për punë në SHP në f.Izvor me pagë neto mujore prej 21.661 den.
3.	Një	(1)	Arsimtar të mësimi klasor për punë në SHP në f.Runicë me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
4.	Një	(1)	Arsimtar të mësimi klasor për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
5.	Një	(1)	Arsimtar të mësimi klasor për punë në SHP në Allashec me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
6.	Një	(1)	Arsimtar të gjuhës shqipe me fond të plotë orësh në javë për punë në shkollën qendrore dhe periferike në Allashec me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
7.	Një	(1)	Arsimtar të gjuhës shqipe me fond të plotë orësh në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
8.	Një	(1)	Arsimtar të gjuhës shqipe me 12 orë mësimi në javë për punë në SHP në f.Runicë me pagë mujore prej 8.664,00 den.
9.	Një	(1)	Arsimtar të fizikës me 16 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe shkollat periferike me pagë neto mujore prej 17.329,00 den.
10.	Një	(1)	Arsimtar të matematikës me fond të plotë orësh në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore pre 21.661,00 den.
11.	Një	(1)	Arsimtar të matematikës me fond të plotë orësh për në javë punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
12.	Një	(1)	Arsimtar të matematikës me 20 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe shkollat periferike me pagë neto mujore prej 21.661,00,00 den.
13.	Një	(1)	Arsimtar të matematikës me 9 orë mësimi në javë për punë në SHP në F.Allashec me pagë neto mujore prej 9.747,00 den.
14.	Një	(1)	Arsimtar të historisë me fond të plotë orësh në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
15.	Një	(1)	Arsimtar të shkencave natyrore me 20 orë dhe 2 orë mësimi biologji në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
16.	Një	(1)	Arsimtar të gjuhës maqedone me 20 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe shkollën periferike në f.Allashec.
17.	Një	(1)	Arsimtar të informatikës me 10 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 10.831,00 den.
18.	Një	(1)	Arsimtar të programimit me 14 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe SHP me pagë neto mujore prej 15.163,00 den.
19.	Një	(1)	Arsimtar të programimit me 12 orë mësimi në javë për punë në SHP me pagë neto mujore prej 12.997,00 den.
20.	Një	(1)	Arsimtar të projekteve nga informatika me 4 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore me pagë neto mujore prej 4.332,00 den.
21.	Një	(1)	Arsimtar të gjuhës frënge me fond të plotë orësh në javë për punë në shkollën qendrore dhe SHP me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
22.	Një	(1)	Arsimtar të etikës së religjioneve me 12 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe SHP me pagë neto mujore prej 12.997,00 den..
23.	Një	(1)	Arsimtar të etikës me 6 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe SHP me pagë neto mujore prej 6.498,00 den.
24.	Një	(1)	Arsimtar të biologjisë me 2 orë mësimi në javë për punë në SHP me pagë neto mujore prej 2.166,00 den
25.	Një	(1)	Arsimtar të shkencave natyrore me 6 orë mësimi në javë për punë në SHP – Allashec me pagë neto mujore prej 6.498,00 den.
26.	Një	(1)	Arsimtar të arsimit teknik me 5 orë mësimi në javë për punë në SHP me pagë neto mujore prej 5.415,00 den.
27.	Një	(1)	Arsimtar të artit figurativ me 12 orë mësimi në javë për punë në shkollën qendrore dhe SHP me pagë neto mujore prej 12.997,00 den.
28.	Një	(1)	Defektolog në shkollë me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.
29.	Një	(1)	Bibliotekist me 40 orë pune në javë me pagë neto mujore prej 21.661,00 den.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet sipas Ligjit për arsimin fillor.

Të gjitha vendet e punës janë me afat të caktuar kohor deri më **31.08.2019**.

Procesi edukativo-arsimor në shkollë zhvillohet në gjuhën mësimore shqipe.

Kandidatët Lutjes për punë duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:

- Diplomën ose Certifikatën për arsimimin e kryer (original ose kopje e notariuar)
- Certifikatën për gjendjen shëndetësore,
- Certifikatën e shtetësisë,
- Certifikatë nga Gjyqi se nuk janë të dënuar për vepra kundër moralit dhe dinjitetit.

Shpallja mbetet e hapur **5 (pesë)** ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa dokumentet dërgohen në SHFK. " Faik Konica" f.Sllupçan. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

U.D. Drejtori i shkollës
Rashit Jajja

Në bazë të nenit 43 nga Ligji për veprimtari shkencore-hulumtuese të RM (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 41/2014, 145/2015, 154/2015, 53/2016), Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" - Shkup, publikon:

KONKURS

për zgjedhje të bashkëpunëtorëve në tituj shkencor

- Publikohet konkurs për zgjedhje të:
 - një bashkëpunëtor nga sfera - gjuha moderne maqedonase, në një nga titujt shkencor;
 - një bashkëpunëtor nga sfera - leksikologjia dhe leksikografia, në një nga titujt shkencor;
- Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet dhe kriteret nga Ligji për veprimtari shkencore-hulumtuese (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 41/2014, 145/2015, 154/2015, 53/2016) dhe Ligjit për arsim të lartë (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016).
- Konkursi zgjat tetë ditë të punës llogaritur nga dita e publikimit.

Në bazë të nenit 23 nga Ligji për marrëdhënie të punës (tekst i pastuar)("Gz. zyrtare e RM" nr. 167/2015), nenit 80 dhe 82 nga LAF (Gz. zyrtare e RM nr. 103/08), Drejtori i SHFK "Vanço Prke" Dellçevë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE **për punësim për kohë të caktuar** **për vitin shkollor 2018/2019**

- Mësimdhënës të gjuhës maqedonase - 12 orë mësimore, neto pagesa 13.200,00 den.
- Mësimdhënës të mësimi klasor (qëndrim i vazhduar) - 20 orë mësimore, neto pagesa 21.500,00 den.
- Mësimdhënës të mësimi klasor - 20 orë mësimore, neto pagesa 21.500,00 den.
- Mësimdhënës të etika e religjioneve - 8 orë mësimore, neto pagesa 9.250,00 den.
- Mësimdhënës të inovacioneve - 2 orë mësimore, neto pagesa 2.800,00 den.
- Mësimdhënës të etikës - 4 orë mësimore 4.850,00 den.
- Psikolog - 40 orë pune, neto pagesa 21.500,00 den.
- Mësimdhënës të edukatës fizike dhe shëndetësore - 15 orë mësimore, neto pagesa 16.200,00 den.

Orari ditor i punës i kuadrin mësimor është nga ora 07:30 - 13:30, ndërsa i bashkëpunëtorit profesional nga ora 07:00 - 15:00.

Orari javor është i organizuar në 5 ditë të punës, ndërsa i kuadrin mësimor me orar jo të plotë të punës proporcionalisht me angazhimin. Fillimi dhe përfundimi i orarit ditor dhe javor të punës është në varshmeri me angazhimin e orëve mësimore sipas orarit të orëve për vitin shkollor.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parapara në nenin 80 të LAF dhe të kenë të mbaruar arsim të lartë përkatës sipas nenit 77 dhe 70 të LAF.

Me lutjen kandidatët të parashtrajnë diplomën për arsim të kartë përkatës të mbaruar, certifikatë për provim profesional të dhënë (nëse e kanë), certifikatë të shtetësisë.

Shpallja zgjat 3 ditë të punës nga dita e publikimit.

Përzgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 7 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

Lutjet me dokumentet e duhura (original ose kopje të noter) parashtrihen deri në arkivin e SHFK "Vanço Prke" Dellçevë, "Nikolla J. Vapcarov" pn, tel.për kontakt: 071-391-830.

SHFK "Vanço Prke" Dellçevë

ÇAIRASIT KRYEJNË TRANSFERIN E PARË

ENES AZIZI, PORTIER I RI I SHKUPIT

“Jam shumë i kënaqur që jam pjesë e FC Shkupi dhe të them sinqerisht, ndjehem krenar që më është dhënë mundësia të përfaqësojë një klub me emër të madhe dhe traditë, e që e bënë klubin më me emër në vendin tonë, me një tifozëri të flaktë”, ka deklaruar Azizi




Shkup, 8 janar - Skuadra e FC Shkupit ka arritur të angazhojë portierin Enes Azizi, i cili vjen te ekipi bardhekaltër pas pensionimit nga futbolli aktiv i Suat Zendetit. Skuadra shkupjane, kishte zbrazëritë në këtë pozicion, andaj Azizi është një zgjedhje e duhur për portën e Shkupit, i cili vjen nga kampionati zviceran. Portieri shqiptar që ka dy shtetësi, atë të Zvicrës dhe Maqedonisë në karrierën e tij ka luajtur në shumë skuadra, ndërsa vlen të përmendet se ishte pjesë e ekipit të madh francez, PSZH, ku për një vit mbrojti për kategorinë U19. Por një

lëndim në atë kohë bëri që Enesi të mos vazhdojë karrierën në Francë. Më pas ai ishte pjesë edhe te skuadra italiane Rexhina, luajti edhe me ekipin Dardania të Lozanës, po ashtu ishte pjesë edhe e Shkëndijës, ndërsa te FC Shkupi vjen nga ekipi i Bavois. Në deklaratën e tij të parë për faqen zyrtare të klubit Enes Azizi është shprehur krenar që do të mbajë veshë fanellën e klubit më me traditë në vendin tonë. “Jam shumë i kënaqur që jam pjesë e FC Shkupi dhe të them sinqerisht, ndjehem krenar që më është dhënë mundësia të përfaqë-

sojë një klub me emër të madhe dhe traditë, e që e bënë klubin më me emër në vendin tonë, me një tifozëri të flaktë. Për të qenë gjithçka e kompletuar, dua të falënderoj stafin teknik dhe lojtarët që më kanë bërë pritje fantastike. Premtoj se në çdo moment do të jap maksimumin që bashkërisht të arrijmë objektivat e klubit”, ka përfunduar Azizi, i cili ka firmosur marrëveshje me FC Shkupin për një vit. Enes Azizi është i lindur në 9 shkurt të vitit 1994, ndërsa është i gjatë 1.91 cm, cilësohet si një portier me reflekse shumë të mira, robust

dhe i sigurt në dalje duke bërë që të ketë kontroll të plotë të zonës së tij. Ndryshe, FC Shkupi ka konfirmuar edhe largimin e mbrojtësit të majt Bllagoja Ljamçevski të cilët me marrëveshje të dy palëve kanë gjetur gjuhë të përbashkët për të ndërprerë bashkëpunimin. Në këtë mënyrë Ljamçevski, pas qëndrimi një vjeçar në Çair, largohet nga FC Shkupi, ndërsa drejtuesit e klubit dhe kryesia e falënderojnë për kontributin e tij të dhënë në fanellën e FC Shkupit dhe i dëshirojnë suksese në karrierën e tij profesionale. Përveç, Ljamçevski ka ekipi i Shkupit është larguar edhe ndihmës trajneri i deritanishëm Emrah Volkan, i cili për shkaqe familjare ka vendosur që të ndërpres kontratë me skuadrën nga Çairi. Mirëpo drejtuesit e klubit menjëherë kanë arritur që në vendin e Volkan të angazhojnë për ndihmës trajner Husejin Hursoj me të cilin kanë nënshkruar kontratë 1 vjeçare. Ndryshe ekspedita e FC Shkupit, të martën nisi përgatitjet pranverore, ndërsa “stacioni” i parë do të jetë Dojrani, para se të shkohet në Antalë më 17 janar.



Alma Juniku, kampionia e botës në sportin tradicional tajlandez

Një luftëtare me baba nga Kosova dhe nënë nga Shqipëria po shkruan historinë e një sporti tajlandez në Australi. Është 18-vjeçarja Alma Juniku që muajin e kaluar fitoi dy tituj të botës në sportin Muay-Thai, të njohur edhe si tajboks (Thai Boxing). Alma më 13 dhjetor në Hong Kong e mposhti tajlandezen Zaza Sor Aree dhe kështu fitoi titujt e botës në kategorinë bantam në versionet WBC dhe IPCC. Luftëtarja e re ka lindur në Australi, ndërsa është pjesë e klubit “Modern Warrior Gym” në Queensland. Ajo ka nisur si nëntëvjeçare të ushtrijë Muay-Thai, sportin luftarak të Tajlandës, por tashmë të praktikuar në shumë vende të botës. Alma tashmë llogaritet luftëtare profesionale, ndërsa të tillë janë edhe vëllai e motra e saj, Andy dhe Amanda Juniku. Fillimisht fëmijët e familjes Juniku nisën me këtë lloj sporti për hobi, por mbetën në të, ndërsa Alma planifikon të qëndrojë gjatë.

Renova nis me përgatitjet

Shkup, 8 janar - Edhe skuadra e Renovës ka nisur me përgatitje për pjesën e dytë të kampionatit 2018/2019. Renova nën drejtimin e trajnerit Nikolla Ilievski, ditën e parë e nisi me dy seanca stërvitore një në palestër dhe një në terren të hapur. Të pranishëm ishin tre përforcimet Burhan Mustafov, Bojan Mioviski dhe Ermedin Adem. Faza e parë e përgatitjeve do të zhvillohet në Tetovë, ndërsa nga 25 janari, ekipi udhëton në Ohër për fazën e dytë dhe të fundit. Gjatë fazave përgatitore ekipi pritet të zhvillojë shtatë deri tetë ndeshje kon-



trolluese, ndërsa e para do të zhvillohet në Tetovë kundër Shkëndijës më 16 janar. “Me stërvitjen e parë të sotme i fillojmë përgatitjet. Projekti dhe plani janë që 20 ditë të ndalemi në Tetovë, pastaj vazh-

dojmë fazën tjetër në Ohër, ku do të qëndrojmë 12 deri 14 ditë dhe do të zhvillojmë edhe ndeshje kontrolluese”. Pastaj vazhdojmë në Tetovë për fazën e fundit”, deklaroi trajneri i Renovës, Nikolla Ilievski

Mehmedi mund ta përfundojë karrierën te Wolfsburgu

Sulmuesi Admir Mehmedi mund të qëndrojë gjatë te skuadra gjermane, Wolfsburg. Ai në një intervistë të gjatë dhënë gazetës gjermane “Bild”, ka theksuar se është i kënaqur te Wolfsburgu. “Momentet që po i kaloj këtu në Wolfsburg, do t'i ëndërronte çdo futbollist. Këtu kam gjithçka. Për mua si një njeri familjar, qyteti është i përsosur. Mund të qëndroj në Wolfsburg dhe më vonë të punoj edhe me të rinjtë e këtij klubi. Zvicra nuk është opsion për vazhdimin e karrierës. Në fund të karrierës, Amerika do të ishte opsion ideal. Por ka mundësi që ta përfundoj kar-

rierën në Wolfsburg”, ka thënë Mehmedi të hënën. 27-vjeçari me Wolfsburgun ka kontratë deri në qershor të vitit 2022. Te skuadra e Bundesligës u transferua në janar të vitit të kaluar nga skuadra tjetër gjermane Bayer Leverkusen. Në Gjermani ka luajtur edhe për Freiburgun. Karrierë ka bërë edhe në Ukrainë te Dynamo Kiev dhe në Zvicër te Zuerichu. Këtë edicion ka shënuar tre gola dhe ka kontribuar me tri asistime në 11 paraqitje. Ai shpreson të vazhdojë me paraqitje të mira edhe gjatë këtij viti. “Dua të vazhdoj me këtë ritëm. Deri tash ia kam dal. Unë kam potencial të jem



edhe më efektiv dhe të shënoj më shumë gola. Kam përmirësuar shumë gjëra gjatë këtij edicioni

dhe po më përshtatet roli i lojtarit të lirë në fushë”, është shprehur Mehmedi.



Zhuta pranë Konyasporit

Shkup, 8 janar - Skuadra turke, Konyaspor ka shprehur interesim për të transferuar mbrojtësin e krahut të majtë, Leonard Zhuta. Zhuta pjesë e Rijekës është që nga viti 2015, ndërsa me këtë klub kontratë deri në verën e këtij viti. Më herët ka luajtur për skuadrën suedeze, Hacken. “Mbrojtësi Leonard Zhuta ka gjasa të mëdha ta lë Rijekën për t'u transferuar te skuadra që mban vendin e tetë në Superligën e Turqisë, Konyaspor. Rijeka mund të përfitojë qindra e mijëra euro nga transferimi i Zhutës. Konyaspori nuk është skuadër që shpenzon shumë, sidomos në rastin e Zhutës që është në përfundim të kontratës”, raportuan mediat kroate. Zhuta është lojtar kyç në mbrojtjen e Rijekës. Ka kontribuar me dy asistime në 13 paraqitje këtë edicion.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E VRAPÇISHTIT

Rr. 100 PN, 1238 Vrapçisht

+389 (0) 42 332-378

info@komunavrapcisht.gov.mk

SHPALLJE

Për tjetërsim të tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë
përmes ankandit publik elektronik

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronë e Republikës së Maqedonisë, paraparë me DLUP - Dokumentacion lokal urbanistik planor, sipas pasqyrave tabelore në të cilat janë të parashtruara të dhëna për parcelat ndërtimore, për parcelat kadastrale të cilat janë të përfshira me parcelat ndërtimore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore, sipërfaqja për ndërtim, lartësia maksimale deri në varg, përqindja e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit, bruto sipërfaqja e zhvilluar për ndërtim, çmimi fillestar për m², çmimi total fillestar dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës.

1.B1 objekte nga veprimtari të vogla komerciale 05/10 – pasqyra tabelore nr.1

Numri i parcelës ndërtimore	Numri i parcelës kadastrale	Emri i kuajtur	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore (m ²)	Sipërfaqja e ndërtimit (m ²)	Lartësia maksimale deri në varg (m)	Përqindja e ndërtimit (%)	Bruto sipërfaqja e zhvilluar	Koeficienti i shfrytëzimit	Çmimi fillestar për m ² (denarë)	Çmimi fillestar total (denarë)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës (denarë)
1	75, 76, 77/1	Potoçani	1560	850	10.20	55	/	0,90	500	780.000	780.000

- hapi minimal për ankaand të tokës ndërtimore me qellim B1 objekte nga veprimtari të vogla komerciale, është 10,00 denarë.

TË DREJTË NË PJESMARRJE

Të drejtë në pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. Persona fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD, si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të marrin të drejtën për pronësi të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. Persona juridik: persona juridik vendas, person juridik në pronësi të përzier, person juridik i themeluar nga person juridik dhe fizik të huaj, të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD por të cilat nën kushte të reciprocitetit mund të marrin të drejtën në pronësi të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik përmes mënyrës elektronike, përmes sistemit informativ të dhënë në internet faqen www.gradezno-zemijste.mk ku dokumentacioni i duhur parashtror në kopje të shkruajtur (në PDF formë), në të cilën është theksuar për cilën parcelë është fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë në përbërje të fletëparaqitjes, e kompletuar me dëshmitë në vijim (të parashtruara në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter):

- Fletëparaqitje nga parashtruesi, në të cilën janë të theksuara të dhënat për parashtruesin e fletëparaqitjes, të dhënat për tokën për të cilën bëhet fjalë në fletëparaqitjen dhe cili dokumentacion parashtrorhet në bashkëngjitje.
- Garanci bankare për seriozitet të ofertës për çdo parcelë ndërtimore është e përcaktuar sipas pasqyrës tabelore të dhënë në këtë shpallje me afat të vlefshmërisë deri më 08.06.2019, me të cilën ofertuesi do të garantojë që nëse e merr statusin si ofertuesi më i volitshëm, do ta paguajë çmimin e arritur përfundimtar për tjetërsim të tokës ndërtimore në ankandin publik elektronik në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.
- Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës (jo më të vjetër se 6 muaj).
- Autorizim të rregullt për autorizuesin i cili e përfaqëson personin juridik, gjegjësisht dëshmi për funksionin person përgjegjës i autorizuar për personin juridik.
- Deklaratë me të cilin ofertuesi i pranon kushtet e parapara në shpalljen.
- E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes të cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do t'i dërgohen emri i përdoruesit dhe shifra për qasje në internet faqen në të cilën do të zhvillohet ankandi publik elektronik (për parashtruesit të cilët në fletëparaqitjen do të shkruajnë e-mail adresë të gabuar, Komuna Vrapçishte nuk e ka obligim të pranojë dhe të bëjë korrigjime të saj) Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik, për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Komisioni pas skadimit të afatit për parashtrim të fletëparaqitjeve, përcakton a janë fletëparaqitjet e kompletuara dhe të parashtruara në pajtim me kushtet e shpalljes. Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të së njëjtave përmes mënyrës elektronike, në afat prej 24 orëve pas skadimit të afatit për parashtrimin e tyre, ku parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët kanë dorëzuar dokumentacion të plotë i'u dërgon edhe emër përdoruesi dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesit e fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar i'u dërgojnë njoftim për mospjesëmarrjen e tyre në ankandin publik.

Parashtruesit e fletëparaqitjeve janë të detyruar të kenë certifikatë digjitale elektronike (nënshkrim) që të mund të parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik dhe të marrin pjesë në të njëjtën.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelat ndërtimore të theksuara në pasqyrën tabelore nr.1 është 500,00 denarë për metër katror.

GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për çdo parcelë ndërtimore është e përcaktuar sipas pasqyrave tabelore të dhëna në këtë shpallje.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik sipas pasqyrës tabelore nr.1, mund të parashtrohen deri më 08.02.2019, në mënyrë elektronike përmes internet faqes në vijim www.gradezno-zemijste.mk.

Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim www.gradezno-zemijste.mk Ankandi publik për 1 do të fillojë më 14.02.2019, në ora 12:00, dhe i njëjti do të zgjat 15 minuta.

PROCEDURA

- Komisioni informon parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave përmes formës elektronike në afat prej 24 orëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e të njëjtave, ku parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgohet emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgohet kumtesë me arsyetimin se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
- Në ditën e mbajtjes së ankandit publik elektronik pjesëmarrësit kanë qasje në internet faqen me emër përdorues dhe shifër që e kanë marrë në e-mail adresë, të dërguar në formë të bashkëngjitur me paraqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik.
- Ankandi publik elektronik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik, për secilin parcelë ndërtimore veç e veç.
- Ankandin publik elektronik e përcjell Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës së Vrapçishtit.
- Ankandi publik elektronik fillon me publikimin e çmimit fillestar të tokës për metër katror, ndërsa realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve.
- Ankandi realizohet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës në çdo "hap" jo më pak se 10,00 denarë për Pasqyrën tabelore nr. 1.
- Ankandi publik elektronik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në këtë shpallje, ku nëse në kalimin e dy minutave të fundit nga ana e pjesëmarrësve ofrohet ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta. Ankandi publik vazhdon pa kufi derisa brenda intervalit kohor prej dy minutave ka ofertë të re.
- Pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin e ofertuesit më të volitshëm.
- Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik dhe në mënyrë elektronike ua dorëzon të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.
- Pas përfundimit të procedurës për ankaand publik, Komisioni obligohet që në afat prej tre ditëve të punës të parashtrorë dëshmi për mendim deri te Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë në lidhje me propozim-tekstin e marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë.
- Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë obligohet që të parashtrorë mendim në lidhje me propozim-tekstin e marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga marrja e kërkesës për mendim. Nëse në afat prej 30 ditëve Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë nuk parashtron mendim, "do të konsiderohet për pozitiv".
- Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë, Komisioni në afat prej tre ditëve të punës deri te ofertuesi më i volitshëm parashtron lajmërim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.
- Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga marrja e lajmërimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm obligohet që të paguajë mjetet dhe deri te Komisioni të parashtrorë dëshmi për pagesën e realizuar në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 10% të vlerës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës, por jo më shumë se 78.000,00 denarë si dhe dokumentacioni i tërësishëm i nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik (në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter).
- Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet brenda afatit të caktuar, garancia bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të arrihet marrëveshje dhe i njëjti nuk do të mund të marr pjesë në çdo ankaand të ardhshëm të parcelës ndërtimore në fjalë.
- Nëse ofertuesi më i volitshëm i paguan mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi publik brenda afatit të caktuar, ndërsa në bazë të dokumentacionit të parashtruar nuk mund të lidhë marrëveshje, mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore nuk do t'i kthehen, garancia bankare e ofertës i aktivizohet dhe nuk do të lidhet marrëveshje.

16. Shuma e shpenzimeve të posaçme në procedurën për tjetërsim të tokës ndërtimore është 10% e verës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës, por jo më shumë se 78.000,00 denarë.

17. Në afat prej pesë ditëve të punës pas parashtrimit të dëshmisë për pagesën e realizuar dhe parashtrimit të dokumentacionit të kompletuar të nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik, Kryetari i Komunës së Vrapçishtit në emër të Republikës së Maqedonisë lidhë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë në formë elektronike përmes sistemit informativ.

18. Pas lidhjes së marrëveshjes Komuna e Vrapçishtit në afat prej një dite në mënyrë elektronike parashtron marrëveshjen deri te Departamenti për tatime, taksa dhe kompensime për përcaktim të tatimit të qarkullimit të patundshmërive. Blerësi obligohet që në afat prej 15 ditëve pas marrjes së vendimit për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive të paguajë tatimin dhe të parashtrorë dëshmi për pagesën e realizuar.

19. Pas parashtrimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të qarkullimit të patundshmërive, blerësi në afat prej 15 ditëve marrëveshjen në mënyrë elektronike e parashtron deri te noter për kryerje të solemnizimit. Blerësi obligohet që solemnizimin ta realizojë në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të marrëveshjes te noter kompetent.

20. Mosplotësimi i obligimeve nga pikat 17,18 dhe 19 të kësaj shpallje me faj të blerësit paraqesin bazë për ndërprerje të njëanshme të marrëveshjes ku 80% e shumës së përgjithshme të tjetërsimit nuk i kthehet blerësit.

21. Me marrëveshjen blerësi obligohet që në afat prej 9 muaj nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore që është me sipërfaqe mbi 5.000 m², gjegjësisht 12 muaj nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore që është me sipërfaqe mbi 5.000 m² të sigurojë leje për ndërtim të objekteve të parapara në pajtim me planin urbanistik sipas të cilët është tjetërsuar toka dhe të ndërtojë objektet në pajtim me planin urbanistik sipas të cilët është tjetërsuar toka, në afat prej dy viteve pas marrjes së lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtuar deri në 1.000 m², në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, gjegjësisht në afat prej katër viteve nga dita e marrjes së lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtuar mbi 1.000 m², në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, në të kundërtën, nëse blerësi nuk nxjerr leje për ndërtim brenda afatit të parapara, gjegjësisht nëse objektet nuk ndërtohen brenda afatit të caktuar për faj të blerësit, i njëjti obligohet të paguajë dënim të marrëveshjes në shumë prej 1,5% nga çmimi i arritur i përgjithshëm në ankandin publik për tokën në fjalë për secilin muaj të kaluar, në vitin e dytë të kalimit të afatit, gjegjësisht 4,5% nga çmimi i arritur i përgjithshëm në ankandin publik për tokën në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe secilin vit të ardhshëm të kalimit të afatit.

Ofertuesi më i volitshëm obligohet që të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim sipas marrëveshjes së arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore.

22. Përqindja minimale që duhet të jetë e ndërtuar në gjithsej sipërfaqen e zhvilluar për ndërtim të parapara me planin urbanistik për parcelën e ndërtuar ndërtimore nuk duhet të jetë më e vogël se 30%.

23. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

24. Shpenzimet për procedurë materiale dhe futje në evidencë të patundshmërive në Agjencinë për kadastrë të patundshmërive bien mbi blerësin e tokës ndërtimore.

25. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedurën për tjetërsim përmes ankandit publik nuk guxon ta japë tokën personave të tretë para plotësimit të obligimeve nga marrëveshja për tjetërsim të së njëjtës. Ndalea për dhënie të tokës personave të tretë shënohet në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive.

26. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të parashtrorin apel deri te Komisioni në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik elektronik. Pas apelit me vendim Komisioni obligohet të vendosë në afat prej pesë ditëve pas pranimit të së njëjtës.

27. Kundër vendimit të sjellë nga ana e komisionit, i cili vendos në lidhje me apelin e parashtruar, pala ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Kryetari i komisionit
Besnik Ameti



Në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit në fushën e arsimit të mesëm gjatë vitit 2019 ("Lajmëtar zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 17/2018), Qyteti i Shkupit shpall:

Thirrje publike

për tubim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019, të përcaktuara për financim të aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve

1. Të drejtën e pjesëmarrjes

1.1. Të drejtën e pjesëmarrjes në Thirrjen publike e kanë Shoqatat civile dhe fondacionet.

2. Mënyra e përcaktimit të mjeteve.

2.1. Përcaktimi i mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019 (Programi N2 Shërbime për aktivitetet shkollore jashtëmësore në bashkëpunim me organizatat joqeveritare zëri 425 konto 425750) të përcaktuara për financim të aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe fondacioneve, do të realizohet në pajtim me Kodin e praktikave pozitive për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 130/07) dhe në bazë të kriterëve dhe prioritetëve të përcaktuara me këtë thirrje.

3. Lloji i projekteve që do të përkrahen.

3.1. Mjetet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, në shumë të përgjithshme prej 3.500.000 denarë do të shfrytëzohen për financim të aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve, përmes granteve për projekte nga fusha e arsimit të përcaktuara për këto prioritetë vijuese:

1. Krijimi i mjedisëve të sigurta shkollore (*ndihma psikolojike - sociale e anëtarëve të bashkësisë shkollore për ballafaqim me dhunën* përmes sigurimit të përkrahjes profesionale për zbatim të denjë të mekanizmeve dhe protokolleve të miratuara të punës në shkollat, si dhe promovimin e sistemit të vlerave pozitive);
2. *Ngritja e vetëdijes dhe kujdesi për mjedisin jetësor* duke formuar rrjet në eko klubet shkollore, si dhe përmes avancimit të bashkëpunimit dhe lidhshmërisë arsimtarëve, nxënësve dhe ekspertëve nga fusha e ambientit jetësor dhe ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit në themelimin e sistemit të organizuar për selektimin e mbeturinave, si dhe realizimin e aksioneve në vazhdimësi për zburimin e ambientit jetësor.
3. *Edukim dhe promovim për ndërtimin e stileve të shëndetshme jetësore* të rinjve nëpërmjet fuqizimit të vetëdijes të nxënësit e shkollave të mesëm dhe të opinionit më të gjerë për përgjegjësitë personale në mbrojtje të shëndetit fizik, psikik, seksual dhe reprodiktiv. Qëllimi specifik i projektit do të jetë avancimi i bashkëpunimit mes arsimtarëve, nxënësve dhe ekspertëve nga fusha e shëndetit në realizimin e aktivitetëve konkrete të cilat do të kontribuojnë në ndërtimin e stileve të shëndetshme jetësore tek të rinjtë.

4. *Hulumtime dhe promovim i të drejtave të nxënësve*, lirive dhe dallimeve – me qëllim iniciimin e debatit mes të rinjve për tema që janë relevante për preokupimet e tyre identike dhe të ofrojë përkrahje profesionale dhe ndihmë për këtë problematikë.

5. *Nxiti dhe zhvillimi i karrierës individuale të nxënësve dhe ofrimin e ndihmës plotësuese dhe përkrahjen e arsimtarëve dhe nxënësve në aktivitetet për orientimin e planifikuar dhe ndërtimin e karrierës së nxënësve.*

6. *Organizimi i manifestimeve* në të cilat do të prezantohen arrijtjet e larta shkollore, do të promovohen nxënësit më të mirë dhe do të prezantohen rezultatet e veprimtarisë edukative arsimore para opinionit të gjerë.

4. Kriteret themelore të organizimit

4.1. Kriteret themelore të organizimit, të cilat duhet ti përmbushin shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- o Të janë të regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet me seli në qytetin e Shkupit;
- o Të mos kenë fituar mjete ose të mos kenë dorëzuar fletë paraqitje nga / deri te ndonjë organ tjetër i drejtorisë shtetërore ose burime tjera për qëllime dhe aktivitete të njëjta për të cilat parashtrojnë fletëparaqitje, dhe që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të aktivitetëve të njëjta nga burime të ndryshme.

5. Vlerësimi i cilësisë së projekteve

5.1. Vlerësimi i cilësisë së projekteve të shoqatave dhe fondacioneve të cilët i përmbushin kriteret themelore të organizimit, do të realizohet në bazë të këtyre kriterëve të veçanta programore:

Fusha	Pikat maksimale të vlerësimit
1. Resurset dhe struktura e organizimit	40
1.1 Vallë shoqata dhe fondacioni posedon strukturën organizuese dhe resurset njerëzore për realizim të projektit (së paku 10 persona të angazhuar në baza të ndryshme: të punësuar, vullnetarë aktiv, persona të angazhuar me honorarë)	10
1.2 Profesionist të cilët marrin pjesë në zbatimin e projektit	10
1.3 Vallë shoqata dhe fondacioni disponojnë me hapësirë të zyrave dhe me pajisje teknike për realizim të projektit	10
1.4 Vallë shoqata ose fondacioni siguron me shumë se 15 % të pjesëmarrjes pronësore gjatë realizimit të projektit	10
2. Bashkë financimi i projektit	10
2.1 Vallë shoqata ose fondacioni siguron me shumë se 15 % të pjesëmarrjes pronësore gjatë realizimit të projektit	10
3. Cilësia e projektit	50
3.1 Në çmasë qëllimi i përgjithshëm i projektit do të kontribuojë për realizimin e prioritetëve të përcaktuara, sa i njëjtë është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë përfundimtare	10
3.2 Zgjidhje të ofruara me cilësi dhe inovative të përfshira në propozim projektin	10
3.4 Sigurimi i inkuadrimin të organizatave dhe institucioneve tjera	10
3.5 Vallë plani për realizim të projektit është i qartë dhe i realizueshëm	10
3.6 Vallë plani i propozuar financiar është real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive dhe pozitave korrespondon me çmimet e tregut)	10

5.1. Çdo fushë e kriterëve të posaçme programore, do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pika ose 10 pika, me kuptimin vijues: 1 – jo, 5 – pjesërisht dhe 10 – po.

5.2. Me këtë Thirrje publike do të bashkë – financohen maksimalisht 10 projekte.

6. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqata / fondacioni duhet ta dorëzojë së bashku me Fletëparaqitjen për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve

6.1. Përkaj Fletëparaqitjes për përkrahje financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve, e cila duhet të plotësohet (me shkronja të shtypit në alfabetin cirilik), të nënshkruar nga personi i cili është i autorizuar që ta përfaqësojë shoqërinë civile ose fondacionin, me vullën e shoqatës civile ose të fondacionit, shoqata civile ose fondacioni detyrimisht duhet ti dorëzojë edhe shtojcat vijuese:

- Statutin e shoqatës ose të fondacionit;
- Fotokopje të aktvendimit për regjistrim të shoqatës ose fondacionit;
- Formularin e plotësuar me kompjuter për Propozim projektin;
- Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit gjatë vitit të kaluar fiskal si dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë shfrytëzues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit);
- Raport vjetor të shoqatës ose fondacionit për vitin 2018;

- Fotokopje të llogarisë përfundimtare për vitin 2018;
- Vërtetim për tatimet e paguara, të dhënë nga organet tatimore.

7. Dokumentacioni përcjellës

7.1. Shoqatat dhe fondacionet, si shtojca mund të dorëzojnë edhe këto dokumente përcjellëse:

- Biografi profesionale të profesionistëve të cilët do të angazhohen për realizimin e projektit;
 - Listën referente ose dëshmi (p.sh.: kontratë të nënshkruar) për së paku 2 projekte të realizuara nga fusha për të cilën aplikohet,
 - Së paku dy mendime / referenca nga partnerë ose donatorë për realizim të projekteve të mëparshme, dhe
 - Përkrahje me shkrim nga organizatat ose institucionet tjera, të cilët është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.
- 7.2. Shoqatat civile dhe fondacionet, mund të dorëzojnë më shumë se një fletëparaqitje për përkrahje financiare në lidhje me këtë thirrje publike.
- 7.3. Në propozim – projektin e dorëzuar, shoqatat dhe fondacionet duhet të përcaktohen për një nga prioritetet, në suaza të cilat do ta realizojnë projektin.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacione të pakompletuara ose të dorëzuara pas skadimit të afatit të paraparë, nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.

8. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

8.1. Vlerësimi i projekteve do të realizohet nga Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

8.2. Projektet të cilët pas evalvimit të kryer nga ana e Komisionit do të vlerësohen me së paku 60 pika, do të kualifikohen për fitimin e përkrahjes financiare nga Qyteti i Shkupit.

8.3. Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit nga dita e përfundimit të thirrjes publike, do të lidh kontratën për shfrytëzim të mjeteve me ato shoqata civile dhe fondacione, të cilat janë kualifikuar për fitimin e mjeteve financiare për përkrahje.

9. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

9.1. Afati i dorëzimit të fletëparaqitjeve zgjat 15 ditë pune, nga dita e shpalljes në gazetën ditore, gjegjësisht i njëjti zgjat nga data 09. 01.2019 deri më 29.01.viti 2019.

9.2. Fletëparaqitja me dokumentacionin e tërësishëm, duhet të dorëzohet përmes postës në adresën vijuese: **Qyteti i Shkupit, Sektori për arsim, bul. "Ilindenska" nr. 82, 1000 Shkup**, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit deri në ora 15 (me shenjë – Sektori për arsim – Fletëparaqitje për thirrje publike).

9.3. Shoqatat ose fondacionet, pjesëmarrëse në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në afat prej 10 ditëve nga dita e sjelljes së Vendimit për përcaktim të mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019, të përcaktuara për financim të aktivitetëve programore të shoqatave dhe fondacioneve.

Fletëparaqitja për përkrahje financiare të shoqatave dhe fondacioneve si dhe Formulari për Propozim – projektin, mund të merren në hapësirat e Qytetit të Shkupit, në Sektorin për arsim si dhe në ueb faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk në pjesën Shpallje, konkurse, evenimente – Thirrje publike.

Pyetjet për sqarime, mund të dorëzohen me shkrim ose në trajtë elektronike deri te Sektori për arsim.

Kontakti: Sektori për arsim, tel: (02) 3297-323, e - maili: Sultana.Chuleva@skopje.gov.mk

Në bazë të nenit 21 dhe 22 paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, publikon

Shpallje

për punësim me kohë të caktuar deri më 31.12.2019

I. Për nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor për punë administrative dhe juridike në Agjencinë e Punësimit – (3) tre realizues, në Qendrat e punësimit Berovë (1) dhe Shkup (2).

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta në vijim:

- Arsimin e lartë, gjegjësisht të ketë së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose të ketë mbaruar shkallën VII/1- Shkenca juridike;
- Të ketë së paku dy vite përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

2. Bashkëpunëtor për shërbime dhe orientim profesional në Agjencinë e Punësimit e Republikës së Maqedonisë në Qendrën e punësimit – (2) dy ekzekutues, në punësimin e Probishtip (1) dhe Strugë (1).

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsim të lartë- Psikologji;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

3. Bashkëpunëtor për shërbime për mbështetjen e punësimit – (18) ekzekutues, prej të cilëve të punësuar dhe në këto qendra të punësimit: Shkup (4) Manastir (1), Gjevgjeli (1), Gostivar (1), Kriva Pallankë (1), Kratovë (1), Kërçovë (2), Kumanovë (1), Ohër (1), Sveti Nikollë (1), Strugë (1) dhe Tetovë (2).

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas EKTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

4. Bashkëpunëtor për çështjet financiare në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë (2) dy ekzekutues – Qendra e punësimit Strugë- (1) një ekzekutues në Qendrën për Punësim në Krushevë (1) një ekzekutues.

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas EKTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1- Shkenca ekonomike;

- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

5. Referent i shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë (5) pesë ekzekutues– Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit - (4) katër realizues, Qendra e punësimit në qytetin e Gjevgjelit –(1) një realizues

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë.

6. Referent për shërbimeve të sportelit –(2) dy realizues, nga të cilët dy drejtues në qendër për punësim të qytetit të Kavadar (1) një realizues, dhe Radovish (1) një realizues.

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë.

7. Referent për punë administrative dhe juridike në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit - (1) një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Studime të larta juridike ose arsim të mesëm profesional
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë.

8. Administrator për punë administrative dhe punë arkivore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në Valandovë – (1) një ekzekutues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Shkenca të larta juridike ose ekonomike ose arsimin e mesëm juridik ose ekonomik ose gjimnazin
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njëjës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë.

9. Dërgesa e shoferit në Agjencinë në Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në Berovë – (1) një ekzekutues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- arsimin e mesëm
- kështu ose pa përvojë pune
- licenca e shoferit B kategori

- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 12.150 denarë.

10. Mirëmbajtës i higjienës në Agjencinë e punësimit e Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror – (1) një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të mesëm
- Të ketë ose të nuk ketë përvojë punës në profesion
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 12.150,00 denarë

II. Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Aplikimi me një shënim për të cilin është regjistruar vendi i punës;
- Dëftesën/diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/dëshminë për përvojë të punës;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje e programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje aktive të gjuhëve;
- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë.

III. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune-40 orë në javë, nga e hëna deri të premten, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

V. Shpallja do të jetë e hapur 3 (tre) ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditore.

VI. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr.43, 1000, Shkup. Personi kontaktues Nadica Arsovska, telefoni 02 / 3111-850 lokale 127.

- VI. Zgjedhja e aplikantëve do të bëhet brenda 45/90/120 ditëve pas skadimit të afatit për aplikim pas shpalljes.

Interi nuk është dorëzuar për Modric, vazhdon të besojë dhe këmbëngulë në këtë pistë. Një ëndërr që mbetet e gjallë, e zbuluar kohët e fundit edhe nga drejtori sportiv, Piero Ausilio. Menaxheri i Interit përdori shprehjen e famshme "Never Say Never", duke i rindezur shpresat për ta parë yllin kroat me fanellën zikaltër

Vera e vitit 2018 do të mbahet mend nga tifozët e Interit për ëndrrat që ushqyen, se mund ta shihnin Luka Modric në Milano. Pasi u eksploruan disa mundësi në atë kohë, lojtari që më vonë do të bëhej "Topi i Artë" mbebi në "Santiago Bernabeu". Megjithatë, klubi zikaltër nuk është dorëzuar, vazhdon të besojë dhe këmbëngulë në këtë pistë. Një ëndërr që mbetet e gjallë, e zbuluar kohët e fundit edhe nga drejtori sportiv, Piero Ausilio. Menaxheri i Interit përdori shprehjen e famshme "Never Say Never", duke i rindezur shpresat për ta parë yllin kroat me fanellën zikaltër. Duke vuajtur, falë rezultateve të dobëta të Real Madridit, Modric mund të kërkojë një


INTERI I RIKTTHEHET LUKA MODRICIT



rugëdalje të re, pse jo nën shembullin e Cristiano Ronaldos, në "perëndim" të karrierës së tij. Nuk përbën më sekret, e kanë pohuar edhe bashkëlojtarët e tij zikaltër në kombëtare, se "Topi i Artë" për vitin 2018 dëshiron të luajë në Serie A, para mbylljes së karrierës së tij të jashtëzakonshme. Për të bërë që kjo të ndodhë, siç është shpallur nga "La Gazzetta Dello Sport", do të shërbejë një veprim diplomatik, i aftë për të ndrequr marrëdhëniet mes Interit dhe Real Madridit. Vullneti i Steven Zhang është i qartë: të lidhet pas

ankesës të dorëzuar në FIFA nga klubi i Madridit, prej nga mori përgjigjen se Interi nuk ka thyer asnjë rregull. Për t'i propozuar sërish Modricit një ofertë vërtet joshëse për vitet përmblylëse të karrierës. Ardha e Giuseppe Marotta në klubin zikaltër mund të ndihmojë për t'i "shëruar" marrëdhëniet me Florentino Perez. Strategji që mund të japë fryte, të paktën si fillim. Në favor të klubit italian pritet të jetë edhe kontrata e Modric, që skadon në vitin 2020 dhe ende nuk po rinovohet. Një "aleat", që nuk ka rëndësi të

vogël për Interin, i cili duket se ka nisur një politikë shumë të qartë për të siguruar shërbimet e nënkampionit të botës. Përtej financave, Modric i sigurohet vendi i titullarit në ekip, por edhe kombinimi me lojtarë të tjerë me përvojë në "San Siro", sikurse është fjala për Diego Godin. Një perspektivë ambicioze, që vërtet josh dhe ngroh. Në kushtet e lojtarëve të lirë, edhe Robben e Valencia janë në radarin zikaltër. Fundja, Marota është thirrur "nën armë" pikërisht për këtë, që të sjellë përvojën bardhezi tek Interi. Puna sapo ka nisur



Chelsea i "vendos syrin" Benzemas

Sulmuesi i Real Madrid-it, Karim Benzema është piketuar nga Chelsea sipas "Mirror". Marrëveshja pritet të arrihet këtë muaj, duke pasur parasysh "etjen" e teknikut të bluve Maurizio Sarri për të fuqizuar ekipin në dritaren e merkatos pas dështimit të Alvaro Moratas dhe Giroud për të qenë titullar të padiskutueshëm. 31 vjeçari ka shkuar te Real Madrid në vitin 2009 pas një marrëveshje të majme të bërë me Lyon. Ai ka shënuar shtatë gola në 18 paraqitje në La Liga këtë sezon dhe mendohet se kohës së tij në Bernabeu i ka ardhur fundi. Nuk dihet ende oferta financiare, por blutë kërkojnë me domosdoshmëri të zëvendësojnë Moratan që ka ende probleme me vetëbesimin, i cili është lidhur së fundmi edhe me një lëvizje te Sevilla.

Milan dhe Juventus, një tjetër marrëveshje e bujshme



Leonardo po mundohet që në të gjitha drejtimet të komplettojë skuadrën, në mënyrë që të krijojë një Milan konkurrues për fazën e dytë të kampionatit italian. Së fundi në Itali është zbuluar se drejtori brazilian është vënë në kontakt me drejtuesit e

Juventus për të mbyllur marrëveshjen për transferimin e Medhi Benatias. Mbrojtësi do të largohet nga "Zonja e Vjetër" dhe për të janë të interesuar klube të mëdha si Arsenal dhe Borussia Dortmund. Por, Leonardo po shfrytëzon kanalën që u krijua nga

shkëmbimi i madh i merkatos së verës Higuain-Bonucci-Caldara. Milan po përgatit një ofertë për mbrojtësin maroken, që nëse arrihet të komplettohet si marrëveshje mund të përfitojë edhe një ulje të vlerës së kartonit të Higuain.

Pulisic lojtari më i shtrenjtë në merkaton e këtij viti

Ka kaluar vetëm një javë nga hapja e merkatos së janarit dhe do të ketë shumë lëvizje deri në fund të muajit, por ndërkohë klubet më të pasur po lëvizin dhe që tani janë regjistruar jo pak transferime të bujshme. Lojtari më i shtrenjtë në merkaton e këtij viti deri tani është Christian Pulisic, i cili është transferuar nga Dortmundi te Chelsea për 64 milionë euro, ndërsa do të luajë në Gjermani deri në verë, i huazuar. Blerja e dytë më e shtrenjtë është ajo e brazilianit Lucas Paquetà nga Milani, që ka paguar 35 milionë euro për t'ia marrë Flamengo. Më pas horizontet zgjerohen jashtëzakonisht, sepse blerja të shtrenjta ka anëmbanë globit, gjë që nuk ndodhte në të shkuarën. Në 10 transferimet më të shtrenjta të këtij muaji tre janë regjistruar në



Meksikë, aty ku klubet po forcohen gjithnjë e më shumë ekonomikisht. Edhe Kina e ka një superblerje, me Anderson Talisca që kalon nga Benfica te Guangzhou Evergrande për 19 milionë euro. Al Ittihad në Arabinë Saudite ka sh-

penzuar 9 milionë euro për të marrë Garry Rodrigues nga Galatasaray, ndërsa Anglia është aq e frikshme financiarisht, saqë dy klube nga Championship kanë bërë blerje që hyjnë në 15 më të shtrenjtat e janarit.

MERKATOJA E JANARIT: 15 TRANSFERIMET MË TË SHTRENJTA

Christian Pulisic (Borussia Dortmund - Chelsea, 64 milionë)
 Lucas Paquetà (Flamengo - Milan, 35 milionë) Dominic Solanke (Liverpool - Bournemouth, 21 milionë) Anderson Talisca (Benfica - Guangzhou Evergrande, 19 milionë)
 Amadou Haidara (RB Salzburg - RB Leipzig, 18 milionë)
 Brahim Diaz (Manchester City - Real Madrid, 17 milionë)
 Benik Afobe (Wolverhampton - Stoke City, 13 milionë)
 Maximiliano Meza (Independiente - Monterrey, 13 milionë)
 Victor Davila (Necaxa - Pachuca, 10 milionë) Orbelin Pineda (Chivas - Cruz Azul, 10 milionë) Alphonso Davies (Vancouver Whitecaps - Bayern München, 10 milionë) Lisandro Magallan (Boca Juniors - Ajax, 9 milionë) Garry Rodrigues (Galatasaray - Al Ittihad, 9 milionë) Alexis Vega (Toluca - Chivas, 8 milionë) George Saville (Milwall - Middlesbrough, 8 milionë)



HAPET KONKURS PËR PUNË NË FANAR, PAGUHET 130 MIJË DOLLARË NË VIT

Zyrtarët lokalë në një ishull që ndodhet pranë San Franciskos, kanë hapur një konkurs, për dy punëtorë që do të punojnë në farin e ishullit. Paga vjetore është shumë e lartë, për të cilën punë paguhet 130.000 dollarë, shkruan Guardian. Puna kryesore e të punësuarve është të përgatisin ushqim

për turistët, kështu që duhet të dinë të gatujnë mirë, të pastrojnë, të ofrojnë shërbime të ndryshme për mysafirët dhe të organizojnë shpërndarjen e ushqimit. Ata gjithashtu duhet të dinë të përdorin varkën, e që kërkon lejen e kapitenit nga Rojet bregdetare të Shteteve të Bashkuara. "Puna

është sigurisht joshëse, por gjithashtu ka shumë punë për të bërë. Orari është rrasëkapitës. Shpesh zgjat nga mëngjesi i hershëm deri në fund të natës", tha Jillian Miker, një zonjë që la punën, por gjithashtu do të ndihmojë në intervistat për punonjësit e ardhshëm të farit.



Një 16-vjeçar mbaron... Harvardin!


Një nxënës 16-vjeçar nga Kansas ka vendosur të përfundojë studimet si në shkollën e mesme ashtu dhe në Universitetin e Harvardit, në pranverë. Braxton Moral, i cili është një nxënës në liceun e "Ulysses High School", do të marrë si diplomën e shkollës së mesme edhe atë bachelor nga universiteti "Ivy League", në muajin maj, shkruan DPA. Pavarësisht se është studenti i parë dhe i vetëm që njëkohësisht ndjek një diplomë të shkollës së mesme dhe një diplomë bachelor nga Universiteti i Harvardit, Moral nuk e konsideron veten të ndryshëm nga nxënësit e tjerë të shkollave të mesme. "Unë nuk jam ndryshe, unë thjesht bëj një gjë të vogël në anën tjetër", thotë Moral. Moral shpreson të studiojë në Fakultetin Juridik të Harvardit pas diplomimit. Ai ka në plan të bëhet politikan, pas përfundimit të studimeve në këtë fakultet.

Pse gjithmonë hipim në aeroplan nga ana e majtë?

Udhëtimi me aeroplan shpesh kërkon t'i bëjmë vetes disa pyetje të reja, kryesisht për shkak të procedurave specifike që shpesh nuk i vërejmë. Njëri prej tyre është hyrja në aeroplan. Pse është gjithmonë në anën e majtë të aeroplanit? Zgjedhja bie në një anë kryesisht për shkak të stafit që pala tjetër mund të përdorë për të shtuar karburante, për të vënë në ndonjë bagazh etj. Përveç kësaj, pilotët zakonisht ulen në anën e majtë, pasi e bën më të lehtë të vlerësojnë distancën e avionit nga aeroporti dhe ta parkojnë më mirë atë. Ka një shpjegim tjetër që rrënjët i ka në traditën detare. Më parë, njerëzit duhej të hipnin në anije vetëm në të majtë, kështu që prodhuesit e avionëve ndoqën të njëjtin shembull. E vetmja mënyrë që mund të hyni në të dyja anët është nëse fluturon me një aeroplan më të vogël.



Nxënësit në këtë qytet kanë dollape për telefonat e tyre



Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në shkollën për ushqim dhe ekonomi në Prijedor, Bosnjë dhe Hercegovinë, të gjitha klasat janë të pajisura me dollape për të lënë telefonat celularë. Ideja është që telefonat nuk përdoren gjatë ligjeratave, i cili është një vendim i përbashkët i këshillit të studentëve, prindërve dhe mësuesve. Vendimi nënkupton që të gjithë respektojnë të njëjtat rregulla, kështu që profesorët menjëherë e pranuan idenë e re. Studentët thonë se ata pajtohen sepse në këtë mënyrë arrijnë të përqendrohen në mësimdhënie. Ata lënë telefonat e tyre në kabine para fillimit të orëve, dhe ata mund t'i përdorin ato gjatë festave. Në periudhën e mëparshme, brendësia e shkollës ishte e pajisur me mobilje dhe ndriçim të ri.

1317 - Filip i V i Gjati kurorëzohet Mbret i Francës.

1349 - 700 hebrenj të Bazelit të Zvicrës ndizen të gjallë në shtëpitë e tyre.

1558 - Gjeneva shpallet e pavarur nga kantoni i Bernit.

1718 - Franca i shpall luftë Spanjës.

1799 - Kryeministri britanik Uiliam Pit prezanton ngritjen e taksave për të ardhurat që të rriten fondet për luftën kundër Napoleonit.

1943 - Qeveria japoneze në Java limiton shitjen dhe përdorimin e automjeteve.

1995 - Ekuadori dhe Peru përfshihen në një luftë kufitare.

1997 - Sulmi në zemër kthen në spital Frank Sinatrën.

2002 - Majkëll Xhekson merr çmimin Artist i Shekullit në "American music awards".

2007 - Apple Inc CEO, Steve Jobs prezanton iPhone.

KALENDARI HISTORIK 9 JANAR



PSE DUHET TË LINI NJË KOKËRR QEPË TË QËRUAR NË DHOMË

Vetitë e qepës janë të njohura për shëndetin, ndaj këshillohet që të konsumohet rregullisht. Por nëse vetitë antibakteriale dhe kurative janë të njohura, ka një tjetër veti të saj të cilën nuk e njihni. Kështu nga sot bëni mirë që të lini një kokërr qepë të qëruar në dhomë, sidomos në stinën e dimrit. Kjo pasi një kokërr qepë në dhomë arrin që të thitë të gjitha bakteret duke mbrojtur shëndetin tuaj. Në këtë mënyrë parandalohen sëmundjet dhe virozat e dimrit. Këshillohet që një kokërr qepë të mos mbahet më shumë se 24 orë, ndërsa më tej vendosni një tjetër.

A E DINI SE...

KULLERI

Vdes njëri dhe kullerat shkojnë për kryeshëndosh. Kulleri: Hej njerëz, a u mërzhitet për tipin bre, shumë i smut o kon a, shumë mu ka dhimt aaa! Burrat tjerë në dhomë ia kthejnë: Jo bre su kanë smut, po kerri e ka shkelë!

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Edhe e vërteta e dëmshme vlen më shumë sesa gënjeshtria e dobishme. (Tomas Man)